

**Alain Maillard
Kujtim Shabani**

IMAZHI I SHQIPTARËVE NË MEDIET ZVICERANE

Parathënia Olivier Meuwly
Pasthënia Laurent Matthey



ISEAL

**Alain Maillard
Kujtim Shabani**

IMAZHI I SHQIPTARËVE NË MEDIET ZVICERANE

Parathënia **Olivier Meuwly**
Pasthënia **Laurent Matthey**

ISEAL
2017

ISEAL

Institut Suisse d'Etudes Albanaises
Istituto Svizzero per gli Studi albanesi
Instituti Zvicëran i studimeve shqiptare
Schweizerisches Institut für albanische Studien

Departamenti i Botimeve ISEAL

Përgjegjës për botime: Driton Kajtazi, drejtor i ISEAL-it

Përkthimi nga gjermanishtja: Kujtim Shabani

Redaktimi gjuhësor: Sulejman Dërmaku

Faqosja: Labinot Hasani

Leximi kontrollues: Arbesë Hoxha

Titulli në origjinal: *Image-Entwicklung der Albaner in den Schweizer Medien*

Foto: © BETOGJENI

Përmbajtjet e botimit reflektojnë pikëpamjet e hartuesit
dhe jo domosdoshmërisht ato të ISEAL-it

Botimi në gjuhën shqipe me përkrahjen e:



IMAZHI I SHQIPTARËVE NË MEDIET ZVICERANE

PËRMBAJTJA

OLIVIER MEUWLY: PARATHËNIE	7
KUJTIM SHABANI: NGA PUNËTORË NË NJERËZ.....	11
10 INTERVISTA.....	37
ALAIN MAILLARD: NJË IMAZH NË REHABILITIM.....	81
LAURENT MATTHEY: PASTHËNIE.....	91

PARATHËNIE

Imazhi i një popullate, e cila imigron në një shoqëri të caktuar nikoqire, me kalimin e kohës mund të ndryshojë fort. Alkimia që duhet të lindë nga ballafaqimi i grupeve njerëzore me traditat dhe doket e tyre të shumta, nuk mund të dalë ndryshe, përveçse komplekse. Një shoqëri e vendosur prej dekadash apo shekujsh në një territor, kurrë nuk është e prirur që spontanisht t'i hapet të panjohurit, të huajit. Këtë e provon historia e njerëzimit. Një shoqëri lirohet nga mekanizmat e saj mbrojtës dhe pa problem u uron mirëseardhje njerëzve nga anë të tjera. Nëse ata arrijnë në një numër të kufizuar: pa ndonjë presion të madh, këta njerëz në të shumtën e rasteve ndihen të aftë për të integruar në ambientin e tyre jetësor njerëz që vijnë me historinë, doket dhe nganjëherë me traumat e tyre. Edhe nëse ardhja e tyre i plotëson nevojat ekonomike të shoqërisë, proceset e integritimit zhvillohen në etapa, ndërsa shpesh është e rrezikshme që ato të kalohen tepër shpejt. Proceset vështirësohen befasisht, sapo numri i të ardhurve merr përmasa të «konsiderueshme», ndërsa ky tregues nuk mund të kuantifikohet në mënyrë precize...

Zvicra sigurisht nuk përbën ndonjë përjashtim nga ky rregull. Italianët, të cilët duheshin në kantieret dhe fabrikat e vendit tonë, nuk janë pranuar gjithmonë sikurse që e meritonin. Ky problem u përsërit në vitet 1980 me tamilët dhe më vonë, kur shpërthyen luftërat ballkanike, me kosovarët. Aftësisë së të ardhurve për t'iu përshtatur ambientit në të cilin dëshirojnë të integrohen, u përgjigjet gatishmëria e «autoktonëve» për ta perceptuar ambientin e tyre të ndryshuar nga një perspektivë tjetër. Për sa u përket kosovarëve, një hapësirë duhet t'u rezervohet atyre që shpesh u tërhoqën te prindërit apo të afërmit e vendosur prej kohësh në Zvicër. Kjo çoi në një rrezik të madh, apo në një keqkuptim: Përse të ardhurit e rinj nuk sillen detyrimisht sikurse pararendësit e tyre, edhe nëse faktori religjioz në skenën ndërkombëtare sjell një masë shtesë pasigurie dhe nga fillimi i viteve 2000 është armiqësor ndaj sekularizimit të shoqërisë së atëhershme? Cilit islam i përkasin shqiptarët? Pyetja është absolutisht e drejtë. Po fillon një kohë e gjatë e njohjes së ndërsjellë, e cila mund të fshehë befasi të këqija, por para së gjithash të mira. Dhe, Zvicra ofron një sërë shembujsh të këtillë.

Këtu ndërmjet hyn realiteti lokal, i cili e gjen veten të konfrontuar me kundërthëniet, brengat dhe konfliktet e veta. Një realitet, ku të ardhurit mund të bien pre e tij pa dijeninë e tyre.

Në Zvicër, sikurse në vendet e tjera perëndimore, te një numër i nënshtetasve është zhvilluar një lloj detyrimi moral kundrejt ndonjë popullate të huaj, sigurisht ndaj atyre, të cilët jetonin në atëherë të ashtuquajturën Botë e Tretë. Lëvizje antiraciste dhe lëvizje të Botës së Tretë vendosmërisht luftonin për një hapje bujare të kufijve dhe për një pranim të gjerë të popullatave të shtypura, të cilat ishin në kërkim të një strehe të sigurt, ndoshta të një pune. Azili u ngrit si një e drejtë themelore e njeriut dhe vendet perëndimore, shumë syresh ish-kolonizatore, apo të shikuara si bashkautore të imperializmit, në politikën e tyre duhej t'i përmbushnin këto kërkesa morale ndaj të huajve. Ky parim kryesisht u pranua deri në ditën kur vështirësitë ekonomike sollën një dergjë shoqërore, përmes së cilës imigrimet e reja u perceptuan në një dritë tjetër. Pranimi i migrantëve, në kuptimin e arritjes së qëllimeve të vendosura nga shoqëritë perëndimore, në emër të një miksi kulturor, i cili kuptohej si një matriks i ripërtëritjes së Perëndimit, bazohej në refuzimin e ndjenjës nacionale si dhe në të drejtën e banorëve me banim tashmë prej kohësh që të jenë krenarë për vendin e tyre.

Si duhet të organizohet bashkëjetesa ndërmjet atyre popullsive të ndryshme në këto kushte? Integrimi i grupeve të reja në një «tokë pjellore», mund të ndodhë vetëm me maturi. Një ndërmarrje e vështirë, që Zvicrës, pavarësisht nga të gjitha, nuk po i ecën keq. Kjo falë sistemit të saj federal, i cili lejon trajtimin e problemeve nga distanca më e afërt, konform kushteve vendore, jo sipas skemave abstrakte dhe falë sistemit të saj politik të demokracisë gjysmëdirekte, i cili, pavarësisht nga referendumet nganjëherë për keqardhje, e lejon trajtimin e frikërave me një shpejtësi të cilën vendet e tjera nuk e njohin.

Një integrim i mirë do kërkimin e vazhdueshëm të të gjitha palëve të përfshira, sipas një baraspeshe të rregulluar ndërmjet tolerancës dhe përshtatjes. Mesazhi i transmetuar të ardhurve nuk mund t'i ikë këtij parimi. Të ardhurit e rinj mund të vuajnë nën këshilla të papërshtatshme. Banorët dhe migrantët duhet të mësojnë t'i drejtohen njëri-tjetrit, përndryshe konflikti është i paraprogramuar. Dhe, në këtë proces, një rol luan ndjenja! Mohimi i saj do të shpjerë në dobësimin e «trupit social», duke krijuar një kornizë pak të përshtatshme për nevojat e vërteta të të ardhurve.

Paradoksi është tepër i qartë: Një ndjenjë e mohuar kombëtare mund t'i dëmtojë të ardhurit. Puna është që atë ta bësh pjesë të një solidariteti të ri, i cili do ta shporrte mbajtjen artificiale të partikularizmit, i cili nganjëherë duhet t'i shfuqizojë të drejtat legjitime të të gjithë atyre që i pranon, dhe nganjëherë i duhet t'i pranojë Zvicra.

Dr. Olivier Meuwly

Historian, avokat

Anëtar i Këshillit të Fondacionit të ISEAL-it

Kujtim Shabani

NGA PUNËTORË NË NJERËZ

PIKËNISJA

Më 2003 opinionin zviceran e befasoi një njohje: U gjet që të rinjtë me sfond migracioni nga të ashtuquajturat vende të treta, pavarësisht nga aftësitë dhe zhvillimi i njëjtë, janë të diskriminuar në kërkimin e punës. Kjo vlente sidomos për shqiptarët që vinin nga ish-Jugosllavia. Ata disfavorizoheshin me 24 për qind në Zvicrën perëndimore dhe me 59 për qind në Zvicrën gjermane. Kjo nuk ndodhte në këtë masë me asnjë grup tjetër migracioni, të cilat u përfshinë në studim.

Ky mosbesim kundrejt shqiptarëve gjithashtu shprehet në një tjetër aspekt thelbësor të jetës. Një studim i *National Coalition Building Institute*, i autorizuar nga organizata «Gewählte Stimme», provon vështirësitë me të cilat ballafaqohen shqiptarët gjatë kërkimit të një banese. Ky hulumtim kishte konstatuar një diskriminim neto shumë të lartë të shqiptarëve.

Një vit më vonë, xhiron e botës në mediet zvicerane e bëri gjetja e një studimi të Departamentit të Brendshëm, sipas të cilit çereku i njerëzve në Zvicër kanë një qëndrim armiqësor ndaj të huajve. Kjo shprehet sidomos në vendin e punës, ku, megjithatë, fqinjët janë të favorizuar. Kryetitulli ishte: Vetëm 25 për qind e zviceranëve duan të kenë të bëjnë me shqiptarët në punë (Basler Zeitung, 2015). (Në asnjërin prej këtyre artikujve të gazetave nuk ka një referencë të titullit dhe hartuesit të studimit. Përveç kësaj, studimi nuk mund të shkarkohet nga platforma e botuesit.)

Qëndrimi ndaj shqiptarëve në opinionin publik ndërkohë duhet të ketë ndryshuar. Gjithsesi mund të vërehet një raportim më i moderuar për shqiptarët në mediet zvicerane. Nga fundi i marsit të këtij viti, një artikull i «Aargauer Zeitung», i cili e vlerëson performancën e shqiptarëve në Zvicër, ka bërë një karrierë të mirëfilltë në shumë medie zvicerane. Sipas tij, ngasjet e tërbuara me vetura, martesat e detyruara, hakmarrja dhe zakone të tjera të këqija, që u vishen shqiptarëve, ndërkohë i takojnë së kaluarës. Pjesëtarët e këtij komuniteti në Zvicër i dedikohen me pasion sportit. Përveç kësaj, numri i studentëve shqiptarë në universitetet zvicerane është rritur ndjeshëm. Në të vërtetë, kërkimi në makinat elektronike nuk nxjerr të njëjtin numër të artikujve që raportojnë për deliktet e shqiptarëve, si para një kohe. Artikulli ka përjetuar një rezonancë të tillë, kështu që redaksia, si një gjest i

rrallë, vendosi që atë ta botonte edhe në shqip (Fuchs, 2016). Ai erdhi si një përgënjeshtim i pllakatit të Partisë Popullore Zvicerane me mbishkrimin «Kosovarët therin zviceranin».

Së fundmi, magazina «Beobachter» fokusin e numrit 9 të këtij viti ua kushton shqiptarëve të Zvicrës. Ai konstaton se shqiptarët kanë një nam të keq. Sipas tij, shtypi bulevardesk raporton me kënaqësi për deliktet e shqiptarëve. Përtej kësaj, këtu ishte e përfshirë edhe politika; kështu Partia Popullore Zvicerane, me pllakatin «Kosovarët therin zviceranin», u mundua që një rast të tillë ta kapitalizonte për një kauzë politike. Magazina pyet se si jetojnë shqiptarët me këtë imazh dhe kujton që ndërmjet heronjve të futbollit dhe parazitëve të sistemit social ka edhe një shumicë sunduese, e cila dëgjohet rrallë.

Nga këto pak momente lidhur me shqiptarët në Zvicër, del qartë që ky grup migracioni po ballafaqohet me një imazh të dëmtuar. Është një ndjenjë, e cila ishte përhapur edhe në mesin e pjesëtarëve të këtij komuniteti dhe që si duket është shndërruar në një kompleks të inferioritetit. Në kuadër të një punimi nga viti 2004 lidhur me statusin e integritit të shqiptarëve në Zvicër, disa prej të intervistuarve e pohonin se shpesh e fshihnin identitetin e tyre kombëtar dhe fetar. Për të shmangur keqkuptimet, ata gjuhën e nënës nuk e përfshijnë në jetëshkrimet e tyre (Shabani, 2016).

Ky trajtim ka për qëllim që në qendër të interesit ta vendosë, para së gjithash, atë shumicë të prekur, e cila në mënyrë të pamerituar del si bartëse më e madhe e pasojave të një imazhi të dëmtuar. Një duzinë personalitetesh zvicerane, të cilat shquhen për njohjet e tyre në fushën e zhvillimeve shoqërore, diskutojnë për shkaqet e këtyre situatave dhe për rrugëdaljet. Ata i shpjegojnë përvojat e tyre me shqiptarët dhe i diskutojnë proceset shoqërore e politike në lidhje me qenien e grupit të migrantëve shqiptarë në Zvicër. Janë perspektiva të ndryshme ndërdisiplinore, të cilat mëtojnë të hapin një debat sensibilizues lidhur me një problematikë që i përket integritit të grupit të migrantëve shqiptarë dhe bashkëjetesës në shoqërinë zvicerane.

Në vazhdim pason një paraqitje e pranisë së emigracionit shqiptar në Zvicër. Më pas vjen një shkoqitje e perceptimit të ndërsjellë të zviceranëve dhe të këtij komuniteti. Pistën për te intervistat me bashkëbiseduesit e përbën tematizimi i teorive për imazhin e shqiptarëve në Zvicër.

PUNËTORË DHE NJERËZ

Në fillim shqiptarët në Zvicër erdhën vetëm, si fuqi punëtore. Më pas i tërhoqën edhe familjet e tyre. Një pjesë e madhe e migrantëve shqiptarë duhej të kalonin një rrugë të vajtueshme deri këtu. Shumica e njerëzve të këtij grupi migrantësh vijnë nga ish Jugosllavia; kryesisht nga Kosova, por edhe nga Maqedonia, ku ata përbëjnë rreth një të tretën e popullsisë dhe nga jugu i Serbisë si dhe nga Mali i Zi, ku ata pjesërisht përbëjnë minoritete të konsiderueshme. Në fund, në Zvicër kanë ardhur edhe migrantë nga Shqipëria dhe, ndërkohë, tani të gjithë ata disi janë bërë pjesë e shoqërisë zvicerane dhe të historisë së saj më të re.

KONTEKSTE TË MIGRIMIT TË SHQIPTARËVE NË ZVICËR

Shqiptarët në Zvicër – kjo është një histori 50-vjeçare. Dihet që shqiptarët e parë në Zvicër kanë arritur në vitet 1960. Në fillim, në kuadër të një migracioni të punës nga ish-federata jugosllave. Dhe, shqiptar është një vetëreferim dhe referim nga të tjerët për ata, të cilët shqipen e kanë gjuhë nëne. Këta migrantë, kryesisht nga Kosova dhe Maqedonia, në fillim ishin popullorë në Zvicër. Ata fitonin pak dhe me këtë e financonin jetesën dhe shkollimin e të afërmeve të tyre në vendlindje. Në Zvicër ata e gëzonin statusin e stinorit, i cili ua mundësonte atyre të qëndronin nëntë muaj në vend. Lejet e tyre të punës duheshin përtëritur çdo vit. Profili social i këtyre shqiptarëve të parë nga ish-Jugosllavia ishte ai i një grupi popullate të paprivilegjuar dhe të diskriminuar: të rinj dhe me një shkollim modest. Fokusi i tyre jetësor ngeli vendlindja.

Situata e keqe në vendlindje dhe nevojat e ekonomisë së këtushme sollën migrantë të tjerë shqiptarë në Zvicër. Në vitet 1970 dhe 1980 numri i tyre në Zvicër u rrit. Ata edhe më tej njiheshin si jugosllavë dhe vlenin si punëtorë shembullorë. Pas disa vjet qëndrimi në Zvicër, avancoi statusi i stinorit, kështu mund të tërhiqej në Zvicër edhe familja. Ky hap shënon një kthesë në historinë zvicerane të migrimit. Nga ky kontekst del fjalja legjendare e shumëcituar e Max Frisch-it: «Kërkuam fuqi punëtore dhe erdhën njerëz». Migrantët shqiptarë, të cilët fillimisht në Zvicër do të punonin vetëm ndonjë vit për të çuar pastaj në vendlindje një jetë më të mirë, i ndryshuan planet dhe i

sillnin gjithnjë e më shumë anëtarët e familjes në Zvicër. Bashkimet familjare, nga njëra anë, u nxitën prej tensioneve sociale dhe politike në vendlindje, nga ana tjetër, pasuan si një reagim ndaj politikës së re zvicerane për migracionin në fillim të viteve 1990, e cila praktikisht e pezulloi migracionin e punës me ish-Jugosllavinë. Çfarë ngeli, ishte azili. Gjendja politike në Kosovën e viteve 1990 u ashpërsua radikalisht. Statusi juridiko-politik, i cili Kosovës i siguronte një autonomi në kuadër të federatës jugosllave, u suprimua. Të gjithë të punësuarit në sektorin publik u pushuan nga puna, ndërkohë që në Kosovë nuk kishte ndonjë sektor privat për të qenë dhe papunësia e shqiptarëve ishte edhe ashtu më e lartë se ajo e pakicave. Në shkolla u ndalua mësimi në gjuhën shqipe, dhuna ishte e gjithëpranishme. Ishin sidomos të rinjtë që kërkonin azil në Zvicër; ata u arratisën nga shërbimi ushtarak, i cili shpeshherë rrezikonte t'i shpinte në ndonjë luftë. Prandaj edhe për këtë zgjidhej Zvicra, sepse shumë prej tyre kishin të afërm këtu, të cilët ishin vendosur aty vite më parë. Megjithatë, dhe ky më vonë do të dëshmohej si një moment i rëndësishëm, ata u vendosën në strehimore të përbashkëta dhe nuk kishin të drejtë të punonin. Shumica e kërkesave të azilit u refuzuan, por aplikantët duhej të pranoheshin përkohësisht, sepse autoritetet jugosllave e refuzonin kthimin e tyre. Vendimtare për numrin e paparë deri atëherë të kërkesave të azilit në Zvicër u dëshmuua sidomos përhapja e luftës në Kosovë në vitet 1998/99. Në këtë kohë 50.000 veta nga Kosova kishin kërkuar azil në Zvicër. Atyre iu sigurova një pranim i përkohshëm dhe menjëherë pas mbarimit të konfliktit ajo e lancoi një program rikthimi, i cili ua mundësonte risistemimin në vendlindjen e vjetër. Shumica, megjithatë, e lëshuan vendin vullnetarisht. Ndërkohë 4.000 azilkërkues kosovarë përfituan nga një aksion i vitit 2000 të Qeverisë dhe mundën ta rregullonin qëndrimin në Zvicër. Shumica e kosovarëve, të cilët në Zvicër kanë migruar në vitet 1990, qëndrimin e tyre këtu e kanë falë modelit të bashkimit familjar. Por, procesi i migrimit nga Kosova dhe ish- Jugosllavia nuk ka përfunduar dhe mekanizmat ngelin të njëjtë. Përmes bashkimit familjar, që nga viti 2000 për çdo vit nga Kosova, Serbia e Mali i Zi në Zvicër kanë ardhur rreth 4.000 veta. Migracioni i punës kufizohet vetëm në fuqinë e specializuar punëtore. Migrimi politik, sikurse edhe azili për shkaqe ekonomike, ndërkohë është bërë i pashpresë; rajoni nga vijnë shqiptarët klasifikohet si i sigurt¹.

¹ Ky elaborim bazohet sidomos tek Maillard/Leuenberger 1999, von Aarburg/Gretler 2008 dhe Burri et al. 2010.

Migracioni nga Shqipëria në Zvicër është relativisht i ri, ai ka filluar pas ndryshimit të sistemit, në fillim të viteve 1990. Ky migracion i detyrohet modelit të azilit dhe të bashkimit familjar. Shqiptarët e parë, pas ndërrimit të sistemit, vendin e tyre e kanë lëshuar si azilkërkues politikë dhe ekonomikë, ndërsa janë shpërndarë në gjithë botën. Më vonë u zhvillua motivi i gjakmarrjes, e cila në disa rajone të Shqipërisë është shumë e përhapur. Numri i migracionit nga Shqipëria, me deri 150 veta në vit, ishte diçka më i fortë në vitet 1993 deri 2003 dhe u ngrit përsëri në këtë nivel pas liberalizimit të vizave në vitin 2010. Më 2014 janë 190 veta me shtetësi shqiptare që kanë ardhur në Zvicër, dhe ky paraqet kulmin e migrimin të tyre në Zvicër që nga fillimi².

SHQIPTARËT NË ZVICËR – NJË PEIZAZH

Në vitin 1980, në Zvicër mund të takojë 15 shqiptarë në kuptimin e shtetësisë. Deri në vitin 1991 prania e tyre shprehej në numra dyshifrorë. Më 1992, pas ndërrimit të sistemit në Shqipëri, Zvicra numëronte 123 shtetas shqiptarë. Më 1999, ata për herë të parë kapën numra katërshifrorë dhe ngeli me kaq: Më 2014, në Zvicër jetonin 1.488 shqiptarë si të tillë. Në vitin 2010 këta përnjëherë u tejkaluan nga 58.755 shqiptarë kosovarë, një pjesë e të cilëve më 1980 strukeshin të 44.094 ish-jugosllavët, më 1994 e përbënin shumicën e 24.891 maqedonasve dhe në vitin 2001, kurnukmblidheshin në të dhënanën konceptin e ish-Jugosllavisë, u përfshinë të 190.940 emigrantët nga Serbia e Mali i Zi³. Më 2014, në Zvicër, përveç këtyre 1.488 shtetasve shqiptarë, jetonin edhe kryesisht 99.799 kosovarë. Megjithatë, shumicën e 63.516 maqedonasve dhe pakicën e 78.092 shtetasve të Serbisë së 2014-tës në Zvicër e përbënin shqiptarët. Vlerësohet se 70 për qind e shqiptarëve që jetojnë në Zvicër vijnë nga Kosova, 25 për qind nga Maqedonia dhe 5 për qind nga Shqipëria e Serbia jugore (Beobachter, 2016: 22-23).

Shqiptarët identifikohen dhe definojnë përmes gjuhës së nënës. Nëse ndërrohet paradigma dhe i referohet gjuhës së popullatës së rregullt të

² Einwanderung der ständigen Wohnbevölkerung nach Staatsangehörigkeit, 1991-2014. Quellen: 1991-2010: ESPOP & PETRA, ab 2011: STATPOP. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

³ Ständige ausländische Wohnbevölkerung nach Staatsangehörigkeit, am Ende des Jahres 1980-2014. Quellen: PETRA (1980-2009), STATPOP (ab 2010). © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

Zvicrës, në vitin 2014 e japin 3 për qind e 8.236.666 banorëve si gjuhë të parë shqipen⁴. Referuar gjuhës kryesore, albanofonët mbi 15 vjeç në popullsinë e rregullt të Zvicrës më 2014 përbënin 174.102 persona. 25.653 prej tyre janë vendosur në regjionin e Liqenit të Gjenezës, 32.769 në Zvicrën e Mesme, 29.387 në atë veriperëndimore, 40.417 në Cyrih, 32.165 në Zvicrën Lindore, 18.198 në Zvicrën Qendrore dhe 2.874 e këtyre jetojnë në Tesinë⁵.

Zaten: 25.301 veta të popullsisë së rregullt zvicerane, nga 0 deri 14 vjeç, prej të cilëve 23.905 të lindur në Zvicër dhe 1.396 jashtë saj, vijnë nga Kosova. Ndër 10 shtetësitë më të shpeshta dhe nga gjithsej 1.224.981 veta të kësaj moshe përmendet edhe Maqedonia me 15.198 persona deri 14 vjeç, me ç'rast shumica e tyre – 14.333 kanë lindur në Zvicër dhe 865 jashtë.

Ndër 10 shtetësitë më të shpeshta në popullatën e rregullt zvicerane mbi 15 vjeçe, Kosova vjen me 43 burra dhe 36 gra në 1.000 banorë. Nga këto 37, përkatësisht 32 bëjnë pjesë në gjeneratën e parë dhe 6 burra e 4 gra në të dytën. Maqedonia këtu paraqitet me 25 burra dhe 23 gra. Nga këta 23 burra dhe 20 gra vendosen në gjeneratën e parë, kurse 2 burra dhe 2 gra bien në gjeneratën e dytë të këtij grupi migrantësh⁷.

Interesimi për shtetësinë zvicerane te shqiptarët ka filluar relativisht herët. Shqiptari i parë në kuptimin e shtetësisë, shtetësinë zvicerane e ka fituar në vitin 1987. Kjo në një numër dyshifror avancoi vetëm në vitin 1998, me 12 persona. Kulmin e përbën viti 2007 me 109 natyralizime, nga të cilët 48 burra dhe 61 gra. Vetëm mund të hamendësohet që ndonjëri prej 492 shtetasve të ish-Jugosllavisë, që më 1981 e fituan shtetësinë zvicerane, ishte shqiptar etnik. Kosova për herë të parë në statistikën e shtetësisë zvicerane shfaqet në vitin 2010 me 1.611 raste, nga të cilët 816 burra dhe 796 gra. Ndërsa numrat e natyralizimit të shtetasve kosovarë rriten në mënyrë lineare, tek ata të Maqedonisë bie në sy viti 2006 me 2.596 shtetësi të fituara; nga të cilët 1.360 burra dhe 1.236 gra⁸.

Më 2014, shtetësinë zvicerane e kanë fituar 40 shtetas të Shqipërisë. Kategoria më e shpeshtë e qëndrimit të tyre në Zvicër është 5-9 vjet; 10 prej këtyre

⁴ BFS – Strukturerhebung (SE).

⁵ Strukturerhebung 2014. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

⁶ Ständige Wohnbevölkerung im Alter 0 bis 14 Jahren nach Geburt und Staatsangehörigkeit, 2014. Quelle: STATPOP. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

⁷ Ständige Wohnbevölkerung ab 15 Jahren mit Migrationshintergrund, nach Generationenstatus, Staatsangehörigkeit und Geschlecht, 2014. Quelle: Schweizerische Arbeitskräfteerhebung (SAKE). © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

⁸ Erwerb des Schweizer Bürgerrechts (Männer u. Frauen) nach früherer Staatsangehörigkeit, 1981-2014. Quelle: 1981-2010: PETRA, ab 2011: STATPOP. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

kanë lindur në Zvicër. Në të njëjtin vit, shtetësinë zvicerane e kanë fituar 2.622 shtetas kosovarë; 468 veta, dhe kjo është kategoria më e shpeshtë, kanë një stazh qëndrimi prej 15-19 vjetësh në Zvicër; kurse 1.186 prej tyre kanë lindur në Zvicër. Maqedonia më 2014 vjen me 1.279 natyralizime në Zvicër; kategoria më e shpeshtë e qëndrimit në Zvicër është 20-24 vjet; ndërsa 538 e të gjithë shtetasve rishtarë kanë lindur në Zvicër. Totali i të gjitha shteteve është 32.836 veta të natyralizuar⁹.

Vështruar nga pikëpamja e vendit të lindjes, shtetësisë dhe gjinisë, në statistikat e viteve 1981-2014, Shqipëria paraqitet me 2.446 veta: 1.141 burra dhe 1.305 gra. Në total u natyralizuan 707 persona – 313 burra dhe 394 gra; 828 burra dhe 911 gra e gëzojnë statusin e migrantit. Më tej, në popullatën e rregullt të Zvicrës bëjnë pjesë 76.792 kosovarë, të cilët kanë lindur atje; prej të cilëve 40.292 burra dhe 36.500 gra. 21.689 veta – 11.311 burra dhe 10.378 gra – janë natyralizuar në Zvicër; 55.103 të tjerë – 28.981 burra dhe 26.122 gra – jo. 59.193 qytetarë të Maqedonisë, që kanë lindur atje, jetojnë në Zvicër; 30.572 prej tyre janë burra, kurse 28.621 gra. Janë natyralizuar 16.134, nga këta – 8.427 burra dhe 7.707 gra. Shumica e tyre, 43.059 veta, prej të cilëve 22.145 burra dhe 20.914 gra, nuk e kanë shtetësinë zvicerane¹⁰.

Në një bilanc të viteve 1991-2014, në Zvicër janë martuar 32 shtetas shqiptarë. Në 5 raste me gra të së njëjtës shtetësi, në 18 të tjera gruaja ka qenë zvicerane dhe në 9 raste – një e huaj tjetër. Kosovarët prijnë në mesin e komuniteteve shqiptare me 1.095 martesë në Zvicër; në 363 raste gratë e kanë të njëjtën prejardhje, në 593 raste të tjera gruaja është zvicerane. Ngjashëm ndodh edhe me martesat e shtetasve nga Maqedonia, vetëm se në përmasa më të vogla: 434 martesë, në 148 raste bashkëshortja i ka të njëjtat rrënjë, 229 herë bëhet fjalë për zvicerane¹¹. Njëkohësisht, në këtë hark kohor në Zvicër janë martuar 53 shtetase shqiptare. Të përzgjedhurit e tyre në 5 raste kanë qenë shqiptarë, ndërsa në 23 zviceranë. 846 kosovaret, të cilat kanë vënë kurorë në këtë periudhë në Zvicër, në 363 raste kanë marrë për burrë një bashkatdhetar dhe në 398 raste të tjera një zviceran. 394 qytetare nga Maqedonia në 148 raste kanë vënë kurorë me një burrë nga vendlindja e tyre, në 181 të tjera – me një

⁹ Erwerb des Schweizer Bürgerrechts nach früherer Staatsangehörigkeit, Geburtsort und Anwesenheitsdauer, am 31.12.2014. Quelle: STATPOP. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

¹⁰ Ständige Wohnbevölkerung nach Geburtsstaat, Staatsangehörigkeit und Geschlecht, 2014 Quelle: STATPOP. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

¹¹ Ehe schliessende Frauen nach gegenseitiger detaillierter Staatsangehörigkeit des Ehemannes, 2014. Quelle: BEV-NAT. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

zviceran¹². Shqiptarët dhe shqiptaret, jo vetëm janë martuar në të shumtën e rasteve me zvicerane dhe zviceranë, edhe në rastin e ndarjeve zviceranet dhe zviceranët paraqiten më shpesh si të ndarë; edhe pse shifrat janë më të ulëta. 11 shtetas shqiptarë (para martesës) janë shkukurëzuar në këtë hark kohor; në një rast gruaja e kishte të njëjtën shtetësi (gjithashtu para martesës), në 7 raste ishte zvicerane. Më 2014 janë ndarë 96 kosovarë. Në 13 raste bashkëshortja vinte nga i njëjti vend, në 68 të tjera ajo ishte zvicerane¹³. 73 çifte janë ndarë, ku burri kishte shtetësi maqedonase; në 13 raste gruaja ishte nga i njëjti vend, kundrejt 48 të tjerave që ajo ishte zvicerane. Në anën tjetër, nga 14 shkukurëzime grash shqiptare, në një rast bashkëshorti ishte bashkëkombës, në 7 raste zviceran. 54 kosovare janë ndarë prej bashkëshortëve të tyre; në 13 raste bëhej fjalë për burra me të njëjtën shtetësi, në 32 ata ishin zviceranë. Kjo ka ndodhur 48 herë me shtetase të Maqedonisë: në 13 raste burri e kishte të njëjtën vendlindje, në 27 raste ishte shtetas zviceran¹⁴. Nuk gjenden statistika për shumë fusha në mënyrë të detajuar sipas shtetësisë. Një tjetër që ekziston quhet: «Lindje të gjalla sipas përkatësisë së detajuar shtetërore të fëmijës». Lindja e parë e shënuar e një fëmije me shtetësi shqiptare në Zvicër ka ndodhur në vitin 1987. Në vitin 1991 ishin 12 dhe deri më 2014 kjo ngel një numër dyshifror: 31. Mund të supozohet se ndër 1.304 lindjet e regjistruara të fëmijëve me shtetësi ish-jugosllave të vitit 1983 gjenden edhe shqiptarë etnikë. Sikur edhe me 302 lindjet e fëmijëve me shtetësi maqedonase të vitit 1994, numri i të cilave më 2014 shkonte në 1.182. Kosovarët për herë të parë shfaqen në statistika më 2010 me 1.735 lindje në Zvicër, dhe më 2014 ishin 2.146. Totali i të gjitha shteteve më 2014 ishte 85.287¹⁵.

Është evidentuar edhe sa veta kanë emigruar nga Zvicra. Sado atipike të duket, statistikat nxjerrin se që nga 1991, çdo vit një numër dyshifror shtetasish shqiptarë e kanë lëshuar Zvicrën; më së shumti më 2014: 73 persona. Më 2010, kosovarët duken në statistika me 131 të migruar. Nga kjo kohë, ky numër ka shkuar duke u rritur, në vitin 2014 janë 451 shtetas

¹² Ehe schliessende Männer nach detaillierter Staatsangehörigkeit der Ehefrau, 2014. Quelle: BEVNAT. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

¹³ Scheidungen von Frauen nach detaillierter Staatsangehörigkeit der Männer 2014. Quelle: BEVNAT. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

¹⁴ Scheidungen von Männern nach detaillierter Staatsangehörigkeit der Frauen vor der Heirat, 2014. Quelle: BEVNAT. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

¹⁵ Lebendgeburten nach detaillierter Staatsangehörigkeit des Kindes, 1970-2014. Quelle: BIVANT. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

kosovarë që e kanë braktisur Zvicrën. Shtetasit maqedonas filluan më 1993 me largimin e 25 vetave; dy vjet më pas janë 627. Ky trend vazhdon deri më 2001, kur vendi u përfshi në një konflikt të armatosur, atëherë ndalon lëshimi i Zvicrës. Më 2014 ishin 390 shtetas maqedonas të migruar. Më 2014 kanë migruar 1.184 shtetas të Serbisë dhe 44 malazez ¹⁶. Nga 73 shtetasit shqiptarë të larguar nga Zvicra më 2014, 31 ishin burra, kurse 42 gra. Mosha më e shpeshtë është ajo ndërmjet 20 dhe 39 vjeç. Ndërkaq 292 prej kosovarëve të larguar nga Zvicra më 2014 janë burra dhe 169 gra. Mosha më e shpeshtë, në 276 raste, është përsëri ajo 20 deri 39 vjeç. Te të migruarit me shtetësi të Maqedonisë qenë 241 burra dhe 149 gra; këtu mosha më e shpeshtë e të larguarve është më e lartë: 40 deri 64 vjeç¹⁷. Një numër shqiptarësh e kanë lënë jetën në Zvicër. Dy rastet e para të vdekjes së shtetasve shqiptarë në Zvicër janë regjistruar në vitin 1987, dhe numri i tyre ngel njëshifror deri në vitin 2014: dy burra, një grua. Mund të besohet që në 94 rastet e vdekjes në Zvicër shtetasish ish-jugosllavë, të regjistruara për herë të parë më 1983, bëjnë pjesë edhe shqiptarë etnikë, sikur edhe ndër 13 personat me shtetësi maqedonase më 1994. Numri i këtyre të fundit me kalimin e viteve shënon një rritje të lehtë, dhe më 2014 janë 81 veta: 47 burra dhe 34 gra. 79 rastet e vdekjeve të personave me shtetësi kosovare për herë të parë paraqiten më 2010; më 2014 janë 128 vdekje kosovarësh këtu: 82 burra dhe 46 gra¹⁸.

PERSPEKTIVA SHQIPTARO-ZVICERANE

Integrimi, që është thelbi i këtij diskutimi, është një proces i ndërsjellë, në të cilin që të dyja palët – shoqëria nikoqire si migrantët – kanë për të dhënë një kontribut. Në rrafshin e këtij plani, që të dyja e plotësojnë imazhin e statusit të integrimit të shqiptarëve në Zvicër: Perceptimi i Zvicrës dhe njerëzve të saj nga këndvështrimi i migrantëve, në këtë rast i shqiptarëve, dhe anasjelltas.

¹⁶ Auswanderung der ständigen Wohnbevölkerung nach Staatsangehörigkeit, 1991-2014. Quellen: 1991-2010: ES-POP & PETRA, ab 2011: STATPOP. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

¹⁷ Auswanderung der ständigen ausländischen Wohnbevölkerung nach Staatsangehörigkeit, Geschlecht und Alter, 2014. Quelle: STATOP. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

¹⁸ Todesfälle nach detaillierter Staatsangehörigkeit, 1970-2014. Todesfälle (Männer u. Frauen) nach detaillierter Staatsangehörigkeit, 1987-2014. Quelle: BEVNAT. © BFS – Statistisches Lexikon Schweiz.

ZVICERANËT NGA PERSPEKTIVA SHQIPTARE

Në perceptimin e shqiptarëve për Zvicrën dhe qytetarët e saj, fillimisht, para së gjithash, shprehet lavdërim për rendin që mbretëron në vend, përpikërinë, pastërtinë, funksionimin e përkryer të institucioneve, standardin e lartë jetësor etj. Këto aspekte spikatin sidomos nga krahasimi me situatën në vendlindjen e tyre. Kontrasti me të relativizohet me një qëndrim më të gjatë në Zvicër. Me kalimin e kohës, ata e shohin njëfarë distancimi të zviceranëve, mungesën e spontanitetit në mënyrën e tyre të jetesës etj. Përshtypjet e shprehura për Zvicrën varen nga situata jetësore në Zvicër dhe përvojat që kanë pasur. Pastaj vijnë ankesat lidhur me trajtimin e rreptë të azilkërkuesve në qendrat përkatëse. Të tjerë raportojnë për mungesën e perspektivës në tregun e punës. Përmenden edhe shprehje, si ksenofobia dhe indiferenca. Si pasojë e këtyre përvojave negative, mirënjohja për kontributin e Zvicrës është pastaj edhe më e madhe (Schader, 2005 n.v.).

Imazhi i zviceranëve dhe i Zvicrës për shqiptarët gjithsesi varet nga përvojat individuale, kushtet e jetesës, koha e qëndrimit në Zvicër, «prejardhja dhe qëndrimi kulturor personal, dhe modelet e interpretimit të realitetit që lidhen me këtë qëndrim» (po aty: 32). Migrantëve me prejardhje urbane dhe shkolim të mirë u premtohen mundësi më të mira për t'u orientuar në një kontekst adekuat zviceran. Një dallim në këtë kontekst mund të vërehet midis atyre që kanë ardhur rishtazi në Zvicër dhe atyre që kanë lindur këtu.

Për aq sa dihet, nuk ka studime sistematike, të cilat japin informacione mbi vlerësimet e shqiptarëve për Zvicrën dhe qytetarët e saj. Do të ishte fort informative të gjendej si qëndron puna me besimin e shqiptarëve tek institucionet dhe njerëzit në Zvicër.

Mbështetur në një hulumtim kualitativ joreprezantues të vitit 2014 me shqiptarë të moshuar në Zvicër për këtë temë, mund të supozohet se gjysma e tyre u besojnë bashkëqytetarëve. Ndërkaq, gjysma tjetër mendojnë që shumicës së njerëzve më shumë nuk mund t'u besohet. Ata për këtë e citojnë një fjalë të urtë shqiptare: «Besnik bëhu, besë mo zër». Në këto raste qartazi nuk kemi të bëjmë me një situatë optimale, por ky qëndrim në asnjë mënyrë nuk paraqet një refuzim të tjetrit të panjohur. Megjithatë, ofrohet të qenit në dispozicion për të tjerët (Shabani, 2014: 42). Në Zvicër besimi te bashkëqytetarët, nga mesi i viteve 1990 ishte 41 për qind. Në Serbi dhe Mal të Zi, ku hynin edhe shqiptarët e Kosovës, ishte 30,4 për qind. Në Maqedoni, që e reprezenton një pjesë të shqiptarëve, besimi te bashkëqytetarët arrinte

vetëm 8,2 për qind. Të dhëna më të diferencuara për këto tri vende nuk janë të njohura. Besimi i përgjithësuar tek 50-69-vjeçarët në Zvicër në vitin 1989 ishte 40 për qind, ndërsa në vitin 1996 ishte 46 për qind. Tek mbi 70-vjeçarët besimi te bashkëqytetarët në vitin 1989 ishte 36 për qind, ndërsa 42 për qind në vitin 1996 (Freitag, 2001: 100; Freitag, 2005: 580).

Në një shkallë vlerësimi nga 1-5, në të cilën 1 është për besim të ulët dhe 5 për besim të lartë, në intervistimin e shqiptarëve të moshuar në Zvicër, ndërmarrjet, entet e punësimit, mediet dhe sigurimet shfaqin rezultatet më të dobëta. Vlerat më të larta të besimit mesatarisht i shfaq qeveria (4,7), administrata (4,5), drejtësia (4,65), dhe bankat (4,72) (Shabani, 2014: 43). Vlerat relativisht të larta të besimit tek institucionet korrespondojnë aq shumë me tendencat, të cilat u vërejtën në vitet 1990 në hulumtimin e besimit në Zvicër, e që besimi në sistem lidhet me moshën. 50-69-vjeçarët, me 66 për qind në vitin 1989, 44 për qind në vitin 1996 dhe me 48 për qind në vitin 1998, treguan një besim të lartë tek institucionet. Te mbi 70-vjeçarët në vitin 1989 shkalla e atyre që kishin besim të lartë tek institucionet ishte 72 për qind; në vitin 1996 ishte 50 për qind dhe në vitin 1998 – 47 për qind (Freitag, 2001: 100 n.v.).

Këto prova plotësuese janë të nevojshme për aq sa ato i mbështesin gjetjet e reja. Në vlerësimin e institucioneve të veçanta nga migrantët shqiptarë, duhet të kihet parasysh gjithashtu përvojat në vendin e prejardhjes dhe qasja relacionale. Ky qëndrim në mënyrë plotësuese konfirmohet nga rezultatet e një hulumtimi – përsëri joreprezentues – të vitit 2004 me një grup heterogjen prej 35 migrantësh shqiptarë. Për pyetjen se si i vlerësojnë institucionet zvicerane, përgjigjet e 63 për qind të tyre shkojnë nga një besim i lartë; 11 për qind shprehin dyshime, ndërsa 25 për qind e të intervistuarve i çmojnë institucionet, por nuk u besojnë pa kufi (Shabani, 2008: 8).

SHQIPTARËT NGA PERSPEKTIVA ZVICERANE

Në mënyrë të përmbledhur, shqiptarët në Zvicër kanë vuajtur nga një imazh i keq, ndërsa krijimi i këtij imazhi ishte pasojë e korrespondimit të disa zhvillimeve.

Në mënyrë të përsëritur është rikujtuar që migrantët shqiptarë në Zvicër deri nga fundi i viteve 1980 nuk u perceptuan si të tillë. Ata, përgjithësisht, përshkruheshin si «jugosllavë». Këta migrantë të parë shqiptarë vepronin

në sektorë joatraktivë dhe kryenin punë të rënda, për të cilat vendësit nuk ishin në dispozicion. Migrantët e parë shqiptarë jetonin të tërhequr, fitonin pak dhe nuk kërkonin kurrfarë shërbimesh nga shteti. Situata ndryshoi në vitet 1990, kur, me trefishimin e numrit të migrantëve, shqiptarët fituan më shumë rëndësi. Para së gjithash, falë bashkimit familjar, ndryshoi struktura e deritanishme e gjinisë dhe e moshës. Pjesërisht të papunë dhe pa orientim, ata përnjëherë u shfaqën si shqiptarë në fokus të opinionit publik. Këta migrantë shqiptarë gjetën një Zvicër, e cila po kalonte një fazë të stagnacionit ekonomik dhe, sidomos pas shembjes së Perdes së Hekurt dhe hapjes ndaj Lindjes, ishte e zënë me redifinimin e identitetit të vet. Në këto rrethana shumë migrantë shqiptarë ishin të varur nga asistenca sociale. Në këtë kontekst, imazhi i shqiptarëve në Zvicër kishte marrë çarjet e para. Për më tepër, në këtë kohë ishin përhapur deliktet e drogës, për të cilat dyshoheshin rrjete shqiptare. Koncepti tanimë i konotuar negativisht «azilant» lidhej me shqiptarë – zhvatës të sistemit social dhe trafikantë droge. Këtë imazh në një masë të madhe e ka shënjuar edhe raportimi i padiferencuar mediatik (Schader, 2005: 34 n.v., Burri et al., 2010).

Në mënyrë sistematike dallohen tri fusha të perceptimit – kryesisht në rrafshin e veprimeve të shqiptarëve në Zvicër: perceptimi institucional-shtetëror, perceptimi popullor si dhe ai i informimit profesional dhe i studimeve shkencore.

Valët e mëdha të migrimit nga Ballkani paraqitnin sfida të papritura, sidomos për sistemin social dhe shkollor. Këtu bëjnë pjesë numri i madh i të ardhurve, gjendja e tyre e rëndë psikologjike, përgatitjet e këqija shkollore, situata e pashpresë e punësimit, delikuanca etj. Këto probleme Zvicra i ndeshi me një investim prej 500 milionë frangave zvicerane vetëm në vitin 1999, edhe pse jo të gjitha u përdorën për nevojat e tyre. Si një sukses vlen sidomos mbajtja e disa statistikave jo vetëm mbi bazë të shtetësisë, por tanimë mbi bazë të gjuhës së nënës. Në disa kantonte u financuan këshillime speciale, përkthime dhe ndërmjetësime sociale. Gjithashtu u investua në infrastrukturën e shoqatave, të cilat angazhoheshin për takime ndërmjet shqiptarëve dhe zviceranëve. Janë botuar fjalorë shqip-gjermanisht për nxënës shqiptarë dhe tekste të tjera didaktike në shqip. Përveç kësaj, për një kohë u përkrahën disa revista shqiptare me fonde publike. Në disa komuna financohet mësimi plotësues në shqip, dhe nevoja është e madhe – aq më tepër që është provuar se ky ndikon pozitivisht në mësimin e rregullt. Negativisht janë vlerësuar procedurat e azilit, të cilat zgjasnin deri në shtatë vjet. Indinjatë kanë shkaktuar kufizimet

e lejeve të punës për azilkërkuesit. Dhe, përfundimisht, edhe mbajtja larg njëri-tjetrit e anëtarëve të një familjeje, pa përfillur lidhjet e tyre, gjë që është shumë e vlefshme për shqiptarët. Me këtë synohej që azili të bëhej joatraktiv, por që në fakt u ka shkaktuar dhimbje të mëdha migrantëve dhe kosto të larta shtetit. Kjo e ka shkatërruar orientimin e tyre dhe e ka ushqyer delikuecën (Schader, 2005: 35 n.v.). Një hije në marrëdhënien me shqiptarët e Kosovës hedh suspendimi i Marrëveshjes për Sigurimet Shoqërore me Kosovën dhe mosarritja e një marrëveshjeje të re, sikurse u procedua me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Por, fundja, Zvicra është njëri ndër shtetet e para, i cili më 2008 e njohu pavarësinë e Kosovës.

Migrimi masiv i shqiptarëve në vitet 1990, veprat kriminale, shpenzimet për sistemimin e tyre dhe asistencën sociale, si dhe koniunktura e papërshtatshme ekonomike, bënë që emri «shqiptar» në opinionin publik zviceran të konotohej negativisht. Për më tepër, këtu ka kontribuar edhe raportimi i shtypit bulevardesk. Akuzat ishin: Pririje dhune, lidhje me trafikun e drogës dhe mafien, mungesë e vullnetit për integrim etj. Një gjest radikal në këtë kontekst paraqiste pllakati i Partisë Popullore Zvicerane më 1998 me mbishkrimin «Shqiptarë të Kosovës JO». Kjo njëkohësisht i zemëroi shumë zviceranë, të cilët protestuan në medie dhe në gjykata. (Më 2015 kjo parti lancoi një pllakat me një titull tejet problematik: «Kosovarët therin zviceranin», për çka ajo u padit dhe u shpall fajtorë në dy instanca gjyqësore). Një solidarizim të jashtëzakonshëm të popullatës zvicerane me shqiptarët paraqet aksioni humanitar «Glückskette» gjatë luftës së Kosovës në vitin 1999, me ç'rast u dhurua një shumë rekorde prej 20 milionë frangash zvicerane (Poaty: 37).

Përveç shtypit bulevardesk, theksohet edhe realiteti i një spektri mediatik, veprimtaria e të cilit karakterizohet nga profesionalizmi. Sidomos pozitivisht çmohet raportimi i tyre i moderuar gjatë luftës së Kosovës. Në vorbullën e këtyre ngjarjeve janë botuar shumë raporte hulumtuese mbi realitetin e migracionin shqiptar, i cili jeton prej vitesh në Zvicër. Ndërkohë, kësaj diaspore në Zvicër i janë kushtuar disa monografi, po kryhen studime, mentorohen punime diplome në shkollat e larta dhe mbahen ligjërata në këtë kontekst. Një aspekt të veçantë të perceptimit të migracionit shqiptar në Zvicër përbëjnë iniciativat publike dhe private për ndihmë zhvillimore në vend, në vendlindjen e këtyre migrantëve. Një vëmendje më të madhe meritojnë arritjet e fëmijëve shqiptarë në shkollat zvicerane dhe evidentimi

i nevojave të tyre për një integrim të suksesshëm. Për ta kuptuar më mirë diasporën shqiptare, duhen studime krahasuese, për shembull, nga një perspektivë sociologjike dhe etnologjike (Po aty: 37 n.v.).

SFONDE TË IMAZHIT TË SHQIPTARËVE NË ZVICËR

Në diskursin publik imazhi i keq i shqiptarëve në Zvicër shpesh lidhet me kriminalitetin e pjesëtarëve të veçantë të këtij grupi migrantësh. Si një faktor tjetër vendimtar në këtë kontekst – i vetëm apo jo – diskutohen mediet, domethënë raportimi i tyre. Jo në fund përmenden modele, të cilat pozitën e ngushtuar të migracionit shqiptar e shpjegojnë si pasojë e krizave identitare dhe ekonomike, të cilat mund t'i pllakosin shoqëritë nikoqire në faza të caktuara kohore.

KRIMINALITETI

Nga viti 2008, Enti Federal i Statistikave në mënyrë sistematike evidenton një Statistikë Kriminalale Policore. Janë të dhëna për delikte në kontekst të Kodit Penal, Ligjit të Substancave Narkotike dhe Ligjit për të Huajt. Tek i pari bëjnë pjesë deliktet e dhunshme, si: vrasja, lëndimi trupor, grabitja, dhuna seksuale, kërcënimi. Këtyre u shtohen edhe dënimet lidhur me pasurinë, si vjedhja dhe dëmet materiale. Pastaj deliktet seksuale, si ushtrimi ilegal i prostitucionit, ekzibicionizmi, veprimet seksuale me fëmijë dhe dhunimi. Deliktet kundër Ligjit të Substancave Narkotike në thelb nënkuptojnë konsumimin e substancave narkotike dhe trafikimin e tyre. Ligji për të Huajt është shkelur në rast të hyrjes ilegale në vend, gjatë qëndrimit ilegal në Zvicër, apo me ushtrimin e një veprimtarie fitimprurëse pa leje (BSF 2016: 7 n.v.).

Numrin më të madh të delikteve të regjistruara – rreth tri të katërtat – e përbëjnë shkeljet e Kodit Penal. Rreth dy të tretat e rasteve të tjera janë delikte kundër Ligjit të Substancave Narkotike; pasojnë shkeljet e Ligjit për të Huaj dhe kundërvajtje kundër ligjeve të tjera federale. Në kuadër të delikteve kundër Kodit Penal, me më shumë se dy të tretat e rasteve të regjistruara, pjesën më të madhe e përbëjnë ato që lidhen me pasurinë. Pastaj

vijojnë ato kundër lirisë, trupit dhe jetës, dhuna publike, integriteti seksual dhe të tjera (po aty: 11 n.v.).

Ndër të tjera, në këto raporte ka një ndarje të të akuzuarve sipas nacionalitetit dhe statusit të qëndrimit, e cila deri diku jep informacion edhe për shqiptarët e akuzuar. Në vitin 2015, nga gjithsej 40.316 të akuzuar në kontekst të Kodit Penal, 596 veta janë nga Shqipëria, 2.487 nga Kosova, 2.078 nga Serbia e Mali i Zi dhe nga Maqedonia vinin 1.162 të akuzuar. Kështu, Shqipëria zë vendin e 17-të, Maqedonia vjen në vendin e 9-të, Kosova qëndron në të 5-tin e një liste, në të cilën vijnë persona nga 54 vende. Përpara këtyre gjenden Italia, Portugalia, Gjermania dhe Rumania; pas tyre renditen shumica e nacionaliteteve në Zvicër (po aty: 27 n.v).

Kodi Penal: Të akuzuarit sipas statusit të qëndrimit, 2015

	Total	Popullata e rregullt	Sfera e azilit	Të tjerë
Shqipëria	596	49	17	530
Kosova	2'487	1'849	75	563
Maqedonia	1'162	975	11	176
Serbia & Mali i Zi	2'078	1'492	93	493

Nëse shikohet numri i shqiptarëve, të cilët më 2015 janë përfshirë në delikte penale në kontekst të Ligjit të Substancave Narkotike, raportet ndryshojnë paksa. Këtu Shqipëria shfaqet me 949 veta, nga Kosova janë 450 persona dhe nga Maqedonia 263, prej gjithsej 15.155 të akuzuarve nga 29 vende. Shqipëria këtu zë vendin e 5-të, Kosova vjen në të 10-tin, Maqedonia në të 15-tin. Serbia e Mali i Zi, nga ku vlerësohet se vjen një numër i vogël i shqiptarëve, del në vend të 7-të. Para këtyre vijnë Italia, Franca, Portugalia, Gjermania; prapa pasojnë një duzinë nacionalitetesh të tjera (po aty: 29).

Ligji i Substancave Narkotike: Të akuzuarit sipas statusit të qëndrimit, 2015

	Total	Popullata e rregullt	Sfera e azilit	Të tjerë
Shqipëria	949	15	7	927
Kosova	450	365	12	73
Maqedonia	263	215	4	44
Serbia & Mali i Zi	514	327	36	151

Sidomos sa u përket shqiptarëve situata ndryshon dukshëm në këndvështrim të raportit me Ligjin për të Huajt. Nga gjithsej 23.455 të akuzuar, nga e pakta 47 shtete, dalin 1.106 veta nga Shqipëria, 2.560 nga Kosova, 1.197 nga Serbia e Mali i Zi dhe 642 nga Maqedonia. Këtu Shqipëria zë vendin e 4-t, Serbia e Mali i Zi të 3-tin, Maqedonia vjen në vend të 9-të. Para këtyre nuk vjen asnjë nacion tjetër, kampion në deliktet kundër Ligjit për të Huajt në vitin 2015 në Zvicër është Kosova (po aty: 30 n.v.).

Ligji për të Huajt: Të akuzuarit sipas statusit të qëndrimit, 2015

	Total	Popullata e rregullt	Sfera e azilit	Të tjerë
Shqipëria	1'106	8	6	1'092
Kosova	2'560	359	37	2'164
Maqedonia	642	137	4	501
Serbia&Mali i Zi	1'197	205	28	964

Paraqitja e plasimeve këtu i shërben përjashtimisht krijimit të një pasqyre më të mirë për atë se ku gjenden përafërsisht shqiptarët në raport me ligjin në Zvicër; renditja e të gjitha nacioneve që vijnë në raport do të dilte jashtë kornizave të këtij punimi. Në këto paraqitje janë përjashtuar edhe zviceranët,

ata në këtë listim nuk janë marrë në konsiderim fare. Ligji për të Huajt, për shembull, ata edhe ashtu nuk i prek pothuajse aspak. Përveç kësaj, nëse këto shifra shikohen pak më nga afër, bie në sy që një numër i madh i të akuzuarve nga një nacionalitet në një delikt nuk bën pjesë në popullatën e rregullt; aty bëhet fjalë edhe për persona nga fusha e azilit, apo të tjerë, si persona me qëndrim të shkurtër, turistë, azilkërkues të larguar, rezidentë ilegalë, persona në procedurë paraqitjeje etj. Kjo bie në sy sidomos te shqiptarët, madje në të gjitha dimensionet e veprave penale. Te deliktet në lidhje me Ligjin për të Huajt, kjo është tejet e theksuar me Kosovën (BFS 2016: 27 n.v). Por, Kosova në këtë kohë ishte vendi i vetëm në rajon, i përjashtuar nga Lëvizja e Lirë. Në përgjithësi, duhet pasur parasysh që paraqitjet u referohen numrave absolutë dhe nuk konsiderohet raporti i rasteve me numrin e pjesëtarëve të nacionaliteteve përkatëse.

Sikur të vështrohet zhvillimi i veprave penale të shqiptarëve kundër Kodit Penal ndër vite, mund të nxirret edhe ndonjë konstatim. Shqipëria në këto statistika shfaqet për herë të parë më 2011, dhe që atëherë mund të vërehet një zhvillim në drejtim të përkeqësimit. Kosova deri më 2010 është përfshirë nën Serbinë dhe Malin e Zi; nga 2011-ta pozicionimi në listë ngadalë priret nga lart. Maqedonia fillimisht qëndronte në vendin e 7-të dhe të 8-të, pas një përmirësimi në vitet 2011-2013, prej dy vjetësh mban vendin e 9-të. Vetëm Serbinë dhe Malin e Zi i dallon një përparim.

Kodi Penal: Deliktet në total dhe pozicionet, 2009-2015¹⁹

	Shqipëria		Kosova		Serbia & Mali i Zi		Maqedonia		Totali i të huajve dhe shteteve	
2015	596	17.	2'487	5.	2'078	7.	1'162	9.	40'316	54
2014	661	15.	2'338	5.	2'298	6.	1'122	9.	41'582	56
2013	679	15.	2'254	7.	2'657	5.	1'187	12.	43'758	58
2012	484	21.	2'052	8.	2'895	3.	1'272	11.	43'521	59
2011	323	24.	1'909	7.	2'867	3.	1'118	11.	39'439	57
2010					5'297	1.	1'329	8.		20
2009					5'496	1.	1'215	7.		17

¹⁹ Tabela është sajuar nga hulumtimet për Kodin Penal të statistikës kriminalistike policore të BFS 2009-2015.

Nga të dhënat për deliktet kundër Ligjit të Substancave Narkotike nga vitet 2009-2015 del përsëri një rritje e veprave penale të qytetarëve shqiptarë. Kosova rangohet dy pozicione më sipër. Serbia e Mali i Zi ngelin relativisht stabile përpara dhe Maqedonia gradualisht prezanton shifra më të ulëta.

Ligji i Substancave Narkotike: Deliktet në total dhe pozicionet, 2009-2015²⁰

	Shqipëria		Kosova		Serbia & Mali i Zi		Maqedonia		Totali i të huajve dhe shteteve	
2015	949	5.	450	10.	514	7.	263	15.	15'155	29
2014	910	5.	421	10.	505	8.	236	16.	15'119	28
2013	768	6.	477	12.	703	7.	291	16.	18'661	29
2012	704	7.	450	12.	673	9.	341	16.	17'864	29
2011	579	9.	430	12.	735	6.	285	15.	16'453	28
2010	394	10.			1'201	4.	308	12.		29
2009	439	8.			1'184	4.	312	12.		28

Nga këndvështrimi i veprave penale kundër Ligjit për të Huajt, Shqipëria, me kalimin e kohës, po ndahet gjithnjë e më keq. Kosova prin në numra absolutë, ndërkohë që numri i delikteve të qytetarëve kosovarë po rritet. Serbia e Mali i Zi shpesh pasojnë ngjitur. Qytetarët e Maqedonisë, ku në të shumtën e rasteve supozohen shqiptarë, lëvizin ndërmjet pozicioneve 7 dhe 12. Sa shqiptarë nga Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës në jug të Serbisë fshihen pas këtyre, mbetet e paqartë.

²⁰ Tabela është sajuar nga hulumtimet për Ligjin për Substancat Narkotike të statistikës kriminalistike policore të BFS 2009-2015.

Ligji për të Huajt: Deliktet në total dhe pozicionet, 2009-2015²¹

	Shqipëria		Kosova		Serbia & Mali i Zi		Maqedonia		Totali i të huajve dhe vendeve	
2015	1'106	4.	2'560	1.	1'197	3.	642	9.	23'445	47
2014	982	4.	2'006	1.	1'024	2.	543	12.	21'030	46
2013	881	7.	2'176	1.	1'063	4.	492	10.	21'623	47
2012	732	7.	1'565	1.	1'065	4.	620	9.	20'103	46
2011	536	10.	1'561	1.	993	2.	687	7.	17'799	40
2010	467	9.			2'607*	1.	601	7.		40
2009	487	9.			2'357*	1.	401	10.		39

Këto statistika tejet të rëndësishme dhe relativisht të detajuara japin informacion për gjendjen aktuale të shqiptarëve lidhur me kriminalitetin dhe për të kaluarën e afërt. Mjerisht, mungojnë raporte të tilla në lidhje me vitet e mëparshme dhe analiza nuk vazhdohet në mënyrë të detajuar sipas shtetësisë së personave të akuzuar.

Diskutime të kësaj teme të orientojnë nga statistika, të cilat flasin për një shkallë më të lartë kriminaliteti të 18 deri 40-vjeçarëve nga ish-Jugosllavia në vitet 2000 deri 2006, ku bëjnë pjesë edhe migrantët shqiptarë, sesa të gjithë të huajt e tjerë. Analiza të tjera sugjerojnë që numri i lartë i delikteve të të rinjve të huaj nuk provon patjetër një shkallë më të lartë të delikuencës së të rinjve migrantë. Ata paditen më shpesh dhe më shpejt sesa vendësit. Përveç kësaj, shifrat e gjykimeve të të rinjve migrantë dhe vendës nuk dallojnë sikur të konsideroheshin shkeljet kundër Ligjit Federal për Qëndrimin dhe Vendosjen e të Huajve (ANAG). Gjithsesi, mediet kanë dështuar të raportojnë për angazhimin e të rinjve shqiptarë për tejkalimin e konflikteve në shkollë, në takime të rinjsh dhe në shoqëri në përgjithësi (Burri et al. 2010: 67 n.v.).

²¹ Tabela është sajuar nga hulumtimet për Ligjin për të Huajt të statistikës kriminalistike policore të BFS 2009-2015.

MEDIET

Nga fakti se njerëzit vetëm rrallë kanë kontakt të drejtpërdrejtë dhe përvoja personale me të huajt, një rol i rëndësishëm si burim përvojash u bie medieeve. Përgjithësisht, medieeve u njihet një funksion pozitiv integrimi, ndonëse kjo më shumë është një pritshmëri. Në të vërtetë, në shkencat e medieeve dhe të komunikimit janë etabluar dy teza kundërthënëse lidhur me ndikimin e medieeve në realitetin e migrantëve: teza e homogjenizimit, pra ajo e integritimit, thotë se mediet shfaqin një efekt pozitiv në integrimin e migrantëve; teza e fragmentimit, përkundrazi, ka gjetur që mediet kanë një ndikim tëhuajgues tek njerëzit (Schulz 1999: 90 n.v, Geissler/Pöttker 2006: 21)²².

Migrantët janë që nga vitet 1970 objekt i debateve publike në vend; përgjithësisht raportimi në mediet zvicerane për ata është modest. Analizat e përmbajtjes së raportimit mbi migrantët identifikojnë një tendencë negative ndaj tyre. Kjo ndodh në një kontekst problematizues në trajtën e «problemimit të të huajve», «problemimit të azilit» etj. Edhe metaforat e përdorura për këtë shpeshherë janë negativisht të konotuar: «përmbytje», «ortek», «kërcënim» etj. Konteksti tematik shpeshherë është kriminaliteti. Kështu, mediet me këtë e favorizojnë ngritjen e stereotipave, apo madje paragjyqimeve, të cilat në instancë të fundit përfundojnë në një diskriminim shoqëror (Bonfadelli, 2007).

Stadi i dijes për temën e paraqitjes së pakicave etnike i referohet fundit të dekadës së parë të shekulli të ri dhe përfshin një duzinë studimesh. Ky diskutim vetëm duhet të tregojë që raportimi mediatik mund të konsiderohet fort mirë si një model shpjegues në lidhje me statusin e integritimit dhe me imazhin e shqiptarëve. Përveç kësaj, ai e ilustron prirjen që shfaq raportimi mediatik në vija të trasha. Këtu shquhet një punim, i cili është kryer në një kontekst të veçantë, pikërisht përpara një votimi të rëndësishëm nga pikëpamja e statusit të migrantëve në Zvicër dhe një tjetër, në të cilin shqiptarët duken në mënyrë eksplicite.

Njerëzit nga Ballkani, në lidhje me kontributin e tyre shoqëror, në mediet zvicerane janë të reprezentuar në mënyrë deficitare. Ky është përfundimi i një

²² Në të njëjtin hulumtim mund të shfaqen të dyja. Një analizë bivariate e hulumtimit të sipërpërmendur me 35 shqiptarë në Zvicër tregonte që, si përdorimi i televizionit zviceran, ashtu edhe i atyre në shqip, kishte një efekt negativ në besimin në institucione. Po kjo, ama nuk vlen për përdorimin e formateve të lajmeve: Njëkohësisht përdorimi i televizionit dhe radios në gjuhën gjermane lidhej me motivimin për t'u integruar dhe anëtarësimin në organizata zvicerane. Ndërkohë që motivimi për t'u integruar u definua përmes investimit në Zvicër, për shembull, blerja e një banese a shtëpie dhe përmes natyralizimit.

studimi, i cili është kryer në vigjilje të votimit për natyralizimin e lehtësuar më 2004. Në tekstet e medieeve të shtypura, të shfrytëzuara për analizën, është gjetur se është prodhuar një stereotip i të rinjve «nga «Ballkani», që korrespondon me imazhin e «të dhunshmit», apo të «të tërbuarit me veturë» dhe të «maçove»». Ndryshe nga kjo, gratë më rrallë kanë qenë të përfshira në raportim, zaten atyre u vishej shpesh roli i viktimës. Në mënyrë të përmbledhur, studimi nxjerr që mediet e shtypura transmetojnë një pamje tejet të shtrembëruar të migrantëve nga Ballkani, e cila është shënjuar pakrahasueshëm negativisht (Wyssmüller 2004: 121 n.v.).

Dhjetë vjet më parë u krye një hulumtim kuantitativ i shtypit gjermano-zviceran: Të huajt paraqiten ose pozitivisht në kontekst të sportit dhe kulturës, ose në terr, në kontekst të azilit dhe kriminalitetit. Përditshmëria, është gjetur në raportim, nuk ka ndonjë rol domethënës. Prejardhja e personave të analizuar është kryesisht Evropa lindore, e mesme, perëndimore dhe jugore. Si shkaktar problemesh ama dalin ata nga ish-Jugosllavia. Në raportimin për kriminalitetin, në mënyrë eksplicite zakonisht si autorë shfaqen libanezët dhe shqiptarët, si dhe të huajt e azilantët. Azilkërkuesit paraqiten si delikuentë të drogës të pidentitetit dhe refugjatët nuk janë temë e raportimit (Zwingli, 1994).

Përgjithësisht, nga studimet për paraqitjen e të huajve në medie, del që përditshmëria e migrantëve abstrgohet pothuajse krejtësisht. Mungojnë artikuj që flasin për një mirëkuptim të suksesshëm në rrafshin lokal dhe rajonal. Raportimi i medieeve nuk interesohet për sfondin e tematikës së azilit. Migrantët as nuk duken si bashkëbisedues, ata zhvendosen në prapaskenë. Një temë gati e veçantë në këtë kontekst është islami, i cili kuptohet si kërcënim dhe i prapambetur. Dhe, myslimanët shfaqen kryesisht në kontekst të ekstremizmit. Për më tepër, gazetarët e huaj do të kishin një qasje më të mirë tek pakicat kulturore-gjuhësore. Do të ishin të dëshiruara më shumë të ashtuquajtura etnomedie, të cilat u drejtohen si vendësve, ashtu edhe migrantëve të tyre dhe do ta nxisnin bashkëjetesën multikulturore (Bonfadelli, 2007: 99 n.v.).

Vështruar nga perspektiva e shqiptarëve, raportimi mediatik për ta shpesh shkakton pakënaqësi. Në parim ata i vlerësojnë mediet zvicerane më tepër se ato në gjuhën e tyre, por njëkohësisht nuk ndihen të reprezentuar prej tyre, mendojnë se paraqitja e tyre në mediet zvicerane është e shtrembër. Prandaj edhe vlerat e besimit në medie nga shqiptarët e pyetur për këtë dalin më të ulëta se ato në institucione të tjera, si policia, gjykatat etj. (Shabani, 2014).

«ETNIZIMI I POLITIKËS»

Kriza ekonomike dhe krizat e orientimit, për të cilat u fol shkurt, në fakt janë dimensione të një krize sociale. E para manifestohet në trajtë të rënies së prodhimit social bruto dhe rënies së investimeve, rritjes së papunësisë etj. Kriza e orientimit, nga ana tjetër, njëkohësisht paraqet një krizë identiteti, në të cilën mbretëron një pasiguri për atë se si do të zhvillohet e ardhmja dhe se si duhet sjellë. Ato janë momente solemne të lëvizjeve sociale të natyrës politike, fetare apo etnike, në të cilat shihet rasti për të mundësuar të tjera orientime, duke shtruar tema të reja. Paraqitja e këtyre lëvizjeve sjell një tension në opinionin publik. Orientimi i këtyre lëvizjeve të reja bie në konstrukte identitare dhe transformohet përmes një semantike të të huajës. Një diskurs të tillë e karakterizon një nivel i ulët kompleksiteti dhe një dije e dobët për shoqëri të huaja. E huaja problematizohet sistematikisht: Nga stereotipizimi i saj mëson se kush je përmes asaj se çfarë nuk je. Ajo tanimë bëhet shumë më tepër përgjegjëse për gjendjen e zymtë të shoqërisë. Në anën tjetër, në faza të tilla krizash ekonomike dhe identitare ndodh një rishkrim i historisë së kolektivit. Një nacionalizëm përmes ofrimit të miteve, betejave dhe «figurave të mëdha», i jep qëndrueshmëri pasigurisë aktuale. Dhe, ky diskurs njihet si «etnizim i politikës» (Imhof, 1994: 157 n.v.; Imhof, 1996a: 202 n.v.).

Kjo semantikë e tipizimeve të të huajve dhe vetes, e cila kufijtë e përkatësisë i definon ndryshe, parimisht zhvillohet në parlament dhe në medie- pavarësisht nga fakti nëse janë të lidhura me ndonjë parti ose lëvizje, apo jo. Një analizë e këtyre proceseve të historizimit të politikës i identifikon ato si indikator i kohëve të krizës së një shoqërie. Përveç kësaj, del që ato janë një fenomen diskontinuel. Etnizimi i politikës përmes semantikave të tipizimit të të huajve fillon më herët; kohët e krizës vetëm sa e afirmojnë më tepër. Semantikën e të huajës shfaqin një marrëdhënie me pasiguritë për të ardhmen. Përveç kësaj, fazat e etnizimit të politikës nuk kanë patjetër ndonjë marrëdhënie me numrin e të huajve në shoqëri, ato më tepër varen nga konstruktimi i të huajës në kontekst të pasigurisë së përgjithshme (Imhof, 1994: 160 n.v.; Imhof, 1996a: 204).

Para dhe gjatë kohëve të krizave dallohen tri forma të etnizimit diskontinuel të politikës; ato drejtohen kundër të ashtuquajturave pakica virtuale, paraqiten në trajtë të konflikteve shumicë-pakicë dhe të konflikteve fundamentale shoqërore. Pakicat virtuale, zaten, definojnë si grupe «më

vete» dhe jo «për vete». Në vija të trasha, dallohen tri konstrakte ndarëse; ato kanë sfond ideologjik-folklorik, natyralist, apo religjioz. Gjatë fazave diskontinuele të etnizimit të politikës dominojnë semantikave dalluese ideologjike-folklorike. Një karrierë tematizimi në faza të ndryshme të zhvillimit të vendit ka provuar shprehja «mbihuajsimi i Zvicrës». Objekti i semantikave të tipizimeve të të huajve dhe vetes tek tensionet shumicë-pakicë është «e huaja» brenda shoqërisë – pakica, të cilat posedojnë me një vetëdije për bashkësinë dhe veten e perceptojnë si të barabartë ndër të barabartët. Shembull paradigmatic i tensioneve të këtilla në Zvicër paraqet konflikti i kulturave dhe konflikti i Jurasë. Konflikti i kulturave është bartur ndërmjet varianteve të protestantizmit dhe katolicizmit. Karakteristikë e këtyre tensioneve është fakti që ato e tangojnë shëmbëlltyrën e një shoqërie. Konflikti fundamental përbën një rrafsh më të lartë të përhapjes së një konflikti politik, kur kundërshtari e refuzon luajalitetin tradicional. Këtu semantikave të tipizimit të të huajve dhe të vetes i drejtohen kundërshtarit të brendshëm politik. Dhe kur kriteret racore, ideologjike-folklorike apo ato religjioze të ndarjes për stigmatizimin e kundërshtarit politik nuk janë në dispozicion, arrihet të semantika e tradhtisë dhe e asocion atë me të huajin. Një koncept që vjen nga ky diskurs është «kolona e pestë». Shembull të këtij konflikti paraqet lufta kundër lëvizjes punëtore gjatë Luftës së Ftohtë, kur një ideologji politike u identifikua me të huajin. Objekt i semantikave dalluese në këtë anë të krizës sociale nuk është e huaja e përkohshme, por një i brendshëm, që tenton drejt saj (Imhof 1994: 163n.v.; Imhof, 1996a: 207n.v.; Imhof 1996b: 88n.v.).

Në këtë traditë studimore është kryer një studim lidhur me raportimin e shtypit zviceran për kriminalitetin, i cili është i një rëndësie të madhe për kontekstin e këtij diskutimi. Kështu, hulumtimi afatgjatë i raportimit për kriminalitetin në harkun kohor 2002 deri 2011 në mediet kryesore zvicerane tregon që dinamika bartet nga dy aktorë: fushatat politike të Partisë Popullore Zvicerane dhe strategjitë publicistike të «Blick»-ut. Përveç kësaj, ajo është shënjuar konsiderueshëm nga politizimi i kriminalitetit. Më tej, studimi ka treguar, «se tematizimi mediatik dhe politik i kriminalitetit ndikon në perceptimin e kërcënueshmërisë së popullatës». Kjo në harkun kohor 2002 deri 2011 është zhvilluar gjerësisht në harmoni me intensitetin e raportimit dhe veprimtari politik (Eisenegger/Ettinger, 2012).

Një analizë kryqësore e kryer në këtë kuadër për krahasimin e raportimit për kriminalitetin me statistikën policore të kriminalitetit për vitin 2011

ka dhënë «që deliktet e dhunshme kundër trupit dhe jetës në arenën e analizuar të shtypit në krahasim me statistikën policore janë mbipërfaqësuar më së shumti». Për sa i përket vëllimit të raportimit për kriminalitetin, këtu dominojnë gazetatat bulevardeske. Atyre u shkon sidomos për dore që veprën ta ngrenë në mënyrë sugjестive që në titull dhe ta vendosin në një kontekst politik. Një shembull i sjellë është ky: «Kosovari e pret pehlivanin në fyt» (Blick, 30.11.2011). Këtë gjini të shtypit e karakterizon një mbipërfaqësim i fortë në krahasim me statistikën e kriminalitetit të veprave të dhunshme, para së gjithash të delikteve të vrasjeve. Në gazetatat falas raportimi fokusohet te zhvillimi i ngjarjes, aty mungojnë gjerësisht përpunimi juridik si dhe raportet hulumtuese për ngjarjen. Raportimi për kriminalitetin në gazetatat e abonuara në raport me ato falas dhe bulevardeske është më i vogël. Është vërejtur që «Tages Azeiger» në fushën e raportimit për kriminalitetin shfaq pjesërisht një profil të ngjashëm sikurse edhe gazetatat falas dhe ato bulevardeske. Proporcionalisht, ai madje shfaq «një raportim lehtë më të vëllimshëm për kriminalitetin se gazeta falas <20 Minuten>». Mediet javore «Weltwoche» dhe «Wochenzeitung» i karakterizon një ngarkesë morale-emocionale në raportimin për kriminalitetin; ndonëse kjo te «Weltwoche» është më e theksuar. Në të dyja mediet kategoria kundër paqes publike është më së shumti e mbipërfaqësuar. «Përzgjedhja dhe forma e paraqitjeve të rasteve kriminale në të dyja mediet është shprehje e një linje redaksionale të shënuar nga botëkuptimet» (Po aty: 3).

10 INTERVISTA

Nga Alain Maillard dhe Kujtim Shabani

Amina Benkais-Benbrahim

IMAZHI NDRYSHOHET PËRMES INTEGRIMIT

Amina Benkais-Benbrahim, që nga viti 2011 është e deleguar e Kantonit të Vaudit për integrimin dhe kryetare e Zyrës Profesionale për Integrimin e të Huajve (BCI). Në një fushë të ngjashme ajo ka punuar në kantonin e Njëshatelit (2002-2010). Ajo takohet rregullisht me përfaqësues të komuniteteve të të huajve.

Çfarë përvojash po bëni me komunitetin shqiptar?

Nëse i krahasoj të dy kantonet, tematika e shqiptarëve në kantonin e Njëshatelit është shumë më pak e pranishme se në kantonin e Vaudit. Kjo lidhet sigurisht me praninë numerike dhe historinë e migracionit. Gjatë viteve që kam punuar në Njëshatel, komuniteti shqiptar nuk kërkonte ndonjë bashkëpunim me autoritetet. Për ne ishte e zakonshme që migrantëve t'u ofronim ndonjë shërbim informimi ose konsulence. Larmia e prejardhjes së bashkëpunëtorëve tanë na e mundëson t'u drejtohem shumë komuniteteve të ndryshme. Edhe pse në ekipin tonë bënte pjesë një punëtor albanofon, shqiptarët nuk i janë drejtuar kurrë aq shpesh zyrës sonë.

A keni një shpjegim për arsyet e mundshme të kësaj?

Ndoshta për shkak të një ankorimi të vogël në atë kohë. Në kantonin e Njëshatelit kjo duhej shqyrtuar më nga afër, por unë besoj që bashkësia u formua para së gjithash në kohën e kërkesave për azil, në vitet 1990. Ishin djem të rinj, pa traditë shoqate. Në kantonin e Vaudit komuniteti është formuar në vitet 1960. Ai përbëhej nga shtresa të ndryshme, me arsye të ndryshme imigrimi. Ai ka struktura të qarta dhe bashkëpunimi me zyrën profesionale për integrimin e të huajve shkonte fort mirë, kur erdha unë më 2011. Partnerët ishin aty, ekzistonte një traditë e bashkëpunimit me zyrën tonë profesionale.

A ka qenë imazhi i shqiptarëve shpesh objekt diskutimesh?

Unë do të thosha se preokupimi për imazhin ekziston te të gjithë migrantët. A është ky te shqiptarët më i theksuar se te të tjerët? Gjithsesi, është shumë i pranishëm. Portugezët, për shembull, merakun e kanë para së gjithash te integrimi profesional dhe kërkimi i punës. Unë besoj se te shqiptarët kanë

ngelur gjurmë të viteve 1990, kur vuanin nga imazhi negativ i «jugove». Ka pasur një vullnet për të punuar në këtë imazh. Por, unë besoj që në vitet e fundit i janë larguar atij. Në kontaktet e mia me shoqatat, shoh një orientim nga puna e integritetit... dhe imazhi do të pasojë. Më pak orientohen nga imazhi si i tillë. Aktualisht kemi shumë projekte të ndryshme, jo përjashtimisht lidhur me imazhin në medie.

Preokupimi për imazhin nuk qëndron më në vijë të parë, sepse kohëve të fundit ai është përmirësuar?

Çështja e imazhit, përgjithësisht, është e lidhur me gjeneratën e parë. Më pas koha e bën të veten. Dhe, atëherë është një konstantë në tematikën e migracionit, që ai i cili vjen në fund është edhe «koka e turkut». Kosovarët dhe shqiptarë të tjerë tanimë nuk bëjnë pjesë në valën e fundit të migracionit. Dhe, ata nuk vijnë më përmes kërkesave për azil, kjo ka mbaruar përfundimisht, ata nuk e kanë më këtë të drejtë. Tani në vijë të parë kanë dalë myslimanët. Është e vërtetë që kjo është një kategori e madhe, një paketë ku bën pjesë edhe shumica e shqiptarëve, por unë konstatoj që ata si komunitet janë më pak në shënjestër. Në shënjestër janë grupe të tjera.

Shqiptarët fillojnë të bëjnë pjesë tek ata që janë prej kohësh këtu. Ata ngelin më të dukshëm se italianët, të cilët në njëfarë mënyre «janë provuar» dhe nga të cilët e kemi marrë një pjesë të kulturës, për shembull «Pizza»-n. Në këtë fushë, për aq sa di, nga shqiptarët nuk kemi marrë asgjë. Por, unë jam e mendimit që kjo është një çështje kohe. Në Francë, pavarësisht nga islamofobia, «Couscous»-i ndërkohë ka kaluar në kulturë. Ndërsa Couscous «Royal»-i në vendet arabe nuk njihet...

Ju i ndiqni me vëmendje mediet, çfarë shihni aty në lidhje me shqiptarët?

Ne po e vështrojmë para së gjithash përmendjen e vendeve të prejardhjes në raste deliktesh. Kosovarët përmenden shpesh aty. Edhe pse janë prej disa dekadash këtu, mediet mendojnë akoma se duhet t'i përgjigjen një nevojë të popullatës, duke e përmendur prejardhjen, madje edhe kur kjo i hedh benzinë zjarrit. Për mua kjo nuk është e domosdoshme, para së gjithash kur flitet për gjeneratën e dytë a të tretë. Te të rinjtë, të cilët ndoshta nuk kanë më asnjë lidhje me vendin e prejardhjes, thyerja e identitetit të tyre forcohet kur u kujtohet nga të tjerët vazhdimisht prejardhja e tyre. Një i ri, i cili ka lindur këtu dhe bën një budallallëk, këtë e bën si lozanas dhe jo si kosovar.

Pra, nuk e keni ndjenjën se është përmirësuar imazhi i shqiptarëve në medie?

Në mediet e shtypura, që i drejtohen një publiku të gjerë, të jem e sinqertë, jo. Pavarësisht nga integrimi i tyre i mirë, gjithmonë përmendet prejardhja e tyre. Me këtë dëshirohet të thuhet se ata ngelin ndryshe, edhe nëse janë prej gjatë kohësh këtu. Me këtë përforcohen stereotipat. Ndryshe nga kjo, prejardhja italiane përmendet rrallë. Megjithatë, ka një zhvillim, nuk flitet më për shqiptarët si grup, sikurse flitet sot për sirianët dhe eritreasit. Për ta flitet kur është fjala për persona të veçantë në lidhje me një delikuencë.

Çfarë reagimesh keni në lidhje me shqiptarët nga popullata dhe rrethi juaj?

Stereotipat ngelin negativë. Jo më shumë a më pak se për afrikanët, të cilët si minoritet i dukshëm shërbejnë gjithmonë si «kokë turku», apo myslimanët me islamofobinë aktuale. Nocioni «kosovar» lidhet para së gjithash me klishe dhe shumica e njerëzve nuk e njohin mirë lidhjen apo dallimin me «shqiptarët».

Atëherë, si mund të përmirësohet imazhi i shqiptarëve?

Klishetë nguliten për gjatë kohë. Çfarë, sipas mendimit tim, ka ndryshuar, është qasja e komunitetit si i tillë, i cili i ka përvjelë mëngët dhe po zhvillon projekte të rëndësishme në fushën e integritit. Kështu, imazhi do të ndryshojë më shpejt sesa nëse mundohesh të justifikohesh. Kulmi i këtij zhvillimi këtë vit ishte krijimi i shoqatës së inxhinierëve shqiptarë. Këshilli Kantonal i Vaudit u ka kushtuar atyre dy orë e gjysmë!

Për mua, kjo përbën mënyrën më të mirë për ngritjen e imazhit. Janë të rinj që kanë studiuar këtu dhe po rrjetëzohen. Këtu është fjala për diçka konkrete. Ka edhe gjithë ato ndërmarrje të vogla në Zvicër të themeluara nga shqiptarët, këto janë indikatorë të matshme të integritit. E gjithë kjo do të kontribuojë në përmirësimin e imazhit, por do edhe ca kohë. Gjendemi në një transicion. Për fat, në perceptimin e një opinionimi që do të frikësojë, shqiptarët po bëhen më pak interesantë.

Bashkim Iseni

TË AFIRMOHET KULTURA SHQIPTARE

Bashkim Iseni, 44 vjeç, prej pesë vjetësh e udhëheq portalin e lajmeve albinfo.ch. Ky ofron informacione online në tri gjuhë, një magazinë lajmesh dhe emisione televizive. Ai në Zvicër ka ardhur në vitin 1989 dhe, falë vëllezërve të tij, ish-stinorë në gastronomi, studioi shkenca politike. Ka shkruar një punim doktorate në Universitetin e Lozanës si dhe një libër për identitetin kombëtar në Ballkan dhe udhëhoqi studime për integrimin në Universitetin e Nëshatelit.

Çfarë kanë treguar studimet tua për integrimin e shqiptarëve në Zvicër?
Unë kam bërë një studim për Universitetin e Nëshatelit lidhur me mediet dhe transformimet e identitetit të kosovarëve në Zvicër dhe pastaj një tjetër për boshnjakët në Zvicër. Rezultatet tregojnë që integrimi i këtyre popullatave, me kulturë kryesisht myslimane, po shkon shumë mirë, me kushtin që të mbështetet dhe pa menduar naivisht se gjithçka ecën mirë. Është një proces i cili duhet të përcillet. Por kjo e kundërshton ndonjë esencializim të kulturës: Asnjë kulturë nuk është për nga definicioni e papajtueshme me atë të vendit, ekzistenca e të cilit bazohet në një përzierje të feve, kulturave dhe gjuhëve.

Ju interesoheni për mediet, çfarë imazhi të shqiptarëve transmetojnë ato në Zvicër?

Para disa vjetësh i kam dhënë një intervistë një gazetareje, të cilën ajo e titulloi «Pushoni së stigmatizuarit kosovarët». Kjo ndodhi pas disa kryetitujsh frikësues, të cilët u konotuan negativisht nga mediet. Ndodhi një lloj stigmatizimi, i cili mund të vazhdonte pandëshkueshëm, duke qenë se mediet e dinin që nuk do të kishte reagime të lexuesve – çka, meqë ra fjala, nuk është ende rasti. Fenomeni u theksua akoma nga një grupim politik, i cili e kishte në shënjestër këtë komunitet.

Dhe, popullata shqiptare gjatë kohë nuk e ka kuptuar që duhet të aktivizohet për ta mbrojtur imazhin e saj. Kjo po ndryshon tani, persona apo institucione e panë të nevojshme që të kundërshtojnë publikisht. Për shembull në Coop kishte një pllakat në gjuhën shqipe, i cili apelonte për të mos e prekur buzëkuqin. Një studente shqiptare ka reaguar, çka u tematizua në «20 Minuten», intervenoi Kuvendi i Shqiptarëve në Zvicër dhe drejtorja e Coop-

it kërkoi ndjesë. Parë në përgjithësi, edhe shqiptarët kanë hisen e tyre të përgjegjësisë në këtë imazh të keq.

Cilën përgjegjësi?

Atë të shkëputjes nga vendi i prejardhjes dhe që nuk kanë kontribuar sa duhet për ta afirmuar më mirë kulturën e tyre, për të hyrë në një dialog, për t'i kërkuar rrjetet, për t'ua mësyre sfidave. Ata është dashur të marrin pjesë më tepër në votime, të participojnë në jetën sociale, fëmijët t'i edukojnë me idenë se Zvicra është vendi i tyre dhe jo një vend i huaj.

Ata shpeshherë nuk e kanë ditur, nëse do të qëndrojnë këtu...

Po, vërtet. Por, ata qëndruan në distancë dhe lajmet për ngjarje fort të dhunshme, të cilat u përshkruheshin atyre, kontribuan për këtë. Për mua nuk duhet të bëhet një dallim fundamental ndërmjet kosovarëve dhe ish-jugosllavëve të tjerë. Ata u nënshtrohen perceptimeve të ngjashme. Kosovarët mbase janë më të prekur nga kjo, duke qenë më të përfaqësuar në Zvicër, por, në përgjithësi, i gjen të njëjtët stereotipa të gjithë migrantët që vijnë nga Ballkani.

A është zhvilluar imazhi dhe si?

Një ndryshim enorm ka ndodhur falë futbollit. Është gjigante ta shohësh se si lojtarët me emra shqiptarë i mbrojnë me mish e me shpirt ngjyrat e Zvicrës. Fakti që emra nga Ballkani janë të përfaqësuar në Kombëtare dëshmon disi për një kulturë, e cila në këtë vend po bëhet legjitime. Duhet modele si Xherdan Shaqiri. Kur shtypi i ofron atij të rrëfejë për rrugëtimin nga vendi i lindjes, në Kosovë, kjo përbën një ndryshim perspektive. Deri në këtë kohë imigrimin nga Kosova e kishin lidhur gjithnjë me probleme.

Është me rëndësi të shprehesh për ta ndryshuar imazhin. Këtë vit, në Lozanë kemi organizuar një ekspozitë me emrin «Besa» për hebrenjtë që shqiptarët i shpëtuan gjatë luftës. Efekti ka qenë i jashtëzakonshëm! Kam dëgjuar si një nënë, fëmija i së cilës shkon në shkollë me të rinj me origjinë shqiptare, shprehej e habitur për këtë pjesë të historisë shqiptare. I kam parë fëmijët e mi dhe të tjerë si i hapnin sytë kur presidenti Daniel Brélaz shprehej pozitivisht për shqiptarët. Përnjëherë ndiheshin shumë të vlerësuar, dhe kjo është e rëndësishme!

A ka ndryshuar imazhi i shqiptarëve në Zvicër edhe në medie?

Stigmatizimi nuk ndodh më në ato përmasa si më herët, edhe pse ende lexohen tituj fort të ashpër. Ky është rasti më pak në Romandie sesa në Zvicrën gjermane. Por mediet për nga natyra janë të prirura të orientohen nga problemet. Ne në albinfo kemi publikuar një artikull për një shqiptar nga Maqedonia, dikur pa letra, i cili e kishte organizuar gjithë pritjen e ministrit të Partisë Popullore të Zvicrës, Guy Parmelin, në kantonin e Vaudit në dy a tri ditë. Kjo ishte një shenjë e bukur e integritit, të cilën ua kemi ofruar disa medie, asnjëri nuk e mori.

Neve shpesh na vishet roli i varrmihësit, kur një person me prejardhje shqiptare ka kryer një krim, por kur diçka ecën mirë, për të nuk pyet askush. Kjo e mbrun shikimin e një komuniteti. Është diçka krejt tjetër kur atë e vështron si potencial dhe jo vetëm si problem. Në albinfo përpiqemi çdo ditë ta influencojmë imazhin e shqiptarëve dhe perceptimin e tij nga zviceranët.

A vuajnë vetë shqiptarët akoma nën këtë imazh të dëmtuar?

Po, jashtëzakonisht. Ata i prek fakti që prejardhja e futbollistëve nuk sillet në kujtesë, kur një ndeshje e Kombëtares zvicerane shkon mirë, por kur përfundon keq... Ngel një ndjenjë subjektive se zviceranët nuk i duan shqiptarët. Edhe unë jam i befasuar, sa pak aktualitete për Kosovën dalin në mediet zvicerane. Për të flitet kur hidhet gaz në parlament, por kurrë për të mirë.

A nuk mungojnë sinjalet e dukshme, pozitive, që mund të lidheshin me shqiptarët? Ai për zviceranët është një komunitet më shumë misterioz...

Po, kjo është e vërtetë. Figura pozitive identifikuese është Shaqiri. Ka vetëm pak restorante tipike shqiptare. Kjo shpjegohet edhe me faktin se flitet për një popullatë që vjen nga viset rurale të Kosovës a Maqedonisë. Por, disa figura të shquara nuk po shfaqen vetëm në sport, si, për shembull, këngëtarja Elina Duni, një divë e vërtetë!

Shqiptarë të rinj e kanë lancuar projektin Balkans.ch, i cili bën udhëzime për udhëtime, për ta njohur më mirë zonën, për t'i zbuluar viset e mrekullueshme malore. Kjo është një mënyrë për t'i arritur zviceranët! Afrimi ndodh edhe përmes martesave të përziera, përmes pjesëmarrjes në jetën shoqërore dhe politike, në medie, të cilave deri më tani u mungon edhe një figurë me prejardhje shqiptare.

Është e vërtetë që zviceranët kanë vështirësi se ku ta vendosin këtë kulturë shqiptare, duke qenë se në emër të saj kanë folur pak ambasadorë. Janë edhe vende që nuk i kanë mjetet për ta afirmuar imazhin e tyre. Për fat, Zvicra po ndërmerr përpjekje për t'i përkrahur platformat si kjo jona, apo ISEAL-in dhe shoqëri të tjera, çka kontribuon për ta afirmuar një realitet, shpesh plotësisht të injoruar.

Cila është, sipas mendimit tuaj, hiseja që ka feja myslimane në problemin e shqiptarëve me imazhin?

Etiketa myslimane vetëm i është ngjitur një imazhi tanimë negativ dhe stereotipik. Pllakatet «Shqiptarët e Kosovës JO», apo kryetitujt për një shqiptar që e ka therur një zviceran, janë fiksuar në kokat e njerëzve. Por, kur shtesa mysliman mbase e thellon problemin, kjo është e padrejtë! Zvicra ka shansin e jashtëzakonshëm të ketë një popullatë myslimane nga Ballkani, raporti i së cilës me fenë është pragmatik dhe inteligjent. Ky është një islam, i cili ka bashkëjetuar për shekuj me radhë me krishterimin. Shqiptarët kanë ditur ta ruajnë çiltërsisht pluralizmin e tyre fetar. Ata e festojnë bashkë festën e Bajramit dhe të Krishtlindjeve. Aty feja është më pak se te popullatat e tjera myslimane një indikator qendror i identitetit.

Jam i bindur se zviceranët do të kishin votuar ndryshe për minaret nëse në mediet dominante do të kishin pasur rastin t'i dëgjonin albanofonët për raportin e tyre me fenë, i cili është shumë i ngjashëm me atë të zviceranëve. Islami i tyre është ai i shkollës hanefite, liberal, ai obligohet t'i përshtatet situatës lokale. Shkoni në Tiranë, ai është një qytet që na mëson se si pluralizmi mund të ushtrohet në harmoni të plotë. Është grandioze, se si shkojnë martesat e përziera! Feja nuk është për nxitjen e konflikteve, përkundrazi.

Për fund: Ku ka ngelur, sipas mendimit tuaj, zhvillimi i imazhit?

Ndryshimi është i qartë dhe, fundja, ka avancuar shumë shpejt, por ai vjen vonë. Duhet të ngutemi të integrohemi më mirë ndër vendësit, apo zviceranët me prejardhje tjetër a shqiptare. Gjeneratat e reja të zviceranëve me prejardhje shqiptare akoma nuk ndihen shumë mirë me kulturën e tyre. Ata janë të prirur t'i shmangen, ta fshehin këtë sfond në shkollë apo tjetërkund. Kjo hipotekë duhet të pajiset me një element pozitiv, ajo duhet të shihet si një atu për t'u integruar më mirë në Zvicër, pa frustrim për identitetin. Ky për mua është integrimi i vërtetë, i bukur. Berisha duhet të bëhet një emër zviceran dhe të themelojë një gjenealogji zvicerane, sikurse është rasti me emrat italianë.

Zvicra ka aftësinë të pranojë njerëz, duke u ofruar atyre një ngritje sociale. Por, në rrafshin kulturor ka ende shumë për të bërë. Ndryshimi është në proces, ka marrë hov, por duhet furnizuar me karburant, për t'ia dalë mbanë. Në futboll kjo sot po shkon shumë mirë, por duhet të ecë edhe në fushat e tjera.

Basil Schader

NËSE ASIMILIMI KUPTOHET SI ÇMIM PËR INTEGRIMIN, KY DO TË ISHTE NJË KEQKUPTIM TRAGJIK

Basil Schader është profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Cyrih dhe udhëheqës i seksionit «Gjermanishtja si gjuhë e dytë». Ai ka doktoraturë në gjermanistikë e albanologji, është autor i librave dhe teksteve të ndryshme shkollore dhe veprave shkencore e didaktike.

Zoti Schader, si mund të përshkruhet imazhi i shqiptarëve në Zvicër?

Kjo pyetje është shumë e përgjithshme. Unë dëshiroj ta diferencoj atë në këtë mënyrë: Cilat grupe në Zvicër kanë çfarë imazhi të cilave grupe të shqiptareve dhe shqiptarëve? Dhe këtu – gjithashtu, në mënyrë të thjeshtëzuar – një përgjigje do të ishte ndoshta kjo: Në perspektivën e qarqeve dhe të shtypit të djathtë populist, imazhi i shqiptarëve është – i fokusuar kryesisht te të rinjtë dhe të tillë, të cilët janë ndjekur penalisht – negativ. Në qarqet më mirë të informuara dhe që mendojnë në mënyrë të diferencuar, kjo duket ndryshe. Kundrejt paragjytimeve dhe gjykimeve paushalle ka më shumë kujdes dhe shqiptarët këtu nuk perceptohen si një grup homogjen, gjë që vërtet edhe do të ishte një non sens.

Cilët faktorë kontribuojnë në krijimin e prestigjit të një grupi?

Edhe kjo është një pyetje goxha fundamentale. Unë do ta marr vetëm një aspekt, i cili i ka prekur dhe pjesërisht vazhdon t'i prekë edhe shqiptarët. Është fjala për rolin e «kokës së turkut», apo grupit me prestigjin më të ulët, që në Zvicër (e me siguri edhe në vendet e tjera të emigracionit) vazhdimisht i vishet një grupi të caktuar. Kjo ndodhi në vitet 1950 dhe 1960, kur ishin italianët, të cilët vlenin si të zhurmshëm, të pacivilizuar dhe të rrezikshëm për gratë tona. Pastaj «kokë e turkut» u bënë jugosllavët (të ashtuquajturit «Jugo») dhe së fundmi shqiptarët, me të cilët i lidhnin klishe si «të dhunshëm», «që bien në sy», «shoferë të tërbuar» etj. Aktualisht, ky rol po zhvendoset te refugjatët nga Afrika dhe veçanërisht te të rinjtë veriafrikane. Në njërin anë, kjo valë migracioni, në anën tjetër integrimi gjithnjë e më i mirë i shqiptarëve (dhe jo vetëm arritjet e tyre në futbollin zviceran!) po çojnë ndoshta mu tani në një transformim të prestigjit të shqiptarëve edhe

në perceptimin e qarqeve që mendojnë në mënyrë më pak të diferencuar. Në këtë kontekst janë interesante paraqitjet e ndryshme që kam marrë kohët e fundit nga gazetarë për temën «shqiptarët e integruar mirë»: Transformimi i rolit të shqiptarëve nga delja e zezë të bashkëqytetari i mirintegruar i ka rënë në sy shtypit, sidomos në kontekst të valëve të reja të emigracionit – aq më tepër që nga grupi i madh i emigracionit shqiptar – 200.000-250.000 veta – këto klishe i përgjigjeshin dhe i përgjigjen vërtet vetëm një pakice të vogël.

A keni një hipotezë për imazhin që e kanë shqiptarët?

Për imazhin negativ të mëhershëm, sikur që është kultivuar dhe stërholluar në ca qarqe, në masë të madhe përgjegjëse ka qenë propaganda e shtypit të djathtë populist. Ajo me këtë i ka shërbyer nevojës së atyre shtresave popullore, të cilat mjaftohen me modele dhe sqarime të thjeshta, klishe dhe etiketime. Këto qarqe u ushqyen me raportet për shqiptarët e rënë në sy dhe për problemet me integrimin, por që shkaqet dhe implikimet e të cilave më shumë nuk u reflektuan.

Për përmirësimin aktual të imazhit dhe prestigjit të shqiptarëve dhe shqiptarëve, në njërin anë, me gjasë është përgjegjëse zhvendosja e rolit të «kokës së turkut» dhe gogolit tek migracioni i ri afrikan, por sidomos mirintegrimi i pashmangshëm i pjesës më të madhe të komunitetit shqiptar, shumë prej të cilëve ndërkohë e kanë edhe shtetësinë zvicerane.

Në çfarë mase mund të ketë ndikuar vetë sjellja e shqiptarëve në prestigjin negativ të tyre?

Duke i përjashtuar veprat penale të një pakice të vogël të shqiptarëve, të fryra fort nga mediet, mund të ketë dallime kulturore, të cilat, varësisht nga receptimi i tyre, mund të perceptohen si problematike. Unë po e përmend, për shembull, përkatësinë fetare islame të shumicës së shqiptarëve, e cila në kontekstin e islamofobisë aktuale mund të çojë në paragjykitime, edhe pse shqiptarët në pikëpamje fetare tradicionalisht janë jashtëzakonisht tolerantë. Ose, për ta përmendur një pikë tjetër, mund të merren ato gra shqiptare, të cilat paraqiten të veshura në mënyrë shumë tradicionale, e edhe pas 20 vjetësh qëndrimi në Zvicër pothuajse nuk flasin fare gjermanisht, sepse ato lëvizin vetëm në qarqet e tyre shqiptare dhe në familje. Që të rinjtë shqiptarë bien në sy me sjelljen e tyre më shumë se vendësit, që do të ishte një shembull i tretë, kjo vendoset më shumë në rrafshin e klisheve dhe zor se provohet nga hulumtimet serioze, ose nga statistika.

Nga e gjithë kjo del qartë se shqiptarët vetë (sikur zviceranët dhe të gjitha grupet e tjera) mund të kontribuojnë shumë në prestigjin dhe perceptimin e tyre dhe këtë tanimë edhe e kanë bërë. Por, këtu gjithmonë duhet pyetur se kush dhe nga cili sfond çfarë arritjesh mund dhe duhet të sjellë në integrim dhe kush (për shembull, sa i përket ndjekjes së kurseve të gjermanishtes, apo sa i takon bashkëpunimit me sistemin shkollor zviceran) do të kishte nevojë së paku për përkrahje dhe ndihmë bazë.

Ku shihet saktësisht përmirësimi i statusit të integritetit të shqiptarëve në Zvicër, që njerëzit po bëjnë karrierë, po përjetojnë ngritje... – a vjen kjo nga mediet, apo nga përvojat direkte?

Besoj që shumë njerëz këtë e shohin nga përvoja direkte. Sigurisht që janë edhe artikujt e gazetave, apo edhe disa statistika, por akoma më të rëndësishëm e mbaj vështrimin autentik dhe të përditshëm. Në spitale, në shitje, në sportelet e hekurudhave dhe të postës, në pozita me përgjegjësi të të gjitha ndërmarrjeve të mundshme, në mënyrë të vetëkuptueshme janë të pranishëm shqiptarë dhe shqiptarë, dhe njëloj natyrisht edhe në shkolla të larta, ku gjenden gjithnjë e më shumë studentë shqiptarë. Ky zhvillim sigurisht që do të vazhdojë, sikur ka vazhduar te italianet e italianët dhe grupet e tjera të emigracionit. Meraku im i vetëm është që disa të rinj shqiptarë i harrojnë dhe i lënë pas dore rrënjët dhe potencialet e tyre shqiptare. Kjo në mënyrë tragjike po konfirmohet, për shembull, te kompetencat shpesh shumë të dobëta në gjuhën letrare e të shkrimit edhe te pjesëtarët, zaten jashtëzakonisht të suksesshëm, të gjeneratës së dytë e të tretë të shqiptarëve në Zvicër, apo në përqindjen turpërisht të vogël të fëmijëve dhe të të rinjve që e ndjekin shkollën shqipe. Nëse asimilimi kuptohet si një çmim për integrimin, ky do të ishte një keqkuptim tragjik. Zvicra tradicionalisht partikulare jeton nga resurset dhe potencialet që sjellin dhe kultivojnë njerëzit e proveniencave të ndryshme.

A ishte imazhi i shqiptarëve shpesh objekt bisedash në përditshmërinë tuaj – si profesionalisht, si privatisht?

Jo, kjo me siguri nuk ka qenë temë qendrore. Në kuadër të angazhimit tim profesional dhe jashtëprofesional, përfundimisht më e rëndësishme ka qenë çështja se çfarë mund të bëjmë në kuptimin e avancimit dhe integritetit të fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë, si mund të kontribuojmë në përkrahjen e mësimin në gjuhën shqipe, të prejardhjes dhe mjeteve të tij etj.

Cilat janë përvojat tuaja personale me komunitetin shqiptar në Zvicër?

Unë, vërtet, si të thuash, kam vetëm përvoja të mira. Kjo lidhet edhe me faktin që di shqip. Kjo i gëzon të gjithë dhe shpie te ajo që unë jam i pranuar dhe i vlerësuar. Unë për veten time i çmoj fort shqiptaret dhe shqiptarët. Kuptohet që kontakti nuk është gjithmonë spontan, por kjo është normale. Ndërkaq, në mesin e shqiptarëve, sikur të të gjithë njerëzit, ka të tillë që për nga interesat dhe formimi më janë më të ngjashëm se të tjerët, por kjo nuk e influencon përzierësinë dhe afërsinë e raportit.

Claudio Bolzman

DINAMIKA E KËTIJ KOMUNITETI MË IMPRESIONON

Prof. Dr. Claudio Bolzman është sociolog në Shkollën e Lartë Profesionale Zvicra Perëndimore (HES-SO) dhe në Universitetin e Gjenevës. Fushë e specializimit të tij janë çështjet e migracionit dhe rrugëtimit jetësor. Ndër të tjera, më 2003 ai ka botuar një libër, i cili nxjerr që fëmijët e gjeneratës së dytë me origjinë spanjolle apo italiane kanë sukses në shkollë.

Si u ballafaquat me çështjen e imazhit të shqiptarëve në Zvicër?

Së pari, nga artikujt e gazetave dhe nga studimet e kolegëve, para së gjithash në lidhje me diskriminimin e shqiptarëve (pavarësisht nëse vijnë nga Kosova, Maqedonia apo tjetërkund) në tregun e punës dhe në kërkimin e vendeve për mësim profesional. Unë kam udhëhequr punime të ndryshme studentësh shqiptarë: të licencës, masterit, apo punime doktorature. E kam udhëhequr një studim për të moshuar me prejardhje shqiptare në Zvicër dhe aktualisht po bëjmë një studim për karrierën e fëmijëve me prindër shqiptarë dhe kalimit në jetën e të rriturve. Përveç kësaj, jam rregullisht në kontakt me shoqëritë shqiptare, UPA-n, ISEAL-in dhe albinfo-n.

Si është mendimi juaj personal për këtë imazh?

A mund të flitet për një imazh, apo fjala është për imazhe të ndryshme? Natyrisht, ka një imazh mbizotërues të një komuniteti, i cili tregon vështirësi integrimi, çka po nxitet nga mediet. Por, ky nuk është imazhi i vetëm që ekziston. Përmes sportit mediet po përhapin një imazh pozitiv.

Mbi bazën e studimeve të mia dhe atyre të kolegëve të mi, e shoh krejt qartë se imazhi i parë nuk përkon me realitetin. Numri i ndërmarrësve brenda komunitetit shqiptar si dhe numri i të rinjve që studiojnë në universitete, apo në shkolla të larta profesionale, është impresionues. Megjithatë, ngelin paragjykime, të cilat kanë një efekt konkret në rrugëtimet jetësore personale. Njëfarë diskriminimi shfaqet që në shkollë dhe pastaj me hyrjen në jetën profesionale, apo në mësimin profesional.

Nëse e krahason komunitetin albanofon me komunitetet e tjera, që në Zvicër kanë ardhur në të njëjtën kohë, ky komunitet shfaq një prej rrugëtimeve jetësore më të ndryshme të pjesëtarëve të tij. Prindërit kanë formime thelbësisht të ndryshme nga ç'është rasti me komunitetet turke apo portugeze. Shumë

migrantë albanofonë kanë një shkollë të mëtutjeshme, apo madje kanë kryer një shkollim universitar. Megjithatë, një pjesë e tyre nuk gjejnë një punë konform formimit që kanë. Në Zvicër ata janë punëtorë, gjersa ndoshta kanë një formim administrativ, apo shkollim të lartë. Kjo shpjegohet me faktin që kanë vështirësi me njohjen e diplomave, apo nganjëherë paraqiten vështirësi personale për t'u përshtatur, por ka edhe njëfarë diskriminimi në tregun e punës.

A ka ky diversitet efekte për gjeneratën që vjen?

Nëse e krahason karrierën shkollore, fëmijët albanofonë, sikur ata portugezë dhe turkofonë, pas mbarimit të shkollimit të obliguar janë të mbipërfaqësuar në shkollimet afatshkurta, zgjidhjet e ndërmjetme, apo madje tek ato që nuk kryejnë ndonjë shkollim. Por, ndryshe prej turqve dhe portugezëve, albanofonët, nëse pas mbarimit të shkollimit të obliguar gjenden në tipat shkollore me kërkesa themelore apo të tjera, janë të mbipërfaqësuar edhe tek ato, të cilëve u ec të bëjnë një shkollim të lartë. Aty ata janë të përfaqësuar proporcionalisht, madje më të numërt se zviceranët.

A e keni ndjenjën se opinioni publik e percepton këtë sinjal të një integrimi të mirë?

Mjerisht, pak. Nëse kjo nuk shprehet në trajta të dukshme, sikur te futbollistët zviceranë me origjinë shqiptare, nuk perceptohet fakti që komuniteti shqiptar është i përfaqësuar në të gjitha fushat profesionale të shoqërisë zvicerane. Opinioni më shumë orientohet nga problemet, sesa nga sukseset. Sipas mendimit tim, ende ekziston një shtrembërim imazhi. Komuniteti shqiptar, nga ana e tij, po ndërmerr përpjekje fort të rëndësishme për t'i dhënë vetes një imazh më të mirë, por shoqatat e përfshira nuk kanë sukses ta arrijnë publikun në ato përmasa siç e kanë të mundur mediet, apo partitë politike.

A mendoni se futbollistët kanë luajtur një rol të madh në lidhje me imazhin?

Prania e tyre sjell përparësi, por ngel diçka e ndërlikuar. Kur fiton Kombëtarja, imazhi rritet, por sapo ekipi tregon dobësi, njerëzit kujtohen në prejardhjen e tyre shqiptare. Kjo ka qenë që në vitet 1990 me Kubilay Türkyilmaz kështu. Kur fitonte Zvicra, flitej për zviceranin Türkyilmaz, kur ky luante keq, atëherë ai ishte lojtari me prejardhje turke, që nuk i përmbushi pritjet.

Pra, ju mendeni që mediet kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në formimin e opinionit dhe nuk transmetojnë ndonjë pamje shumë të favorshme në lidhje me shqiptarët në Zvicër...

Është e qartë që mediet në një shoqëri kombëtare, që është tepër e madhe për t'u njohur dhe diskutuar me njëri-tjetrin, marrin një rol qendror në krijimin e një shoqërie të ashtuquajtur të prezantuar. Ato janë ndërmjetësues që krijojnë imazhe të përbashkëta, një «opinion publik». Unë nuk do t'i fusja të gjitha mediet në një thes, por ato që merren me gazetari sensacionale nuk e transmetojnë informacionin që një shoqëri është integruar mirë.

Në një studim, të kryer dhe të publikuar më 2010 nga Sekretariati Shtetëror për Migracion, raportohet për imazhin shumë negativ të kosovarëve në vitet 1990, që lidhet me delikuencë, trafik droge dhe shoferët e tërbuar «jugo». A nuk ka ndodhur që nga këto vite ndonjë zhvillim?

Flitet më pak për to, sepse çdo gjeneratë i zëvendëson viktimat e mëparshme me një grup të ri të migrantëve në opinionin publik. Sociologu Norbert Elias i dallon të etabluarit dhe të distancuarit. Kosovarët po zhvendosen gradualisht në anën e të etabluarve. Vendin e të distancuarit ata ua kanë lënë kryesisht, por jo krejtësisht, kategorive të reja të migrantëve dhe azilkërkuesve.

A nuk mungon edhe një identifikim pozitiv, një rol, të cilin për italianët e luanin piceritë, për ta kthyer imazhin në pozitiv?

Shqiptarët kanë një kuzhinë të shkëlqyer, atë e zbulon kur ata kremtojnë festa. Dhe, ka shumë elemente të tjera pozitive në kulturën e tyre. Përse, pra, ata nuk ia kanë dalë që t'i shesin ato si italianët a spanjollët? Kjo është një pyetje e mirë dhe pak enigmatike.

A nuk ka diçka si misteri shqiptar? Pak zviceranë e dinë që ata...

Komuniteti pa dyshim prirej tepër fort që të mbrohej, që për një kohë të mos dukej, duke qenë se identiteti i tij për një kohë të gjatë ishte i kërcënuar. Kjo shfaqej para së gjithash te endogamia, dëshira që fëmijët bashkëshortët e tyre t'i kërkojnë brenda komunitetit.

Më tepër se te komunitetet e tjera migrante?

Po. Dhe, aktualisht, kjo mbetet kështu. Por, unë besoj që rezervat lidhur me identitetin e tyre po bien dhe se kjo në të ardhmen do të ndryshojë. Sa të ndodhë kjo, kjo endogami e fortë pamundëson që kultura e tyre të përhapet

në fusha të tjera të shoqërisë, sikur te italianët, apo te spanjollët.

Por, dinamika e këtij komuniteti më entuziazmon, megjithatë. Aktualisht ajo e tregon, para së gjithash, njëfarë nevojë dhe një vullnet të theksuar për t'u dukur. Është unike të hartosh kaq shumë studime dhe artikuj, apo t'i krijosh gjithë këto shoqëri, si ISEEAL-i, UPA-ja dhe albinfo. Politikanë të njohur zviceranë, në detyrë, ulen në kryesitë e këtyre shoqërive, çka është shumë pozitive, duke qenë se edhe politika luan një rol shumë të rëndësishëm në formimin e opinionit.

Në shikimin tim, fotografitë e para të një takimi shpesh nguliten për shumë gjatë dhe e influencojnë pikëpamjen e mëvonshme. Ardhja e befasishme e dhjetëra mijëra kosovarëve në Zvicër, e provokoi një dukshmëri të këtij komuniteti në një moment kur kishte vështirësi integrimi, sikurse ka çdo migrant rishtar, i cili nuk e njeh mirë Zvicrën.

Edhe pse komuniteti ka ndryshuar shumë dhe është integruar më mirë, pamjet e vështirësive fillestare janë ngulitur në kokë. Ato do të zhduken me kohën. Edhe italianëve e spanjollëve u duhej kohë dhe kur migrantë të rinj i spostuan ata, atëherë dolën si migrantë më të mirë, sepse ishin prej kohësh këtu.

Pra, paguhet akoma çmimi i këtij imazhi të keq fillestar?

Gjërat, mjerisht, nuk ndryshojnë kurrë kaq shpejt. Imazhi po përmirësohet, kjo është në rrugë të mirë, por duhet kohë. Pika qendrore e kthesës, e cila e ka favorizuar një integrim më të mirë, sipas mendimit tim, ka qenë pavarësia e Kosovës. Para kësaj, shumë shqiptarë i qëndronin idesë për t'u kthyer dhe për ta vazhduar jetën atje. Pas pavarësisë, mitologjia e kthimit kryesisht u zhduk. Ata u vetëdijesuan, se kjo do të ishte shumë më e vështirë se ç'e kishin imagjinuar dhe se vendi i tyre ndodhej në një gjendje tepër të vështirë. Së këndejmi, ata kanë ndërmarrë përpjekje të përforcuara për t'u integruar. Ata i kanë inkurajuar fëmijët e tyre të bëjnë një shkollë të mirë, apo të kërkojnë një vend pune të kënaqshëm. Unë flas me shumë shqiptarë dhe ata më thonë se do të kishin bërë me kënaqësi biznese në Kosovë, apo se duan të kthehen atje, por se kjo qenkësh tepër e vështirë dhe ata prandaj po mësohen me jetën e tyre këtu. Ky është një aspekt i ri.

Etienne Piguet

NJERËZIT I DUAN KLISHETË

Etienne Piguet është profesor në Fakultetin e Gjeografisë të Universitetit të Nëshatelit dhe nënkryetar i Komisionit Federal të Migracionit. Prej më shumë se 20 vjetësh ai e vrojton rrjedhën e politikës dhe të emigracionit në Zvicër.

Zoti Piguet, si do ta përshkruanit imazhin e shqiptarëve në Zvicër?

Në gjykimin tim, i cili nuk i referohet ndonjë vëzhgimi shkencor, këtu bëhet fjalë për një rast klasik të një transformimi progresiv të imazhit me kalimin e kohës.

Kishte një fazë të parë të emigrimit të shqiptarëve, kryesisht nga Kosova, që karakterizohet nga ndonjë transparencë. Ata ishin punëtorë dhe kryesisht burra, të cilët u rekrutuan nga Zvicra. Kjo gati u harrua. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore ka pasur një rekrutim të fuqisë punëtore nga Italia. Kur ky burim u shterua, atëherë u sollën njerëz nga Spanja, pastaj nga Portugalia dhe nga ish-Jugosllavia. Kosova ishte një regjion i rëndësishëm në vitet 1980, por edhe më parë. Këta punëtorë ishin shumë të dobishëm për ekonominë zvicerane. Ata ishin fleksibël dhe të gatshëm të kryenin punë të rënda.

Por, këto kontingjente ishin të padukshme, kryesisht burra pa familje. Gati nuk vërehej që ekzistonin. Kur stagnoi zhvillimi ekonomik, ata pjesërisht duhej ta lëshonin Zvicrën. Kjo ka ndodhur në vitet 1970, por edhe në fillim të viteve 1990. Në këtë kohë, saldoja e emigracionit për disa vjet ishte negative. Kjo domethënë që shumë prej atyre që e humbën punën duhej të ktheheshin. Ishin pasojat e modelit tradicional zviceran, i cili nuk ishte domosdoshmërisht human.

Pastaj erdhi i ashtuquajtur i Modeli i njohur i Tre Rrathëve; Jugosllavia u pa si një vend tradicional. Në këtë kohë filluan trazirat politike në Jugosllavi; fillimisht në veri, më pas edhe në jug të federatës. Më 1991 erdhi vendimi i Zvicrës, me të cilin Jugosllavia nuk u klasifikua si një vend rekrutimi. Ky është një moment i rëndësishëm, sepse nga këtu për njerëzit nga Kosova ishte më vështirë për të ardhur si punëtorë në Zvicër. Nga ky moment u shpeshtuan kërkesat për azil; edhe për shkak të gjendjes së vështirë politike në vend. Në këtë kohë u shfaq një fytyrë e dytë e shqiptarëve; nuk ishin

më ata punëtorët e mëparshëm të padukshëm, por refugjatët. Me këtë rast harrohet që arsyeja përse shumë njerëz nga Kosova kërkonin strehim në Zvicër ishin të afërmit e tyre, që tanimë jetonin në Zvicër.

Kishte faza kur shqiptarët shiheshin si refugjatë, por u shfaqën edhe problemet me trafikun e drogës. Në vitet 1990 ndodh një përkeqësim i imazhit të shqiptarëve në Zvicër, megjithëse bëri një mot i bukur i reputacionit të shqiptarëve në vitet 1999-2000, gjatë spastrimeve etnike dhe deportimeve. Kjo shprehej në trajtë të mirëkuptimit për praninë e tyre. Ky qëndrim vërtet nuk zgjati shumë, por e shënoi një kthesë ndaj shqiptarëve në Zvicër.

Vështirësitë erdhën përsëri në vitet 2000. Ishte një kthesë tjetër, sepse me Marrëveshjen për Lëvizjen e Lirë me BE-në për njerëzit në Kosovë bëhet akoma më vështirë për të ardhur në Zvicër. Kështu, ata nuk ishin më në qendër të vëmendjes së opinionit. Edhe për faktin që ata ndërkohë u integruan në shoqëri. Në shumë fusha ata ranë në sy si punëtorë të mirë. Por, në disa qarqe të shoqërisë zvicerane dominonte ende imazhi i shqiptarëve të viteve 1990 – si refugjatë, trafikantë droge etj. Në gjykimin tim, në pjesën më të madhe janë të pranuar. Sot janë afrikanët me ngjyrë, myslimanët..., të cilët po konfrontohen me mosbesim. Sigurisht myslimanë, të cilët e përfaqësojnë një islam konservator, çka për shqiptarët myslimanë vlen vetëm rrallë.

Sipas përshkrimit tuaj të zhvillimit të emigracionit shqiptar në Zvicër, imazhi i shqiptarëve nuk është as i i zi, as i bardhë, por më shumë gri...

Po, kishte periudha të errëta dhe më të bardha. Unë jam optimist. Tendenca po shkon në një drejtim të mirë.

Sa i përket imazhit negativ, shqiptarët kanë rënë në sy më shumë si trafikantë droge. Është folur edhe për shpërdorim të rrjetit social... Çfarë ka ngelur më së shumti në kujtesë nga ky imazh negativ?

Në shikimin tim, akuza e shpërdorimit të mbështetjeve sociale në debatin e përgjithshëm për migracionin në Zvicër ekziston. Dhe, kjo është shumë e ashpër. Personalisht, në vitet 1990 në kokat e zviceranëve e kam vërejtur një lidhje më të ngushtë ndërmjet shqiptarëve dhe trafikut të drogës. Kjo sot nuk ekziston. Kjo veti u përshkruhet afrikanëve me ngjyrë. Shpërdorimi i rrjetit social vlen më shumë për azilkërkuesit. Dhe, natyrisht, atëbotë shumë azilkërkues ishin shqiptarë nga Kosova. Prandaj edhe kjo lidhje. Madje ka pasur edhe një shpjegim etnik për marrëdhënien ndërmjet identitetit shqiptar dhe delikteve e trafikut të drogës. Ekzistonte ideja se shqiptarët jetonin në

rrethe kulturore me struktura klani, çfarë do ta përbënte një parakusht për mafien. Kjo është e papranueshme, por përbënte një paraqitje ideale për shpjegime të thjeshta: shqiptar-klan-mafie-trafik droge, që funksiononte. Mund të jetë që perceptimi i këtij komuniteti në regjione të ndryshme të vendit është i ndryshëm.

A keni një shpjegim eksPLICIT, domethënë një hipotezë, si është krijuar ky imazh?

Kishte shumë faktorë të cilët kanë ndikuar njëkohësisht. Në vitet 1960, në fillim të emigracionit italian është folur shumë për një dallim kulturor. Në fillim erdhën njerëz nga veriu, pastaj nga jugu. Kur arritën këta të fundit, thuhej se kishin shprehje të tjera jetese: një raport tjetër me gratë, hanin ndryshe... Kjo ideja e dallimit kulturor u thirr edhe në vështrimin e shqiptarëve në vitet 1990. Dallimi me atë konsiston në faktin që atëbotë pothuajse nuk kishte papunësi. Nuk ishte problem të gjeje një vend pune. Dhe, nëse nuk mund të gjeje një punë, duhej ta lëshoje vendin. Në vitet 1990, papunësia ishte vërtet e ulët, por ishte e pamundur t'i dëboje azilkërkuesit. Kishte shumë të papunë, sikur nuk kishte pasur me emigracionin italian. Përveç kësaj, atëherë nuk ka ekzistuar mundësia e trafikut të drogës në këto përmasa. Kështu u identifikua një grup problematik në kuptimin kulturor dhe penal. Ky asociim me mafien për italiano-jugorët ishte gjithashtu i mundur. Atëbotë mungonte papunësia dhe trafiku i drogës.

Këto asociacione lindin nga kontaktet e drejtpërdrejta të qytetarëve me komunitetin shqiptar në këtë rast, apo...? Cilët janë mekanizmat që kontribuojnë në krijimin e tij?

Për ta rikonstruktuar një reputacion të tillë, duhen disa raste problematike. Dhe, mjafton që vetëm disa raste problematike të dalin në medie dhe njerëzit të flasin për këtë. Apo ata bëhen dëshmitarë të pakëndshmërive në rrugë dhe zë fill përgjithësimi. Po kjo vlen edhe për një shpërdorim të rrjetit social. Mjafton një raport për një rast në «Blick», dhe menjëherë mendon se të gjithë ata që i kanë këto karakteristika janë të prirur për këtë. Njerëzit i duan klishtë.

Teza se mediet kanë kontribuar që komunitetet e emigracionit ta kenë një emër të keq ekziston sigurisht... A mendoni edhe ju se raportimi mediatik për shqiptarët në Zvicër ishte apo është tendencioz?

Sigurisht që mediet e luajnë një rol, kjo është e qartë. Por, mendoj se mediet në Zvicër raportojnë në mënyrë të diferencuar. Natyrisht ka gazeta bulevardeske, si «Blick» apo «Le Matin», por ato nuk krahasohen me atë që vërehet në Britaninë e Madhe. Atje niveli i gazetarisë së verdhë është vërtet shumë më i ulët se ky në Zvicër.

Unë do të thosha që një rol në këtë marrëdhënie e luajnë edhe autoritetet. Shpeshherë në diskursin e tyre kishte, për shembull, paqartësi lidhur me refugjatët të vërtetë dhe të rremë. Kur Jugosllavia më 1991 u degradua në Rrethin e Tretë, diskursi që dominonte ishte se ekzistonin shumë dallime kulturore. Gjithsesi, unë nuk do t'i përcaktoja mediet në mënyrë paushalle si shkak.

Shtoji kësaj faktin se ishte një segment i paprivilegjuar shoqëror që bart edhe trauma...

Arsyet e emigrimit natyrisht janë shumë të ndryshme. Nga një grup i emigracionit pret një diskurs të përbashkët dhe një strukturim me njerëz, të cilët mund të flasin në emrin e tij. Sigurisht që pas një lufte pavarësimi, shoqëria është e ndarë. Kjo është e vështirë për ta kuptuar vendet nikoqire.

Kohët e fundit, në mediet gjermanofone ka pasur disa artikuj që i çmojnë përpjekjet e shqiptarëve për t'u integruar. A ju ka rënë juve në sy një raportim pozitiv për shqiptarët në Zvicër?

Po, kjo është shumë e qartë. E para, kjo ka të bëjë me realitetin. Ka një emigracion shqiptar shumë të diferencuar – tani e kemi gjeneratën e dytë. Dhe, gjeneratës së dytë në Zvicër kryesisht i ecën mirë. Kemi studime për italianët, spanjollët... e edhe për shqiptarët. Këto tregojnë që fëmijët po gjenden më mirë se prindërit. Tingëllon e vetëkuptueshme, por ky është një sukses për një komunitet emigracioni. Në vende si Franca apo Holanda, gjërat nuk po zhvillohen domosdoshmërisht në drejtimin që fëmijët të dalin më mirë se prindërit. Atje prindërit kanë ardhur si punëtorë dhe fëmijët janë të papunë. Ne në Zvicër jemi të lumtur që tregu i punës është i hapur dhe gjenerata e dytë po e kap shansin. Shkollat nuk janë të ndara në «të mira» dhe «të këqija», pothuajse të gjithë i ndjekin të njëjtat shkolla. E kanë në dorë vetë fëmijët të nxjerrin më shumë nga ajo. Këtë e kanë vërejtur mediet. Pra,

ka të bëjë me realitetin dhe me vullnetin e mirë të medieeve, të cilat nuk po shihen si aq miqësore ndaj emigrantëve, sepse raportojnë shpesh për delikte. Dëshirojnë të paraqiten si të balancuara dhe i sjellin këto suksese. Por, këto suksese janë një e vërtetë dhe këta janë shembuj të mirë për të ardhmen.

Cilat janë përvojat tuaja me komunitetin shqiptar në Zvicër – qofshin private apo profesionale?

Unë kam kontakte me intelektualë, të cilët pjesërisht janë për një kohë të gjatë në Zvicër. Janë një shtresë njerëzish nga Kosova, Shqipëria – një diferencim, i cili nuk është rasti me të gjitha grupet në Zvicër. Shpresojmë që në të ardhmen do të kemi më shumë studentë me prejardhje shqiptare nëpër universitete. Edhe pse gjenerata e dytë pjesërisht është ende e re... Kështu, unë aktualisht nuk kam shumë studentë shqiptarë, por ata ekzistojnë.

Njoh edhe disa që punojnë në gastronomi; por ata nuk mund të identifikohen menjëherë se janë shqiptarë. Tamilet nga Sri Lanka kanë ardhur në të njëjtën kohë si shqiptarët në Zvicër. Ata identifikohen mirë si të huaj. Ata janë edhe në numër më të vogël në Zvicër. Tek ata ka edhe më pak martesë të përziera.

A ka qenë imazhi i shqiptarëve shpesh temë në rrethin tuaj?

Jo, vërtet! Unë merrem me çështje të emigracionit, por jo edhe aq me identitetin, komunitetin dhe integrimin, por më shumë me zhvillimet demografike. Megjithatë, e kam pasur një përvojë interesante, që është shumë e rëndësishme. Ndoshta jam shumë optimist në pohimet e mia, por kur është fjala për diskriminimet në tregun e punës, këtu diçka lë për të dëshiruar. Këtu ka një diskriminim të njerëzve që kanë emër shqiptar.

Më 2003 e kemi kryer një studim – «Nomen est omen: Quand s'appeler Pierre, Afrim ou Mehmet fait la différence». Ne dërguam dosje aplikimi të njerëzve fiktivë me profile krejt identike. Kështu kishim mundësinë të identifikonim sa përgjigje do t'u vinin kandidatëve me emra zviceranë dhe sa atyre me emra portugezë... dhe shqiptarë. Rezultati: Për ftesë në një intervistë, një zvicerani i duheshin tri aplikime, një kandidati me emër shqiptar shpesh i duheshin tri herë më shumë aplikime.

Ky ishte një problem i shpërfillur. Studimi ynë ishte i pari që ka tërhequr vëmendjen nga ky problem. Shpresoj që ndërkohë situata e shqiptarëve në tregun e punës ka ndryshuar, edhe pse është vështirë ta luftosh këtë. Në njërën anë mund të ketë të bëjë me ksenofobi të kulluar, por nuk është e thënë të jetë

patjetër kështu. Ka situata kur merr 50 aplikacione dhe duhet të përzgjedhësh sa më shpejt që të jetë e mundur. Atëherë përjashtohen me automatizëm të gjithë kandidatët që nuk u përgjigjen përfytyrimeve standarde; për shembull ata që nuk kanë emra zviceranë etj.

Në total, imazhi i përgjithshëm i shqiptarëve në Zvicër është më i mirë se atëbotë, por vazhdon të ketë diskriminim dhe vështirësi të ngjashme.

Çfarë duhet bërë që kjo të përmirësohet?

Shoqëria zvicerane njëherë duhet ta pranojë që ka diskriminim. Për këtë duhet të diskutohet. Çështja është nëse duhet shkuar më tej, apo vetëm të diskutohet për të dhe të pritët. Unë këtu jam i ndarë, nëse kjo duhet ilegalizuar dhe të sillët një ligj kundër diskriminimit. Një ligj të tillë është në Britaninë e Madhe, ku mund të ankoresh kundër diskriminimit. Diçka flet për këtë, por mund të jetë edhe kundërproduktiv.

Nga ana e komunitetit të emigrantëve duhen afirmuar persona prominentë dhe histori suksesi, që kanë rrënjë shqiptare dhe për të cilat nuk dihet. Kjo tregon që këta njerëz janë të aftë dhe nuk ka arsye për diskriminim.

Martine Brunschwig Graf

KA NJË IMAZH TË MIRË DHE NJË JO AQ TË MIRË

Martine Brunschwig Graf është kryetare e Komisionit Federal Kundër Racizmit dhe anëtare e Partisë Liberale. Ajo ka qenë ministre në Qeverinë e Gjenevës nga 1993 deri 2005, si dhe deputete në Parlamentin Federal nga 2003 deri më 2011.

Zonja Brunschwig Graf, si do ta përshkruanit imazhin e shqiptarëve në Zvicër?

Është i ndryshëm: Ka një emër të mirë dhe një emër jo aq të mirë. Kemi njerëz shumë të integruar edhe zvicerano-shqiptarë, të cilët transmetojnë një imazh pozitiv. Ekipi zviceran i futbollit jep një shembull të mirë për të rinjtë. Pastaj janë edhe deliktet, të cilat nuk vlejnë vetëm për komunitetin shqiptar, por që shkaktojnë një paushallizim të këtyre rasteve. Ky nuk është observimi im, por një observim. Këtu e sheh shpejt që dhuna dhe shqiptarët e bëjnë një lidhje në kokën e njerëzve. Edhe pse nuk është e justifikuar, sepse ka probleme edhe me komunitetet e tjera dhe me vetë zviceranët. Mjerisht, është kështu.

Do të përmendja, dhe kjo për mua është e re, se shqiptarët sikur po radikalizohen pak në drejtim të fesë. Nuk e di sa thellë shkon kjo, por është vetë komuniteti që flet për këtë. Po shihet një rrezik, që të rinjtë shqiptarë po shkojnë pak në drejtim të radikalizimit. Nuk është saktësisht e njëjta sikur me komunitetet e tjera myslimane, por është më shumë një prirje që po duket.

Si shpjegohet imazhi që e kanë shqiptarët? Cila është hipoteza juaj për këtë?

Për të gjitha komunitetet, të cilat duhet të integrohen në Zvicër, ka klishe. Qoftë në fillim, apo për kohë më të gjatë. Besoj që kjo ka të bëjë më shumë me faktin që, kur ndodh ndonjë e keqe, njerëzit shohin menjëherë nga komuniteti përkatës. I njëjti problem, edhe pse në masë më të madhe, ndeshet me afrikanët, të cilët lidhen me drogën. Kështu nis shumë shpejt paushallizimi. Menjëherë krijohet lidhja: «Ata janë të zinj, pra kanë të bëjnë me drogën». Shqiptarët asociohen shpesh me dhunën. Kjo klishe është ngulitur.

Por, ka edhe shpresë. Tamilët, që kanë ardhur në vitet 1980 dhe 1990, sot janë shumë mirë të integruar. Që integrimi të ketë sukses, merr edhe pak kohë.

Cilat janë përvojat tua me komunitetin shqiptar në Zvicër?

Komunitetin shqiptar e njoh nga koha në Qeverinë e Gjenevës. Ne e kemi përkrahur Universitetin Popullor Shqiptar në Gjenevë. Unë e kam ndjekur zhvillimin e tij dhe ne i kemi ofruar mjetet që ky universitet të mund të punonte. Kjo ka qenë një përvojë e mirë atëbotë. Por, nuk ishte gjithmonë e lehtë. I kam njohur edhe njerëzit të cilët i kanë prirë atij. Para dy vjetësh isha aty për një ligjëratë. Çështja ishte nëse ka një rrezik të radikalizimit të shqiptarëve të rinj. Dhe, unë besoj që ky komunitet në Gjenevë po e bën një punë të mirë bindëse. Ata mendojnë që një element i integritetit është edhe shtetësia zvicerane dhe marrja e përgjegjësisë si qytetarë të Zvicrës; ata ligjërojnë për shtetin ligjor, për sistemin zviceran etj.

Përvojat tua me shqiptarët në Zvicër i referohen vetëm Universitetit Popullor Shqiptar në Gjenevë?

Jo, unë kam, për shembull, edhe kontakte me Institutin Zviceran për Studime Shqiptare në Zvicër. Ne shkëmbejmë me njëri-tjetrin. Kam edhe kontakte të tjera me njerëz që na drejtohen neve, për problemet që kanë, ose për të diskutuar. Janë njerëz të angazhuar. Për Zvicrën është shumë me rëndësi që ka komunitete, shoqatat e të cilave kultivojnë kontakte me autoritetet, ose me Komisionin Federal Kundër Racizmit. Këtë e kam përjetuar më shumë herë.

A ishte imazhi i shqiptarëve shpesh objekt bisedash në përditshmërinë tuaj, qoftë atë profesionale, apo private?

Jo, këtë desha ta them edhe më parë: Shqiptarët nuk janë në qendër të diskutimeve në Komision. Kjo domethënë që nuk ka probleme për të cilat duhet të bisedohet këtu. Edhe në përditshmërinë time sigurisht jo.

A është problemi i imazhit tani më pak prioritar në opinionin publik, duke u nisur nga ajo se ai është përmirësuar?

Nuk mund të them kështu. Mund të bëhet prioritar, nëse ata janë myslimanë dhe ballafaqohen me të njëjtat probleme sikur të tjerët. Domethënë, me një qëndrim kundër myslimanëve. Me këtë trend të islamofobisë, i cili artikullohet në trajtën «të gjithë myslimanët janë të këqij». Kjo reflekton te të gjithë, qofshin këta shqiptarë, apo marokenë, apo zviceranë myslimanë. Në këtë kuptim vijnë probleme, të cilat janë të njëjta për komunitete të ndryshme. Kjo nuk ka të bëjë me atë se këta janë shqiptarë, kjo lidhet, për

shembull, me «Shtetin Islamik» dhe paushallizohet – këtu lindin probleme, për të cilat duhet të flitet. Ne e kemi identifikuar këtë si një problem dhe duhet ta luftojmë.

A mendoni se imazhi i shqiptarëve në fillim ka qenë më i mirë, pastaj është përkeqësuar dhe tani është përsëri më i mirë?

Sikur vërejta më parë, kjo është e ndryshme. Dhe, nuk mund t'i përgjigjem direkt me «po» ose «jo». Në fillim e kishim këtë situatë: Në Kosovë kishte probleme të mëdha, njerëzit duhej të mërgonin në Zvicër dhe këtu duhej të integroheshin. Kur zviceranët e panë se çfarë po ndodhte atje, u solidarizuan me ta. Kjo është e qartë. Pastaj vjen normaliteti. Sot diskutimet janë ndryshe. Njerëzit pyesin se ç'po ndodh me një komunitet të tillë. Imazhi është variabël dhe varet nga ajo nëse ka delikte. Vjen identifikimi doras-shqiptar, apo sido që të jetë – dhe pastaj paushallizimi.

Çfarë shihni për sa u përket shqiptarëve në medie?

Ndoshta vijnë disa shembuj pozitivë më shumë. Edhe në medie. Po shihet çdo ditë se këta njerëz po e luajnë një rol në Zvicër. Qoftë në kulturë, qoftë në sport apo në komunitet etj. Dhe, këta nuk shihen më si shqiptarë, por si prominentë.

Çfarë duhet të bëhet për ta përmirësuar këtë imazh të shqiptarëve?

Duhet parë se si mund të sillesh si qytetar dhe si shqiptar në Zvicër. Jemi zviceranë, apo jetojmë këtu – duhet respektuar shteti ligjor. Është shumë me rëndësi që shoqëria të jetë e aftë ta shprehë këtë dhe t'ua transmetojë të rinjve. Me rëndësi është që të mos biem në komunitarizëm, sepse kështu nuk mund ta përmirësosh imazhin. Duhet një punë e gjatë, sidomos me të rinjtë. Në Zvicër mund ta ruash identitetin e trashëguar, por është shumë me rëndësi që t'i respektosh rregullat dhe ta mësosh gjuhën. Kështu krijohet një imazh i mirë. E kundërta ndodh kur ke përshtypjen se disa nuk dëshirojnë t'u përmbahen rregullave. Detyra e një komuniteti është ta mendojë se përse ekzistojnë këto klishe dhe çfarë mund të bëjë kundër. Dihet që integrimi nuk është një rrugë e thjeshtë. Por, shumëçka varet nga ajo se si t'u shmangesh klisheve.

Edhe shoqëria nikoqire duhet të bëjë diçka, që integrimi të ketë sukses...

Prandaj e përmenda edhe shembullin me Universitetin Popullor Shqiptar, kur shteti ka dhënë para, dhe kjo ishte e drejtë.

Massimo Lorenzi

SPORTI PO I PARAPRIN SHOQËRISË

Massimo Lorenzi është gazetar, redaktor dhe që nga viti 2009 udhëheqës i sportit në Radio Télévision Suisse, si dhe ish-lexues i lajmeve (1993-1998).

Çfarë përvojash keni bërë me komunitetin shqiptar?

Së pari, përmes lidhjeve personale dhe përmes kolegëve të djalit tim të madh. Unë kam qenë dhe vazhdoj të jem në kontakt me shqiptarët. Duke qenë se vetë jam bir migrantësh italianë, shpesh identifikohem më parë me «të huajin» se me vendësin, edhe nëse qëndrimi im është sigurisht një çikë i veçantë, jam më parë i sensibilizuar për situatën e tyre. Meqë ra fjala, unë jam i mendimit se ka disa ngjashmëri ndërmjet shqiptarëve dhe italianëve të ardhur në vitet 1960-70.

Kontaktet e mia të para datojnë nga fillimi i viteve 1990. Unë kam ngrënë shpesh në një piceri në një cep tek ne. Kamerieri ishte shqiptar. Kemi folur për futbollin, e kam pyetur se nga vinte dhe e kam takuar edhe në rrugë. Ne i dukeshim njëri-tjetrit simpatikë dhe një pasdite më tha se do të martohej dhe më ftoi... Kur ndërrova shtëpi, munda të diskutoja me punëtorët e bartjes së mobilieve të cilët ishin kryesisht kosovarë; djali im në shkollë bënte sport me fëmijë kosovarësh... Nuk do të duhej përgjithësuar kaq shumë, por duke qenë se ksenofobët po e bëjnë këtë, unë po e bëj në drejtimin e kundërt: Unë kryesisht kam pasur të bëj me njerëz shumë të sjellshëm. Ata kanë një zemërbutësi, që më pëlqen. Shumica e tyre po integrohen fort mirë. Ata janë të motivuar, plot zell në punë dhe kanë dëshirë të ndërtojnë një jetë tjetër. Si gjithmonë, mjaftojnë një dy budallenj, që bëhen shkak për kryetituj, ashtu që ekstremistët i marrin këto raste. Por, personalisht kam pasur vetëm marrëdhënie të mira, miqësore, të përzemërta dhe të pandërlikuara.

Vitet 1990 karakterizoheshin para së gjithash nga mosbesimi ndaj kosovarëve, nga ardhja e azilkërkuesve të panumërt, nga rastet e delikuençës, paragjykimet e forta...

Po, vërtet ndodhi delikuenca, por që është marginale. Unë s'e kam përkrahur kurrë këtë stigmatizim, sepse isha prekur vetë në fëmijëri nga kjo. E di se si ishte kjo në vitet 1960 për italianët, pastaj për spanjollët, portugezët, turqit... Nuk duhet përgjithësuar mbi bazën e disa detajeve.

Megjithatë, ju në «Téléjournal» duhej të raportoni për këto ngjarje... a përbënte kjo për ju një dilemë etike?

Po. E pranoj. Nuk ishte fjala vetëm që konfrontohesh me njerëz, të cilët a priori kishin një qëndrim negativ. Duhej t'i thosha vetes: «Ti ke a priori një qëndrim pozitiv, por, megjithatë, ka një ngjarje aktuale që është e pakëndshme; emocioni duhet lënë mënjanë dhe duhet munduar që faktet të shihen objektivisht.» Duhej bërë, po pa shtuar ndonjë gjë. Në transmetimin e informacionit, përmes intonacionit, në përpilimin e tekstit gjithmonë mund të futet një shije e vogël ksenofobie, apo njëfarë mirëkuptimi. Këtu duhej të kisha pak kujdes. Unë kisha pikërisht prirjen t'u kundërvihesha atyre të cilët ata i shihnin si të paintegrueshëm – dhe besoj që fundja realiteti më ka dhënë të drejtë.

A ka pasur ndonjëherë tension në ekipin e «Téléjournal»-it në lidhje me këtë temë?

Natyrisht. Një redaksi është një shëmbëlltyrë e opinionit publik, kishte kolegë që thoshin «Prapë këta, ngadalë, u mbush kupa, ata dihen...» Unë mundohesha t'i luftoja klishetë, edhe duke e ditur që disa persona nuk po integrohen dhe krijojnë probleme. Integrimi i të huajt është një detyrë dhe përpjekje reciproke. Paragjykimet duhen luftuar jo vetëm në rrethin profesional, por edhe në jetën e përditshme personale, apo në edukimin e fëmijëve. Ne të gjithë jemi të huaj, është vetëm një çështje e perspektivës.

Ka mendime, të cilat i akuzojnë mediet publike audiovizuale se kanë një prirje zbulimi, apo se e abstraktojnë ose e minimizojnë realitetin. A keni marrë shpesh këso reagimesh?

Po, sigurisht, më kujtohen letra shumë të ashpra, në të cilat akuzoheshim se jemi të majtë, se e tradhetojmë Zvicrën... Por këta tituj nuk e reflektonin realitetin. Ndjesia që zgjonin ato u përforcua dhe shfrytëzua politikisht. Por, nuk duhet të ketë të drejtë ai që bërtet më fort. Çdo integrim në fillim ka disa vështirësi dhe duhen më shumë gjenerata për t'ua dalë me to! Në vitet 1960 italianët qëndronin shumë në mes vete. Kosovarët e kanë bërë të njëjtën, edhe komunitete të tjera në të ardhmen do të mbahen kështu.

Nuk jam dakord që të huajt të stigmatizohen, kushdo që të jenë ata. Dhe e pranoj që i kam shfrytëzuar paksa funksionet e ndryshme që kam pasur në televizion për t'i luftuar paragjykimet. Edhe pse shkollimin e kam ndjekur këtu dhe kam pasaportë zvicerane, veten e shoh edhe si të huaj. Mund të dilja

edhe ndryshe, por unë jam më parë ksenofil se ksenofob, dhe i qëndroj kësaj. Tjetri është një pasurim, jo armik.

A mendoni se mediet zvicerane i kanë stigmatizuar shqiptarët?

Po, nganjëherë. Mendoj që një shfrytëzim i pacipë i kryetitujve negativë i shkakton shumë shpejt dëm një komuniteti të tërë. Kanaleve të informimit që i kemi në dispozicion duhet t'u qasemi në mënyrë kritike.

Sipas mendimit tuaj, a duhet përmendur kombësia e një delikuentit në transmetimin e informacionit?

Po, nga momenti që fillon të formësohet një prirje për këtë fenomen, për shembull, në komunikatat e policisë, mund të shtrohet pyetja. Përndryshe jo. Një vrasës është një vrasës, një trafikant një trafikant, pavarësisht nga pasaporta. Nëse statistikën e lejojnë të nxjerrësh përfundime, kjo duket ndryshe, por unë nuk jam i bindur që në rastin e dhënë është shfaqur ndonjëherë një prirje e qartë. Është e lehtë që këtë ta bësh të besueshme. Mjafton që në të njëjtin muaj fjalën «kosovar» ta sjellësh tri, katër, persë herë në kryetituj. Kjo ndodh pa dyshim pa qëllim ksenofobik, por, megjithatë, mund çojë në një mendim të keq publik.

A është për ju prania e disa lojtarëve me prejardhje shqiptare në Kombëtaren e zvicerane të futbollit një sinjal i integritetit të mirë?

Po, kjo e ilustron atë që e kam besuar gjithmonë. Edhe pse dëgjon dhe lexon që ky ekip qenkësh «stërballkanizuar», edhe pse bëhet fjalë për zviceranë, disa me shtetësi të dyfishtë, por zviceranë. Ta thuash këtë, sikurse po e bën njëfarë shtypi bulevardesk, është e rrezikshme. Këta lojtarë janë zviceranë dhe rrënjët i kanë tjetërkund. Nganjëherë ka tensione me lojtarët e tjerë, por ç'rëndësi ka? A nuk ka tensione shekullore ndërmjet romandinasve dhe zvicerano-gjermanëve? Ndërmjet gjenevasve dhe valisasve? Që ky ekip zviceran shfaq identitete të ndryshme, është i larmishëm me një «ngjyrim ballkanik», që nuk është më ai që ka qenë njëherë para 20 a 30 vjetëve, është një pasurim. Bota ndryshon, ky vend ndryshon dhe këta njerëz kanë talent në fushën e tyre.

Ajo që më bie në sy është se po shpërfilllet larmia dhe po theksohen vetëm dallimet. Por, cilës normë i referohet këtui? Me këtë dua të them: «Po, por ata nganjëherë sillen dhe hiqen ndryshe...» E pastaj? Ata ndoshta nuk janë zviceranë shembullorë, por ky identitet i larmë lëviz nën flamurin zviceran.

Ky është një reflektim i Zvicrës së sotme. Edhe Wawrinka nuk ka emër zviceran, por familja e tij është integruar para shumë kohësh, dhe sot ai shihet si zviceran perfekt. Prindërit e lojtarëve shqiptarë, në përgjithësi, janë nga gjenerata e parë, por gjenerata e dytë është e integruar më mirë dhe e treta do të jetë shkëlqyeshëm! Kjo duhet mbajtur parasysh. Të mendosh se ka norma të rrepta që duhen plotësuar për të qenë zviceran është shumë konservatore dhe reaksionare. Një identitet është gjithnjë në lëvizje. Një vend zhvillohet vazhdimisht.

A kanë kontribuar këta futbollistë shumë në përmirësimin e imazhit të komunitetit të tyre?

Kjo është e pakontestueshme. Edhe nëse disa mërzhiten me faktin se ata ndoshta janë të vrullshëm, gjaknxehtë dhe vendosen ndryshe në skenë, kjo kontribuon në integrim. Sporti e ofron këtë veçanti, për këtë paguhet personalisht një çmim i lartë. Nëse Xherdan Shaqiri jep një duel të mirë, apo të keq, këtë e sheh. Ai i është dorëzuar shikimit të njerëzve. Shaqiri, Xhaka, Behrami kanë një talent të vërtetë, të dukshëm dhe të ndjeshëm. T'i shohësh këta me fanellën e Zvicrës, kontribuon indirekt në integrim. Dhe, shqiptarët e vegjël në Zvicër i shohin idhujt e tyre duke luajtur me këto fanella. Për mua, sporti është faktori më i dukshëm i integritimit.

Si e perceptoni qëndrimin e shtypit sportiv zviceran në lidhje me shqiptarët?

Prania e fuqishme e lojtarëve me prejardhje të huaj mund të nxisë irritime tek ata të cilët e injorojnë faktin se një identitet dhe një kulturë janë në lëvizje. Unë shoh edhe vështirësi për ta akceptuar këtë. Por, gazetarët e rinj e zotërojnë këtë më mirë se kolegët e tyre të vjetër, të cilët mund të kenë një përfytyrim të përcaktuar më rreptë të identitetit zviceran. Por, unë konstatoj se ata po kualifikohen thjesht si «zviceranë», kur flitet për ta. Shkruhet «zvicerani Xherdan Shaqiri», mu si «zvicerani Breel Embolo». Mendoj se sporti, në këtë rast, i paraprin shoqërisë. Lëvizjet e thella të shoqërisë bëhen më të ngadalshme në koka nga ç'po akceptohen në terren.

A e ndani, pra, mendimin se imazhi i shqiptarëve në Zvicër është në rrugë të mbarë për t'u përmirësuar?

Patjetër. Dhe mendoj se është përmirësuar para së gjithash për një arsye që nuk duhet harruar: Integrimi do kohë, është një proces i ngadaltë pjekurie.

Vendësit i nënvlerësojnë përpjekjet që nënkupton çfarë do të thotë ajo të vish në një vend tjetër dhe të vendosesh aty. Më kujtohet që kjo ka qenë kështu edhe për prindërit e mi. Nënvlërësohet rëndësia e çrrënjësjes, e përçarjes së brendshme dhe e përpjekjes për t'u integruar në kulturën e vendit nikoqir. Atyre u duhet dhënë kohë, dhe t'u ndihmohet që të integrohen. Shkollat publike, sikurse edhe sporti, luajnë një rol fundamental.

Të gjithë mund të integrohen, për këtë jam i bindur thellë. Dhe varet nga vullneti i atij që ka për t'u integruar, por edhe nga ai i atij që po integron. Sa më shumë kohë që po kalon, aq më tepër besoj se postulati im po vërtetohet. Personalisht jam i bindur për këtë si me zemër, ashtu edhe me mendje.

A është punë e medieve që ta promovojnë integrimin?

Po, duke i trajtuar ata krejt normalisht dhe duke mos i hidhëruar me koncepte që i vendosin në një qoshe. Në këtë plan duhet të përpiqemi akoma.

Roland Wiprächtiger

NJË IMAZH I PËRHAPUR KRYESISHT NGA SHTYPI I VERDHË

Roland Wiprächtiger deri më 2015 ka punuar si gjykatës në Kantonin e Lucernës. Ai është njohës i shqiptarëve.

Zoti Wiprächtiger, si do ta përshkruanit ju imazhin e shqiptarëve në Zvicër?

Imazhi i shqiptarëve në Zvicër ishte i keq, është përmirësuar shumë dhe më së voni, në dhjetë vjet, problemet me shqiptarët – ashtu sikur ata janë paraqitur shpesh në shtyp – do të kenë kaluar.

Me ç'fjalë mund të shprehet ky imazh i keq?

Në Zvicër ka një traditë të veçantë: Të huajt që vijnë te ne, sidomos punëtorët, të cilët nuk e njohin Zvicrën, shpeshherë bëhen fajtorë për shumë situata negative. Kjo ka qenë kështu me italianët, me tamilët, me njerëzit nga Ballkani, pra edhe me shqiptarët. Ata nuk mund dhe nuk donin të dallonin.

Për çfarë kanë rënë në sy konkretisht shqiptarët, nganjëherë flitet për shpërdorim të rrjetit social, nganjëherë për dhunues...?

Këtë imazh e ka transmetuar para së gjithash shtypi i verdhë. Sipas tij, shqiptarët janë të prirur për dhunë, i japin veturës me tërbim dhe e keqpërdorin sistemin social; pra, paragjykime tipike.

Tani mendoni se situata është më e mirë. Po si shpjegohet ky imazh, si u ngrit ai?

Janë përzgjedhur raste të veçanta, si puna e një shoferi të tërbuar, që e ka shkaktuar një aksident me pasojë vdekjen. Kjo sjellje e gabuar është përgjithësuar dhe i është veshur gjithë kësaj popullate. Kjo ka ndodhur kështu edhe me shqiptarët. Ndërkohë kanë ndodhur disa gjëra: Stinorët e parë shqiptarë, në fillim mendonin se do të ktheheshin shumë shpejt. Kur, megjithatë, i sollën familjet e tyre në Zvicër, nuk i dhanë shumë rëndësi shkollimit të fëmijëve të tyre. Ndërkohë kjo ka ndryshuar. Sot një pjesë e madhe e shqiptarëve dhe e shqiptareve kanë shkollim të mirë. Ata në shumë raste ushtrojnë profesione të lakmuara, prandaj sot edhe mund të thuhet se

shqiptaret dhe shqiptarët në Zvicër ia kanë dalë. Dhe, kjo vjen duke u rritur. Unë konstatoj që shkollimit po i kushtohet gjithnjë e më shumë rëndësi. Sipas gjykimit tim, kjo është A-ja dhe O-ja e integritit shoqëror.

Ju mendeni se imazhi i keq është ngritur nga përgjithësimi i rasteve të veçanta...

Pa asnjë dyshim.

Po ku qëndron interesi i një opinionit publik që të përhapë këso përshtypjesh?

Nëpërmjet kësaj, për shembull, shkaqet e mungesës së aksesit në një shoqëri mund t'ua vësh «kokave të turkut». Ta shohësh nga këndvështrimi shoqëror, aktualisht në Zvicër po ndodh kjo: Christoph Blocher dhe partia e tij e synojnë pushtetin social dhe politik për një elitë nacional-konservatore. Gjithnjë e më shumë pasuri dhe ndikim po shkon në këto qarqe, ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë po bëhet humbëse dhe po varfërohet shumë. Nëpërmjet ndërgjegjësimit të të huajve dhe, së fundmi, edhe refugjatëve për këto shtrembërime në shoqëri, shkaktarët e vërtetë për shumëkënd ngelin të fshehtë. Kjo funksionon gjithnjë.

Si ka sukses ky përgjithësim, cilët mekanizma kontribuojnë që të induktohet nga rastet e veçanta në komunitete?

Unë nuk jam as sociolog, as historian. Unë e di vetëm që këto procese, sikur sapo i tregova, po ndodhin gjithandej në Evropën Perëndimore, gjë që mund të konstatohet lehtë.

Cilat janë përvojat tuaja personale me shqiptarët në Zvicër, si i keni perceptuar ju personalisht ata?

Unë jam trajtuar me shumë respekt nga shqiptarët. Këtë e kam përjetuar gjithmonë kur kam qenë me ta. Ata nuk janë ngutur kurrë të gjykojnë për mua, por përherë ma kanë dhënë rastin të artikulohem dhe të paraqitem. Vetëm atëherë është krijuar një bindje për mua. Kjo më ka imponuar jashtëzakonisht. Për mua, që shqiptarët i njoh prej gati dyzet vjetësh, kjo veti është një karakteristikë e veçantë e këtij populli. Ata janë edhe fort mikpritës, çka më zë përherë ngushtë, kur e kujtoj kulturën tonë.

Po në jetën tuaj profesionale si gjykatës në Lucernë, a kishit edhe aty rast të njihnit shqiptarë...?

Po, madje në dy mënyra. Nga njëra anë, më duhej të gjykoja shumë raste nga fusha e bashkimit familjar. Në anën tjetër, në shumë raste flitej për një dëbim nga Zvicra.

Cila prej këtyre e kishte primatin në karrierën tuaj?

Më shumë rastet e dëbimit – te këto nganjëherë ndodhte që instancat paraprake kishin hetuar njëanshmërisht. Atëherë detyra e gjyqit ishte që të krijonte një pamje të plotë të dikujt, përmes masave plotësuese dëshmuese. Në gati 20 vjet, nga 20 deri 30 dëbime në vit, kishte vetëm katër ose pesë raste, në të cilat nuk ka pasur sukses miratimi i ankimit në këtë kuptim, sepse të prekurit kanë kryer përsëri vepra penale.

E kam pyetur veten vazhdimisht, se ku qëndron dallimi më i madh ndërmjet zviceranëve dhe shqiptarëve. Dhe, përgjigjen nuk e di akoma. Po dëshiroj të identifikoj diçka. Që nga marshimi i Napoleonit, zviceranët praktikisht nuk njohin më konflikte të armatosura. Kundrejt kësaj, populli shqiptar në 200 vjetët e fundit përjeton vetëm sulme, dëbime me shumë viktima, dhunime etj. Kjo e ka shënjuar shpirtin e këtij populli dhe ka bërë që gjaku i një shqiptari të jetë diçka më i nxehtë se ai i një zvicerani. Këtu paqe, atje shtypje. Ky për mua është një dallim markant në zhvillimin e këtyre dy popujve.

A ka qenë imazhi i shqiptarëve shpesh temë në përditshmërinë tuaj – qoftë profesionalisht qoftë privatisht?

Ta njohësh këtë popull, për mua ka qenë një pasurim i madh. Kështu që shqiptarët tek unë nuk kanë pasur kurrë imazh të keq. Meqë ra fjala, unë shqiptarët i kam njohur përmes muzikës së tyre. Të ashtuquajturin imazh të keq të shqiptarëve e kam njohur vetëm përmes shtypit.

Po ku qëndron, sipas mendimit tuaj, në mënyrë specifike, interesi i shtypit që të përgjithësojë raste të caktuara?

Ata duan ta shesin një produkt. Kapitalizimi i këtyre temave në një gjuhë të thjeshtë dhe pllakative mund ta rrisë tirazhin.

A ju bie diçka në sy kohët e fundit në raportimin për shqiptarët?

Për shqiptarët po raportohet pothuajse vetëm pozitivisht. Më parë ishin, para

së gjithash, futbollistët, të cilët bënë imazh të mirë në shtyp. Sot nganjëherë lexojmë edhe që shqiptarët shkëlqejnë në profesione, apo angazhohen si parlamentare dhe parlamentarë. Por, tendenca është në drejtimin që për shqiptarët nuk po raportohet fare. Nuk duhet theksuar më pozitiven, për ta relativizuar negativen. Shqiptarët ia kanë dalë. Ata përfundimisht janë bërë një pjesë e Zvicrës.

A reflekton kjo përshtypje pozitive edhe në rrethin tuaj?

Zviceranët shprehen vetëm për të huajt, kur nuk kanë imazh të mirë. Kur kjo nuk është më kështu, atëherë është gjithçka në rregull. Në rrethin tim nuk po dëgjoj më vërejtje kritike për shqiptarët.

Kujt i përshkruhet konkretisht ky imazhi i mirë i shqiptarëve?

Shqiptarët në Zvicër janë integruar. Këtu ka kontribuar sidomos një institucion në Zvicër. Kjo është shkolla publike. Për këtë jam bindur vetë personalisht për vite me radhë. Bashkëjetesa e fëmijëve ka funksionuar shumë mirë, për më tepër edhe aty ku shkalla e fëmijëve të huaj është e lartë.

Në fillim u shprehët se imazhi ishte i keq, tani është shumë më mirë. Kjo domethënë që ky kapitull nuk është mbyllur. Çfarë duhet të bëhet për ta avancuar më tej këtë çështje?

Para rreth tre vjetësh kam menduar se për rreth 15 vjet integrimi i shqiptarëve në Zvicër do të ishte punë e kryer. Sot jam i bindur që kjo do të ndodhë shumë më herët. Sepse sot shumica e prindërve shqiptarë e dinë se sa me rëndësi është një shkollim i mirë për fëmijët e tyre. Ata janë të gatshëm të angazhohen fuqishëm edhe financiarisht për këtë.

Sophie Malka

NA MUNGON KURESHTJA

Sophie Malka është gazetare dhe që nga viti 2008 koordinatore e shoqatës «Vivre ensemble» në Gjenevë, një platformë informative për azilin politik në Zvicër, e cila boton një revistë.

Çfarë përvojash keni me komunitetin shqiptar në Zvicër?

Në kohën e krizës në Kosovë, isha gazetare te «le Courrier». Së këndejmi, kisha disa kontakte me Universitetin Popullor Shqiptar në Gjenevë dhe mund ta vështroja pamjen që jepnin mediet nga mbërritja e kosovarëve. Kishte paragjykime, sepse atëbotë kjo popullatë, e shfaqur befasisht në Zvicër, nuk njihej. U ashpërsua ligji për azilin dhe kjo temë u shfrytëzua politikisht, çka shkoi në hap me rritjen e rëndësisë së Partisë Popullore të Zvicrës (SVP). Kjo parti me vite i shfrytëzoi azilkërkuesit dhe në veçanti shqiptarët si «kokë turku».

Në «le Courrier», ku isha kompetente për çështjet e azilit dhe të migracionit, mundoheshim ta analizonim gjithë këtë. Përmendja e shpeshtë e kosovarëve a shqiptarëve në kryetitujt e medieeve të caktuara, dhe kjo para së gjithash në kontekst të kriminalitetit, krijoi një imazh fort negativ për një komunitet pak të njohur për zviceranët. Një pjesë e kësaj shoqërie ishte që nga vitet 1960 në Zvicër, me «importin» e stinorëve nga ish-Jugosllavia, por këta njerëz pothuajse nuk dukeshin. Vetëm atëherë kur gjatë luftës i tërhoqën familjet e tyre, u shtrua çështja e integritit.

A nuk do të ishte më mirë sikur të ishte heshtur lidhur me rastet e delikuencës dhe kriminalitetit, në të cilat ishin të përfshirë shqiptarë?

Jo. Këto raste ishin realitet. Ato pjesërisht kishin të bënin me luftërat e Jugosllavisë. Ndodhën rivalitete ndërmjet klaneve në Zvicër, shembuj të këtillë mund të shiheshin në Universitetin Popullor Shqiptar në Gjenevë. Por, problemi është se mediet, në përgjithësi, flasin vetëm për atë që nuk funksionon. Ato i shquajnë këto raste, edhe pse ato thonë pak për atë se çfarë funksionon mirë. Ato raportojnë rrallë për kulturën e migrantëve, për sukseset e integritit të tyre, ato u japin një rëndësi joproporcionale detajeve, të cilat më shumë janë fenomene shoqëruese.

Sipas kësaj, a po e kryejnë ato punën e tyre keq?

Nuk do të shkoja kaq larg. Por, duhet të kenë kujdes. Për shembull, shtrohet pyetja nëse në kryetituj duhet përmendur nacionaliteti a prejardhja e personave, apo jo. Kjo shtrohet sot për debat, sikur edhe para pesëmbëdhjetë vjetëve. Po orientohet nga nacionaliteti, edhe pse në kriminalistikë, para së gjithash, relevantë janë faktorët socioekonomikë; këtë e ka bërë të qartë një studim i André Kuhn. Përveç kësaj, pak vëmendje u është kushtuar faktorëve që e shpjegojnë këtë delikuençë, si regjimit të vizave për pjesëtarët e Ballkanit, që dëshirojnë të vijnë në Zvicër. Kjo i detyronte ata t'u drejtoheshin transportuesve, të cilët nganjëherë ishin edhe trafikantë armësh apo drogash.

Imazhi i kosovarëve në vitet 1990 ishte i keq, kjo del nga një studim i Forumit Zviceran për Migracion; a e keni ndjenjën që ky është përmirësuar?

Ditën e sotme është më pak negativ, para së gjithash sepse nuk flitet kaq shpesh për ta. Por, edhe falë simboleve të integritetit. Kur Xherdan Shaqiri në Kampionatin Botëror të Futbollit shënoi tri gola kundër Hondurasit, erdhi kjo deklaratë e habitshme e një komentatori të «Téléjournal»-it të Radio Télévision Suisse: «Një burri të vetëm, një zvicerani tjetër, vetëm një heroi tjetër i ka ecur deri më tani të gjuajë kështu. Ky ishte Wilhelm Tell». Kjo dëshmonte për atë se sa u adoptuan nga Zvicra disa lojtarë ish-jugosllavë. Shqiptarët tani bëjnë pjesë në botën tonë. Ata kanë themeluar ndërmarrje ndërtimi, emrat e të cilave e sinjalizojnë prejardhjen e tyre, dhe kjo nuk habit më. Ata janë integruar në peizazh sikur atëbotë italianët.

A nuk dëgjoni më paragjykime ndaj shqiptarëve?

Që kur «Vivre ensemble», para tre vjetësh, e ka lancuar numëruesin e medieve, nuk kemi konstatuar më paragjykime në shtyp, të cilat i prekin në mënyrë specifike kosovarët a shqiptarët, si grup. Paragjykime lidhur me përkrahjen, apo në kontekst të kriminalitetit të refugjatët, kjo po. Ka vërtet një korrelacion të dukshëm ndërmjet debateve për nacionalitetet dhe hises së tyre në statistikat e azilit. Kjo lidhet me atë se si ata përdoren politikisht. Viteve të fundit janë eritreasit dhe afganët. Synohet që ata të diskualifikohen në opinionin publik dhe të legjitimohet vënia në pikëpyetje e pranisë së tyre këtu. Shqiptarët, përkundrazi, tani janë në shkollat tona. Unë banoj në lagjen Pâquis në Gjenevë, klasat e fëmijëve të mi përbëhen nga të gjitha nacionalitetet, dhe shoqëritë në mes të fëmijëve i favorizojnë kontaktet ndërmjet prindërve të tyre.

I përmendët manipulimet politike. A luajnë këto për ju një rol vendimtar në formimin e opinionit publik në Zvicër?

Po. Nëse një parti e shfrytëzon frikën nga tjetri për qëllime zgjedhore, i vë syrin pakënaqësisë dhe ndjenjës së sigurisë dhe nëse këto diskurse adoptohen nga parti të tjera dhe me këtë i përmbysin mediet e hapësirën publike, kjo shpie në një ndikim të opinionit publik.

A besoni se pa SVP-në nuk do të kishte paragjykitime?

Po, pa dyshim. Unë mendoj se kundrejt tjetrit ka a priori paragjykitime. Në etiketën azilkërkues shpesh qëndron një shprehje e dyshimit, çështja është se a është prania e saj në Zvicër e justifikuar. Roli i politikanëve të përgjegjshëm do të ishte ta qetësojnë opinionin publik dhe të tregojnë se jemi në gjendje t'i integrojmë të ardhurit rishtazi, sikurse e kemi bërë në të kaluarën edhe me të tjerët. Nuk është fjala për t'i përgënjeshtruar frikërat e një pjese të zviceranëve, madje është e nevojshme që atyre t'u jepet mundësia për t'u shprehur. Por, është roli i përfaqësuesve të popullit, i atyre personave të cilët pretendojnë ta qeverisin vendin dhe të cilët duhet të kujdesen për kohezionin social, të tregojnë se kanë një përgjigje për këto frikëra. Të na tregojnë neve se mund të kemi besim në vete si shoqëri.

A e influencojnë, pra, diskursat politike opinionin publik më shumë se mediet?

Unë mendoj se mediet luajnë një rol përforcues. Nëse gazetatat me tirazh të madh për arsye shitjeje, njëra pas tjetrës, publikojnë kryetituj alarmues, të cilët i prekin azilkërkuesit, apo persona të njëfarë prejardhje, kjo sigurisht ka për pasojë një imazh negativ të këtyre personave. Gazetat, që punën e tyre e bëjnë mirë, mund ta vënë në pikëpyetje këtë diskurs politik që synon frikën. Mjerisht, temat e hulumtuara, përkundrejt aktualiteteve, e humbasin shpejt prioritetin. Shtypi duhet të reagojë shpesh dhe mjaftohet me adaptimin e komunikatave të policisë, të cilat e përmbajnë kombësinë, apo prejardhjen e autorit, pa e vënë në dyshim relevancën e kësaj përmendjeje. Ajo këtë e bën madje edhe atëherë, kur nuk flitet patjetër për një element vendimtar informacioni.

A është kjo arsyeja përse zviceranët i njohin keq shqiptarët, të cilët, megjithatë, janë komuniteti i dytë i huaj në këtë vend?

Është e vërtetë që ata njihen keq, por kjo vlen edhe për shumë kombësi

të tjera. Unë mendoj se, për shembull, portugezët e kanë pasur të njëjtin hendikep. Ne i njohim të gjithë punëtorët portugezë të fabrikës apo pastrueset, por vendin e tyre e njohim keq. Kultura e tyre rrezatonte në gjithë botën, por kjo në Zvicër është pak e dukshme. Nëse do të shkonit për pushime në Portugali, do ta njihnit pasurinë e kësaj kulture, dhe paragjykimet tuaja do të shkriheshin. Do të vetëdijesoheshit që shkaku i paragjyimeve tuaja ishte kureshtja e munguar. Për sa u përket shqiptarëve, e kemi edhe ne që të interesohemi për kulturën e tyre.

Uli Windisch

NUK MUND TË THUHET QË GJITHÇKA PO SHKON MIRË

Uli Windisch është profesor i sociologjisë, autor i rreth pesëmbëdhjetë veprave, ndër të tjera për temën e integritit. Ai është kryeredaktor i platformës së internetit lesobservateurs.ch. Në fillim të viteve 2000 ai ishte në kryesinë e Universitetit Popullor Shqiptar në Gjenevë (UPA).

Cilat janë përvojat tua me komunitetin shqiptar?

Unë fillova në vitet 1960, shumë vjet para se kosovarët të qëndronin në qendër të vëmendjes, të interesohem për çështjet e imigracionit. Komunitetin nuk e njoh shumë mirë, por studentë shqiptarë në Universitetin e Gjenevës, ku unë ligjëroj, më kanë ftuar të hyj në kryesinë e UPA-s. Ata donin që me këtë të përfshihesha në luftën kundër paraqitjes negative të kosovarëve në popullatën zvicerane. U zgjodha shpejt në kryesi, por nuk qëndrova gjatë, sepse institucioni m'u duk shumë i politizuar.

Çka është efekti i një «paraqitjeje negative»?

Si sociolog, jam i mendimit se paraqitja shoqërore shpesh luan një rol të rëndësishëm në influencimin e qëndrimit kolektiv. Dukja e një problemi ka së paku kaq shumë realitet sa edhe vetë problemi. Megjithatë, imazhi negativ i kosovarëve është pjesërisht i arsyetuar, megjithëse edhe në këtë komunitet ka njerëz të jashtëzakonshëm, të cilët duhet të çmohen aq më shumë.

Si përmirësohet një imazh?

Kjo është një çështje e integritit. Unë jam angazhuar gjithmonë për atë që migrantëve t'u jepen të drejta politike, sepse përmes pjesëmarrjes integroresh në shoqëri. Kjo shihet kur klasat e nxënësve në shkolla profesionale organizojnë debate për një votim, nuk ka diçka më integruese sesa kjo! Dhe, kur në fund të ushtrimit klasa voton, asnjërit nuk do t'i shkonte në mendje që t'i largojë nxënësit e huaj. Jam i bindur se zviceranët janë shumë integruar, por vetëm nëse komunitetet e huaja i akceptojnë vlerat tona themelore. Kjo është, mjerisht, pikërisht ajo që është duke ndryshuar, sikurse, për shembull, me thirrjet e Tariq Ramadanit, i cili i thërret myslimanët që të «ngelin vetvetja». Kjo është një situatë e re, po kalohet në një opozitë frontale, e cila është e papranueshme.

A e keni përshtypjen se imazhi i shqiptarëve ka ndryshuar që nga vitet 1990?

Mendoj se ajo mjegullnaja shqiptare, e cila vjen nga disa vende, nuk është definuar qartë në kokat e njerëzve. Koncepti «kosovar» ka sigurisht një konotacion negativ për shkak të ekzistencës së grupeve kriminale, si dhe problemeve në lidhje me sjelljen e të rinjve me prejardhje kosovare, për të cilët shtypi raporton vazhdimisht. Aktualisht, shqiptarët nuk shihen si imigrantët më problematikë, shumë më tepër po preokupohet për migrantët nga Lindja e Afërt, ndër të cilët ka terroristë. Kjo frikë nuk ndahet për shqiptarët. Por, kur u perceptua se Kosova, pavarësia e së cilës u përkrah nga Zvicra, u qeveriska nga njerëz me sfond kriminal, kjo sigurisht ka kontribuar në paraqitjen negative të shtetasve të saj. Patjetër që ka kosovarë shembullorë, por nuk duhen mohuar problemet, të cilat të tjerët ia shkaktojnë vendit nikoqir.

Frika se shqiptarët nuk do të mund të integrohen mirë, shprehej në vitet 1990; sot shihet që ata udhëheqin biznese, themelojnë ndërmarrje, kanë funksione akademike...

Ky është një proces normal. Dhe, sa më shumë që ata integrohen, sa më shumë që disa prej tyre madje mund të bëhen pikë referimi, aq më shumë do të ndryshojë opinioni publik për ta. Por, ekzistojnë akoma ato bandat e të rinjve, ato rrahjet në shkolla. Nuk e di nëse ky fenomen është duke rënë, por po shoh akoma rregullisht këso lajmesh dhe për këtë arsye kosovarët në perceptimin e popullatës vazhdojnë të paraqesin një problem. Dëshirohet që këto fakte të minimizohen, unë jam për atë që të thuhet se çka është puna. Por, unë dua që mediet t'i vendosin në skenë edhe ata ndërmarrës shqiptarë, të cilët kanë një sukses shembullor. Unë përkrah të gjithë ata që ndërmarrin përpjekje për t'u integruar, sidomos përmes punës, kjo është kaq e rëndësishme në Zvicër.

A e ndani pra mendimin që ky integrim po përparon?

Unë mendoj se nuk duhet përgjithësuar dhe aq më pak të thuhet se gjithçka po shkon mirë dhe shqiptarët do të integrohen. Mua më duket se kjo është më e vështirë nga ç' ishte për italianët, spanjollët a portugezët. Imigrimi në Zvicër karakterizohet nga dallime kulturore gjithnjë në rritje, që shpie në një inkompatibilitet, nëse feja e pamundëson integrimin. Dihet që myslimanët nga vendet ish-komuniste, sikurse është rasti me kosovarët, janë ndryshe nga ata që vijnë nga vende me një kulturë më të fortë fetare. Përparësia e

shqiptarëve ndoshta qëndron aty që besimi tek ata nuk është vendimtar. Por, kush e di se të rinjtë shqiptarë, nga nevoja e identitetit, nuk do të ndienin të arsyeshme të futen në struktura fetare, të cilat janë armiqësore ndaj integritetit në Zvicër...

Përse në sytë tuaj është kaq e rëndësishme që të flitet për probleme të integritetit?

Nëse nuk flisni për këtë, sepse dëshironi ta pamundësoni një rritje të paraqitjeve negative, me këtë e arrini efektin e kundërt. Duhet folur për probleme, si dhe përvoja pozitive. Policia duhet t'i ofrojë të dhënat, pa e hequr prejardhjen e delikuentëve. Dhe, nëse shikohet që kosovarët e rinj bëjnë probleme specifike, duhet të mund t'i thuhet komunitetit që t'i fusë ata përsëri nën kontroll. Kjo do të ishte pozitive për gjithë shoqërinë.

Alain Maillard

NJË IMAZH NË REHABILITIM

Më 2 shkurt 2015 magazina e Migros-it botoi një artikull me titullin karakteristik: «Këta kosovarë i pluhurizojnë klisjetë». Kjo revistë javore falas prezanton portrete të disa të rinjve dhe familjeve në Zvicër. Hyrja paralajmëron, sikurse kjo të ishte e habitshme, që «shqiptarët e gjeneratës së dytë çojnë një jetë normale. Ata shpesh janë të natyralizuar, studiojnë, themelojnë ndërmarrje, bëjnë fëmijë, kanë karriera premtuese. E tërë kjo e mbështetur në strukturat solide tradicionale familjare. Në mënyrë paradoksale, me këtë ndodh një afrim te modeli i qytetarit ideal, çfarë po propagandohet nga qarqet armiqësore ndaj imigracionit.»

Ky artikull është larg të qenit i vetmi i kësaj gjinie. Prej disa vjetësh shtypi zviceran boton artikuj pozitivë për shqiptarët në Zvicër, para së gjithash shtypi gjermanofon. Kujtim Shabani citon disa shembuj. Ndodh kjo sepse duhet kompensuar diçka, duke qenë se më parë problemet të cilat mund t'i bënin kosovarët, apo «shqiptarët e Kosovës» u shquan kaq shpesh?

Titulli i magazinës së Migros-it: «Këta kosovarë i pluhurizojnë klisjetë» është prandaj kaq karakteristik, sepse ai e qartëson forcën e këtyre klisheve të përhapura nga mediet. Nuk mjafton t'i përgënjeshtrosh ato, por duhet të «pluhurizohen». Nëse ky titull është i domosdoshëm për ta tërhequr vëmendjen e lexuesve, kjo zbulon se supozohet që këto klishe janë rrënjësor thellë.

Sikurse vënë në pah shumë bashkëbisedues në këtë libër, mekanizmi i paragjytimeve e ka shoqëruar gjithë historinë e imigracionit në Zvicër. Stinorët italianë, apo italianë me vizë B, kanë vuajtur deri në vitet 1970 nga kjo. Tamilët dhe turqit e viteve 1980 akuzoheshin se e keqpërdornin procedurën e azilit dhe në këtë kohë filluan të përdorshin koncepte të konotuara negativisht, si «vërshim» apo «refugjatë të remë».

Ajo çka e karakterizonte imigracionin shqiptar të viteve 1990, i cili vërtet nuk ishte i ri, por i padukshëm, ishte një përkim jashtëzakonisht intensiv i shkaktarëve të paragjytimeve. Studimi i Entit Federal të Migracionit (Burri et al., 2010) kujton sidomos atë që imazhi dezastroz i kosovarëve u shënjua përmes një akumulimi të etiketave: kriminelë, trafikantë, paraqitje të dhunshme, shoferë të tërbuar. Sikurse ia qëllon profesor Etienne Piguet, u krijua «një paraqitje ideale për shpjegime të thjeshta: shqiptar-klane-mafie-trafik droge, që funksionoi». Për përgjithësimin «mjafton një raport për një

rast në «Blick». (...) Njerëzit i duan klishetë».

Është karakteristike për paragjykimet që rrethanat të cilat i krijuan, mbijetojnë. Gjithmonë duhet shumë më tepër kohë për t'i eliminuar ato, sesa për t'i krijuar. Sa do të zgjaste në këto rrethana, madje pa kryetituj të papërshtatshëm, derisa të mund të çlirohej imazhi i kosovarëve dhe shqiptarëve të tjerë në Zvicër? Tri gjenerata, katër?

BEFASI POZITIVE

Mund të druash aq më tepër që integrimi i këtij komuniteti është më i vështirë krahasuar me atë «latin» (italianë, spanjollë, portugezë), duke qenë se shqiptarët shfaqin të meta shtesë: një gjuhë dhe kulturë misterioze, vende pak të njohura të prejardhjes, sepse Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria nuk janë – ose ndoshta jo deri më tani – destinacione turistike. Me këtë mungon një mjet për luftimin e paragjykimeve negative.

Në këtë kontekst, sot nuk na befason që më në fund imazhi po përmirësohet, por shumë më tepër shpejtësia me të cilën, pavarësisht nga të gjitha, po evoluon. Një shpejtësi e cila është e krahasueshme me atë të valëve të tjera të migrimit. Me fjalë të tjera, imazhi i shqiptarëve në Zvicër është më pak afatgjatë, i influencuar nga shkaktarët negativë nga ç'ka mundur të druhet. Çfarë mbetet sot nga këto paragjykime? Studimi për diskriminimin gjatë vlerësimit (FMB, 2003) i referohet vitit 2003. Ai e tregonte «përmasën e paimagjinueshme të fenomenit», e cila i prekte shumë më tepër të rinjtë shqiptarë, sesa grupet e tjera të konsideruara në krahasim, sikurse janë të rinjtë me prejardhje portugeze. Ai e vë në pah njëlloj edhe përgënjeshttrimin a zbutjen e problemit në Zvicër. Në mungesë të një studimi aktual për këtë temë, nuk mund të gjykohet nëse problemi me kohën është zbehur krahas përmirësimit të përgjithshëm të imazhit të shqiptarëve në Zvicër.

Bashkëbiseduesit në këtë libër janë të një mendjeje se ky imazh po përmirësohet, ose së paku po e humb negativitetin e tij. Por përparimi i këtij procesi vlerësohet ndryshe. Mendimin më pak pozitiv e përfaqëson sociologu Uli Windisch, i cili, duke i ngelur besnik luftës së tij kundër asaj që ai e quan «politikisht korrekte», më parë e spikat atë që në sytë e tij në çështje të integritetit ende paraqet një problem, pikërisht «probleme në kontekst të sjelljes», që, sipas mendimit të tij, vazhdojnë të ekzistojnë. Ai

supozon që koncepti «kosovar» sigurisht e ruan një konotacion negativ. Kryetarja e Komisionit Federal Kundër Racizmit, Martine Brunschwig Graf, është gjithashtu e mendimit se klisheja që i asocion shqiptarët me dhunën, mbetet e «ngulitur». Pikëpamjet e tjera janë thelbësisht më optimiste. Më entuziasti është gjykatësi Roland Wiprächtiger, i cili mendon që imazhi po përmirësohet shumë më shpejt nga ç'është pritur: «Në rrethim tim nuk po dëgjoj më vërejtje kritike për shqiptarët. (...) Shqiptarët ia kanë dalë. Ata janë bërë përfundimisht një pjesë e Zvicrës.»

Si shpjegohet ky zhvillim? Paneli ynë me dhjetë «dëshmitarë» nuk mund të shihet si reprezentues për opinionin zviceran. Ai përbëhet nga vëzhgues të specializuar dhe përmes një «studimi kualitativ» lejon të hulumtohen faktorët kryesorë në një mënyrë pa dyshim shumë të plotë.

EFEKTI I «KOKËS SË TURKUT»

Nga njëra anë, disa prej bashkëbiseduesve tanë nënvizojnë se shqiptarët sigurisht që po kontribuojnë në zvogëlimin e imazhit negativ të viteve 1990. Në opinionin publik ata shumë thjesht po perceptohen më pak, sepse po orientohet nga lëvizjet e reja të migrimit, siç janë azilkërkuesit eritreas, apo sirianë.

E deleguara e për integrimin e Kantonit të Vaudit, Amina Benkais-Benbrahim, tregon që «i ardhuri së fundmi është shpesh «koka e turkut». Nëse akoma ndodh që mediet të raportojnë për raste të veçanta të kriminalitetit dhe e shquajnë prejardhjen e të dyshuarit si kosovar a maqedonas «pothuajse nuk flitet më për shqiptarët si grup». Nëse, sipas saj, imazhi ndodhet «në transformim», kjo i referohet para së gjithash asaj që «në perceptimin e një opinionit që do të frikësojë shqiptarët po bëhen më pak interesantë».

Gazetarja dhe koordinatorja e «Vivre ensemble», një platformë informimi për azil politik, Sophie Malka, vëren «një korrelacion të hapur ndërmjet debateve mbi kombësitë dhe hysenë e tyre në statistikën e azilit». Këtu do ta shkoqisim pak pikëpamjen e saj, duke treguar një veçanti të politikës zvicerane që nga vitet 1980, apo më saktë, që nga krijimi i së drejtës federale për ligjin e azilit në vitin 1979, i cili përfshinte një procedurë për shqyrtimin e kërkesave të azilit. Numri i «azilkërkuesve» (një koncept i gabuar gramatikisht, i cili, megjithatë, u etablua në diskursin publik), që

nga hyrja e tij në fuqi u rrit mbi pritjet. Rugëtimi i tyre nuk i ngjante më atij, që ligjvënësit e kishin parasysh me rastin e hungarezëve a çekëve, që arratiseshin nga komunizmi. Administrata e stërngarkuar federale edhe vetë i përdorte konceptet «shpërdorim», apo «refugjat ekonomik», përmes të cilit shumica e aplikantëve u diskriminuan dhe shiheshin si të padëshiruar. Ligji ishte disa herë objekt i revizioneve dhe referendumeve (votimi i fundit ishte në qershor 2016), kështu që tema politike e azilit në debatet publike dominonte mbi temat që lidheshin me migracionin. Dhe, kur kosovarët, të cilëve më 1991 u ndalohej qasja në tregun e punës, i janë referuar procedurës së re të azilit, i nënshtroheshin të njëjtit dyshim sikurse aplikantët e tjerë. Duke qenë se ata tani në statistikën e azilit janë shumë më të paktë në numër, kjo, sikurse argumenton Sophie Malka, shpie aty që ata po bëhen shumë më pak objekt i interesit publik.

EFEKTI I MEDIEVE

Edhe këtu efekti i parë i imazhit me të cilin përfitojnë shqipfolësit në Zvicër, përbëhet më pak nga elementet pozitive, dhe më shumë është shenjë e një dobësimi kohët e fundit të pasojave të zhvillimeve negative, të cilat ndodhnin në rrjedhën e viteve 1990-2000. Ky nuk u krijua qëllimisht nga mediet, por ka për shkaktarë mekanizmat e aktualitetit: Është e vërtetë që kryetitujt shpesh u përkithnin kosovarëve dhe që sloganet e një partie politike, të cilat i tematizonin shpërdorimet, ardhjet apo kriminalitetin, u transmetuan një më një. «Problemi është se mediet, në përgjithësi, flasin vetëm për atë që nuk funksionon», mendon Sophie Malka. «Ato raportojnë rrallë për sukseset e integritetit të tyre, ato u japin një rëndësi joproporcionale detajeve, të cilat më shumë janë fenomene shoqëruese».

A duhet të akuzohen mediet? Mendimet e bashkëbiseduesve tanë në këtë pikë ndahen. Si gazetar, i njoh mekanizmat thjeshtësues dhe sforcues të shtypit, të cilët e influencojnë një komunitet të ardhur, sikurse edhe kategori të tjera (studimet kanë treguar që edhe të rinjtë dhe gratë janë viktimë të klisheve mediale). Është më e thjeshtë të gjesh një titull shokues, nëse ai u referohet klisheve dhe josh t'i çimentojë paragjykimet për të arritur një tirazh më të lartë. Në përgjithësi, respektohen rregullat standarde, por presioni ekonomik dhe tempi me të cilin përcillen informacionet shpesh shpien në kompromise. Për më tepër, gazetarët zviceranë prej rreth njëzet vjetësh shfaqin prirjen

të tregojnë që nuk i fshijnë a minimizojnë faktet, duke qenë se nga Partia Popullore e Zvicrës (SVP) akuzohen (pak a shumë me të drejtë) që janë kryesisht të majtë. Për këtë arsye ata me dëshirë e përmendin prejardhjen zvicerane, apo të huaj të kriminelëve.

Ky efekt sforcues sigurisht mund të çojë në një drejtim favorizues. Së paku nëse bazohet në ngjarje që e lejojnë këtë. Kjo prej disa vjetësh po ndodh falë sportit. Një komentator i Radio Télévision Suisse shkoi aq larg sa Xherdan Shaqirin, në fund të një loje të Kampionatit Botëror të Futbollit më 2014, pasi kishte shënuar tre gola, ta krahasojë me Wilhelm Tell-in. Falë rrethanës që në Kombëtaren e Zvicrës luajnë disa lojtarë me origjinë shqiptare, ky efekt mban. Dy nga bashkëbiseduesit tanë vënë në pah se shqiptarët në Zvicër janë të ndjeshëm në faktin se prejardhja e këtyre lojtarëve nuk përmendet në medie në mënyrë të njëjtë: nëse ata japin gola (ata me këtë rast janë zviceranë), apo nëse i humbin duelet e tyre (atëherë ata më parë përshkruhen me prejardhjen e tyre shqiptare). Dallim i vërtetë, apo efekt i një mbindjeshmërie? Si shikues jo i rregullt i televizionit, personalisht prirem nga supozimi i dytë. Ra gjithashtu në sy, që loja e 11 qershorit 2016 e Zvicrës kundër Shqipërisë në Kampionatin Evropian të Futbollit u cilësua si «Derby», një koncept i cili normalisht përdoret në një ndeshje të fqinjëve të drejtpërdrejtë. A nuk është kjo një shenjë e afrimit?

HERONJTË E SPORTIT

Gjatë këtyre intervistave, disa bashkëbisedues folën spontanisht për futbollin si një faktor të rëndësishëm për përmirësimin e imazhit të shqiptarëve në Zvicër. Falë arritjeve të lojtarëve me origjinë shqiptare, nuk flitet më keq për ta, por mirë. Artikujt të cilët rrëfejnë për rrugëtimin e vet, apo të familjeve të tyre nga vendlindjet e tyre, nuk e paraqesin imigrimin më si një barrë, por si një pasurim për Zvicrën. Për gazetarin Bashkim Iseni, ky është një «ndryshim i jashtëzakonshëm».

Me rastin e Kampionatit Evropian të Futbollit, tifozëve në Zvicër iu shitën më shumë fanella shqiptare se zvicerane, dhe këtu mund të identifikohet një sinjal. Kjo pastaj në shtyp nuk u vlerësua si shenjë e një integrimi të keq, por u pranua me të njëjtin mirëkuptim, sikurse me rastin e komuniteteve të tjera me rrënjë të huaja, si italo-zviceranët.

INTEGRIMI I VËRTETË

Sporti përbën vetëm njërin prej kanaleve të integritimit. Pamja mund të mashtrojë, apo madje të shfaqë mungesën e rrugëve të tjera të ngritjes sociale. Po dëshmohet se ai në Zvicër e reflekton shumë më tepër një integrim të vërtetë. Shtimi i ndjeshëm i numrit të të rinjve me prejardhje shqiptare në universitete dhe shkolla të larta e konfirmon këtë. Në këtë kontekst, kjo mund të shihet si Massimo Lorenzi, gazetar në Télévision Suisse, i cili thotë që sporti është thjesht «indikatori më i dukshëm i integritimit».

Apo edhe jo, duke qenë se zviceranët në gazetatat e tyre ditore shohin që shqiptarët themelojnë ndërmarrje, udhëheqin restorante, ushtrojnë profesione të kualifikuara, ndjekin shkollime të mëtejme. Këtë mendim e përfaqëson profesor Basil Schader: Zviceranët e perceptojnë vetë këtë integrim, ata shohin shumë e më shumë shqiptare dhe shqiptarë që punojnë në spitale, në shitje, në sportelet e hekurudhës e të postës dhe në pozita me përgjegjësi. Kjo ndoshta bie akoma më shumë në sy, duke qenë se e përgënjeshtrojnë «një imazh mbizotërues të një komuniteti, që tregon vështirësi integrimi», sikurse shprehet sociologu Claudio Bolzman.

Si shpjegohet ky zhvillim i shpejtë në një vend pa politikë kombëtare të integritimit dhe në të cilin përpjekjet publike lokale, para së gjithash, orientohen nga sporti? Profesor Etienne Piguet vëren që në vendet e tjera «gjërat nuk zhvillohen domosdoshmërisht në drejtimin që fëmijët dalin më mirë se prindërit. Atje prindërit erdhën si punëtorë dhe fëmijët janë të papunë. Ne në Zvicër jemi të lumtur që tregu i punës është i hapur dhe që gjenerata e dytë po e kap shansin». Pa dyshim mund të plotësohet që nevojat e ekonomisë zvicerane për fuqi punëtore kanë për efekt që kjo hapje është e domosdoshme.

Por, për gjeneratën e dytë faktori më i rëndësishëm dhe ndoshta vendimtar është shkollimi. Nga njëra anë, mund të vërehet që ekzistenca e një sistemi të ngritur publik dhe të mirë shkollor e promovon konsiderueshëm integrimin. Nga ana tjetër, familjet shqiptare, që nga pavarësia e Kosovës dhe që nga fillimi i viteve 2000, duke qenë të vetëdijshëm se qëndrimi i tyre në Zvicër do të jetë i gjatë dhe mund të jetë definitiv, i inkurajojnë fëmijët e tyre për një shkollim të mirë. Kjo ndodh në një masë që «sot një pjesë e madhe e shqiptareve dhe shqiptarëve është e shkolluar mirë», thotë për shembull gjykatësi Roland Wiprächtiger.

Integrimi është një përgjegjësi e ndarë, për këtë janë të gjithë të një mendjeje. Gazetari Bashkim Iseni mendon që «edhe shqiptarët e kanë hisenë e tyre të përgjegjësisë në këtë imazh të keq. Atë të shkëputjes nga vendi i prejardhjes dhe që nuk kanë kontribuar sa duhet për ta afirmuar më mirë kulturën e tyre, të hyjnë në një dialog, t'i kërkojnë rrjetet, t'u mësyjnë sfidave. Ata është dashur të marrin pjesë më tepër në votime, të participojnë në jetën sociale, fëmijët t'i edukojnë me idenë se Zvicra është vendi i tyre dhe jo një vend i huaj». Lajmi i mirë është: sapo që të ndodhë riorientimi, sukcesi i një komuniteti i cili shfaq një «dinamikë» të tillë (Claudio Bolzman) duket.

ÇFARË MUNGON

Gati 300.000 albanofonë në Zvicër, kjo është një pjesë e popullatës, rëndësinë e së cilës magazina «L'Hebdo» më 2010 në ballinë e ilustroi në formë të një kantoni të 27-të. Por, nuk është një komunitet i mbyllur në vete (apo jo më), i cili jeton në margjina të pjesës tjetër të popullatës. Shumë ish-shqiptarë tani janë zviceranë të natyralizuar. Sikurse e dëshiron simbolikisht Bashkim Iseni, «Berisha» duhet të bëhet një emër zviceran.

Koha punon për ne. Kjo është normale, sepse integrimi kushton kohë, konfirmon Massimo Lorenzi, prindërit e të cilit kanë ardhur nga Italia. «Po nënvlerësohet rëndësia e çrrënjësjes, përçarjes së brendshme dhe përpjekjes për t'u integruar». Për Martine Brunschwig Graf, Zvicra është një vend që integron me kënaqësi, me dy kushte: «Në Zvicër mund ta ruash identitetin e trashëguar, por është shumë me rëndësi që t'i respektosh rregullat dhe ta mësosh gjuhën».

Këtu është fjala një herë më shumë për kritere, të cilat synojnë t'i shporrin nga rruga barrierat potenciale. Por, ajo çfarë, sipas mendimit tim, i mungon komunitetit shqiptar në Zvicër janë figurat pozitive identifikuese. Heronjtë sportivë e kanë luajtur këtë rol, por kjo pa dyshim nuk mjafton për të përfituar si komunitet i tërë prej kësaj. Ata, megjithatë, paraqesin një shembull që duhet imituar. Mund të mendohet se ngadalë do të shfaqen figura të tjera, si këngëtarja Elina Duni (e cila e meriton të njihet më mirë!). Është për të shpresuar që albanofonët do të dinë ta bëjnë gjithnjë më të njohur kulturën apo gastronominë e tyre.

Laurent Matthey

PASTHËNIE

Ky studim i Kujtim Shabanit dhe Alain Maillard për Institutin Zviceran për Studime Shqiptare (ISEAL) ofron një inventar të imazhit të shqiptarëve në Zvicër. Edhe pse disa prej përfundimeve janë më parë optimiste (Imazhi i vënë në pikëpyetje duket se po «rehabilitohet», sikurse vë në dukje Alain Maillard), studimi të kujton atë se ndryshimet që po ndodhin tani, shënohen në qëndrueshmëri. Koha e lejon një transformim të imazhit, i cili u jep të gjithëve një fytyrë, të cilët në fillim shiheshin si fuqi punëtore («Nga punëtorë në njerëz»).

Humanizimi ndodh përmes ngritjes së miteve të vogla dhe një rrëfimi të madh kolektiv, të cilët, përmes historive personale dhe kolektive, e tematizojnë karakterin shembullor të disa jetëshkrimeve. Trajta heroike e sportistit të madh, për shembull, e tregon një integrim të vërtetë të gjeneratës së dytë, me ç'rast për këtë duhen përgëzuar si migracioni, ashtu edhe shoqëria.

Në përgjithësi, ky studim kërkon hulumtime të tjera, të cilat shtrihen në një hark kohor më të gjatë dhe do të mobilizojnë korpus më specifik, sidomos në pikëpamje të medieve: mediet e shtypura, radioja, televizioni, platformat e interneti, komentet e lexuesve në forume informimi... Këto burime do ta lejojnë lindjen e mëtutjeshme dhe përhapjen e pamjeve dhe botëve imagjinare; do ta dokumentojnë qëndrueshmërinë apo ndryshimet afatgjata; do t'i hetojnë momentet dhe nxitësit e këtyre përmbysjeve (të natyrës politike, shoqërore, ekonomike, por edhe teknologjike).

Për shembull, do të kishte qenë interesante të kuptohet se si platformat e internetit u drejtohen migrantëve dhe njëkohësisht shoqërisë dhe e lejojnë një kontroll më të mirë të imazhit të zakonshëm në medie. Do të kishte qenë e dobishme të zotërohej mënyra se si kundërvajtjet e kryera nga migracioni e përshpejtojnë a e ngadalësojnë «rehabilitimin» e përmendur nga Maillard. Do të kishte qenë edhe kuptimplote të evidentohen kushtet që i përshpejtojnë ndryshimet e imazhit, të cilat çojnë në humanizimin e kësaj mase, që nga shoqëritë perceptohen si fuqi punëtore.

Nëse imazhet ngrihen në kuadër të rrëfimeve kolektive dhe nëse i referohen një miti dypjesësh të një regjimi në kuptimin e Roland Barthes, ato synojnë gjithmonë – në lidhje me një kontekst të dhënë social – të veprojnë, sikurse thërret në kujtesë ky studim. Ato ndjekin qëllime, frymëzojnë botë imagjinare, të cilat e paraqesin atë që më të thjeshtë realitetin shoqëror, sepse ato kryesisht

drejtpërdrejt – si në të mirë si në të keq – flasin në rrafshin e ndjenjave. Në këtë kuptim, veprimtaria e thjeshtë e fact checking-ut (shqyrtimit të fakteve) duket aq më e nevojshme. Ky punim po sigurohet nga shoqëri të panumërta, të cilat raportojnë me shumë durim për fakte, «fotografi» dhe botë imagjinare. Ky pothuaj është instrumenti i një ortopedie të durueshme, i cili nuk heq dorë nga rrafshi mendor për t'i implementuar kërkesat tona. Ky studim ofron edhe një kontribut në këtë punë.

Dr. Laurent Matthey

Anëtar i Këshillit të Fondacionit të ISEAL-it

Literatura

Mieten & Wohnen (2015): Ausländische Mieter unerwünscht. Nr. 7, f. 5.

Basler Zeitung (2005): Mit Albanern arbeitet kaum jemand gerne zusammen. 13.02.2015, f. 5.

Beobachter. Nr. 9, Jh. 2016.

BFS (2015): Die Bevölkerung der Schweiz 2014. Bundesamt für Statistik. Neuchâtel.

BFS (2010): Polizeiliche Kriminalstatistik. Jahresbericht 2009. Bundesamt Für Statistik. Neuchâtel.

BFS (2011): Polizeiliche Kriminalstatistik. Jahresbericht 2010. Bundesamt Für Statistik. Neuchâtel.

BFS (2012): Polizeiliche Kriminalstatistik. Jahresbericht 2011. Bundesamt Für Statistik. Neuchâtel.

BFS (2013): Polizeiliche Kriminalstatistik. Jahresbericht 2012. Bundesamt Für Statistik. Neuchâtel.

BFS (2014): Polizeiliche Kriminalstatistik. Jahresbericht 2013. Bundesamt Für Statistik. Neuchâtel.

BFS (2015): Polizeiliche Kriminalstatistik. Jahresbericht 2014. Bundesamt Für Statistik. Neuchâtel.

BFS (2016): Polizeiliche Kriminalstatistik. Jahresbericht 2015. Bundesamt Für Statistik. Neuchâtel.

Bonfadelli, Heinz (2007): Die Darstellung ethnischer Minderheiten in den Massenmedien. Nö: Bonfadelli, Heinz / Mose, Heinz (Hrsg.): Europa als multikultureller Raum?. Wiesbaden 2007.

Burri Sharani, Barbara / Efonayi-Mäder, Denise/ Hammer, Stephan/ Marco Pecoraro/ Soland, Bernhard / Tsaka, Astrit / Wyssmüller, Chantal (2010): Die kosovarische Bevölkerung in der Schweiz. Bern.

Eisenegger, Mark / Ettinger, Patrik (2012): Qualität der Medien. Kriminalitätsberichterstattung in der Schweizer Presse. Studien 3/2012, Basel.

Fibbi, Rosita / Bülent Kaya / Etienne Piguet (2003). Peter, Afrim oder Mehmet: der Name macht den Unterschied. Neuenburg: Schweizerisches Forum für Migrations- und Bevölkerungsstudien.

FMB, Forum für Migration und Bevölkerungsstudien, (2003): Le passeport ou le diplôme? Etude des discriminations à l'embauche des jeunes issus de la migration.

Freitag, Markus (2001): Das soziale Kapital der Schweiz: vergleichende Einschätzungen zu Aspekten des Vertrauens und der sozialen Einbindung. Nö: Swiss Political Science Review. 7/(4), f. 87-117.

Freitag, Markus / Bühlmann, Marc (2005): Politische Institutionen und die Entwicklung generalisierten Vertrauens. Ein internationaler Vergleich. Nö: Politische Vierteljahresschrift 46, f. 575-601.

Fuchs, Daniel (2016): Kriminelle Ausländer. Wie gut haben sich die Kosovo-Albaner integriert? Nun sind die Kosovaren die Guten. Nö: Aargauer Zeitung, 26.01.2016, f. 2-3.

Geissler, Reiner / Pöttker, Horst (2006): Mediale Integration von Migranten. Ein Problemaufriss. Nö: dies. (Hg): Integration durch Massenmedien – Mass Media-Integration. Bielefeld, f. 13-44.

Imhof, Kurt (1994): Die Ethnisierung des Politischen oder die diskontinuierliche Problematisierung kollektiver Identität. Nö: Jahrbuch für vergleichende Sozialforschung. fq. 157-177.

Imhof, Kurt (1996a): Die Semantik des Fremden in sozialen Krisenphasen. Nö: Das Fremde in der Gesellschaft: Migration, Ethnizität und Staat. f. 199-214.

Imhof, Kurt (1996b): Die gesellschaftskonstitutive Bedeutung des Fremden und die diskontinuierliche Ethnisierung des Politischen. Zur Problematik der Trendperspektiven in der Gesellschaftstheorie. Nö: Annali di Sociologia/ Soziologisches Jahrbuch der Italienisch-deutschen Gesellschaft für Soziologie.

Maillard, Alain / Ueli Leuenberger (1999). Les damnés du troisième cercle: les Albanais de la Kosovë en Suisse, 1965–1999. Genève: Les éditions Metropolis.

Sabani, Kujtim (2008): Integration, Albaner, Medien. Në: Albsuisse, f. 8.

Schader, Basil (2005): Shqyrtime gjuhësore rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes në Zvicër, Tiranë.

Schulz, Winfried (1999): Fernsehen und sozialer Wandel: Untersuchungen zur Integrations- und Fragmentierungsthese. Në: Wilke, Jürgen (Hg.): Massenmedien und Zeitgeschichte. Schriftenreihe der Deutschen Gesellschaft für Publizistik und Kommunikationswissenschaft 26. Konstanz, f. 90-105.

Shabani, Kujtim (2014): Ältere Albaner in der Schweiz. Eine stoische Würde. ISEAL, Lausanne 2014.

Shabani, Kujtim (2016): Dy personazhe – një përfundim. Në: dialoglus, dhjetor 2016, f. 12-13.

Von Aarburg / Hans-Peter / Gretler, Sarah Barbara (2008). Kosova–Schweiz: Die albanische Arbeits- und Asylmigration zwischen Kosovo und der Schweiz (1964–2000). Münster: LIT-Verlag.

Wyssmüller, Chantal (2005). Menschen aus dem Balkan in Schweizer Printmedien: diskursive Konstruktion und (Re-)Produktion von Raum - und Identitätsbildern und deren Bedeutung für soziale Integration. Bern: [s.n.].

Zwingli, Marcel (1994): Fremde schwarz auf weiss: Die Ausländerberichterstattung in der Deutschschweizer Presse – eine quantitative Inhaltsanalyse.

info@iseal.com
www.iseal.ch